



# BJES

## BEDER UNIVERSITY JOURNAL OF EDUCATIONAL SCIENCES

September 2014  
Volume 6, **Number 1**  
ISSN 2306-0557 (**Print**)  
ISSN 2310-5402 (**Online**)



**“HËNA E PLOTË” BEDËR UNIVERSITY**  
*Faculty of Philology and Educational Sciences*

**BJES**

**BEDER  
JOURNAL OF EDUCATIONAL  
SCIENCES**

*With a special contribution of the IWES 2014*

*Volume 6, Number 1*

*September 2014*  
[www.bjes.beder.edu.al](http://www.bjes.beder.edu.al)



# HËNA E PLOTË BEDËR UNIVERSITY

Faculty of Philology and Education at "Hëna e Plotë" Beder University offers Scientific Journal 'Beder Journal of Educational Sciences'- BJES (ISSN 2306-0557) (Print), ISSN 2310-5402 (Online).

BJES publishes three issues per year. BJES is blind peer reviewed by the members of editorial board. Official language of academic articles is English.

The main aim of the BJES is to serve the interests of contemporary and specialized academic works about different theories and practices in the education area seeking to promote the analysis of educational issues with social, cultural, technological, political and economical perspectives. BJES welcomes a wide range of original articles, research papers, proposed models, reviews of current literature, book reviews etc.

The authors are responsible for the originality and the facts contained in the articles and for the opinions expressed therein, which are not necessarily those of BJES and do not commit the editing process.

## EDITORIAL TEAM:

### 1-EDITOR-IN-CHIEF

Dr. Ahmet Ecirli, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

### 2-ASSISTANT EDITOR

M.A Matilda Likaj Shaqiri, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

### 3-DEPUTY EDITORS

M.A Arti Omeri, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

Ms.C Ana Uka, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

## INTERNATIONAL ADVISORY BOARD

Acad. Catalin Zamfir, Director ICCV, Romanian Academy

Prof. Dr. Hans Kochler, President of the International Progress Organization (I.P.O), Austria

Prof. Dr. Vincent N. Parillo, William Paterson, USA

Prof. Dr. Mark Web, Texas Tech University, USA

Prof. Dr. Waleck Delpore, Main University, USA

Prof. Dr. Artan Haxhi, Luigj Gurakuqi University, Albania

Prof. Dr. Liman Varoshi, Aleksander Xhuvani University, Albania

Prof. Dr. Dhori Kule, Tirana University, Albania

Prof. Dr. Remzi Altın, Epoka University, Albania

Prof. Dr. Murat Özler, Istanbul Technic University, Turkey

Prof. Dr. Hüseyin Ekiz, Süleyman Şah University, Turkey

Prof. Dr. Recep Ileri, Bursa Orhangazi University, Turkey

Prof. Dr. Süleyman Seydi, Suleyman Demirel University, Turkey

Prof. Dr. Yasin Aktay, Selçuk University, Turkey

Prof. Dr. Misu-Jan Manolescu, Agora University, Romania

Prof. Dr. Kóksal Alver, Selçuk University, Turkey

Prof. Dr. Gindra Kasnauskiene, Vilnius University, Lithuania

Assoc. Prof. Dr. Mehmet Ali Aydemir, Selçuk University, Turkey

Assist. Prof. Dr. Jędrzej Paszkiewicz, Adam Mickiewicz University, Poznań, Poland

Dr. Wycliffe Amukowa, Mount Kenya University, Kenya

Dr. Oana Petrescu, Universidad de Deusto, Spain

## CONTACT

Matilda Likaj Shaqiri

Assistant Editor

Hëna e Plotë "Bedër" University

Tel: +35542419200

Email: [bjes@beder.edu.al](mailto:bjes@beder.edu.al)

## EDITORIAL BOARD

Dr. Ferdinand Gjana, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

Prof. Dr. Ayhan Tekineş, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

Prof. Dr. Ilie Badescu, University of Bucharest, Romania

Prof. Dr. Elena Zamfir, University of West, Romania

Prof. Dr. Emilian Dobrescu, Romanian Academy, Romania

Prof. Dr. Mithat Mema, Aleksander Moisiu University, Albania

Prof. Dr. Artan Haxhi, Luigj Gurakuqi University, Albania

Prof. Dr. Liman Varoshi, Aleksander Xhuvani University, Albania

Prof. Dr. Dhori Kule, Tirana University, Albania

Prof. Dr. Remzi Altın, Epoka University, Albania

Prof. Dr. Murat Özler, Istanbul Technic University, Turkey

Prof. Dr. Hüseyin Ekiz, Süleyman Şah University, Turkey

Prof. Dr. Süleyman Seydi, Suleyman Demirel University, Turkey

Prof. Dr. Recep Ileri, Bursa Orhangazi University, Turkey

Assoc. Prof. Dr. Kseonela Sotirofski, Aleksander Moisiu University, Albania

Assoc. Prof. Dr. Ertan Özensel, Selçuk University, Turkey

Assoc. Prof. Dr. Mahmut Hakkı Akın, Selçuk University, Turkey

Assoc. Prof. Dr. Merita Xhumari, Tirana University, Albania

Assoc. Prof. Dr. Elida Tabaku, Tirana University, Albania

Dr. Paul Boswell, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

Dr. Trudy Anderson, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

Dr. Adem Balaban, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

Dr. Olcay Özkaya Duman, Mustafa Kemal University, Turkey

Dr. Betül Onay Doğan, Istanbul University, Turkey

Dr. Lulian Stanescu, Research Institute for Quality of Life,

Romanian Academy, Romania

Dr. Rregjina Gokaj, Tirana University, Albania

Dr. Elvana Shtepani, Tirana University, Albania

Dr. Tidita Abdurrahmani Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

M.A Ana Uka, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

M.A Arti Omeri, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

M.A Mehmet Aslan, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

M.A Edith Dobre, Romanian Academy, Romania

M.A Gülay Yurt, Hëna e Plotë "Bedër" University, Albania

M.Sc. Abdurrahman Çelebi, Hëna e Plotë "Bedër" University,

Albania

## JOURNAL DETAILS

Publishing: Faculty of Philology and Education

Hëna e Plotë "Bedër" University

ISSN 2306-0557 (Print)

ISSN 2310-5402 (Online)

Publication Frequency: 3 Issues Per Year

# TABLE OF CONTENTS

<b>Irena XHAFERRI,</b> Impakti i Fëmijëve me Çrregullime të Zhvillimit tek Motrat e Vëllezërit e Tyre.....	7
<b>Elida TABAKU,</b> Mesuesi si Punonjës Social dhe si Mësimdhënës: Sfidë Për Programet e Mësuesisë.....	17
<b>Zenel ORHANI, Valbona MUÇA, Edlir ORHANI,</b> Disa Çështje Themelore të Zhvillimit të Etno-Psikologjisë Shqiptare.....	25
<b>Ledia KASHAHU (XHELILAJ), Theodhori KARAJ,</b> Perceptimet dhe Qendrimet e Mesuesve dhe Drejtuesve të Shkollave 9-Vjecare mbi Fenomenin e Bullizmit.....	35
<b>Xhevdet ZEKAJ, Marsela TOPUZI, Aurela AGALLIU,</b> Barazia Gjinore dhe Edukimi. Gjinor në Arsim, Tregues i Rendesishëm i Zhvillimit Social dhe Ekonomik të nje Shoqërie.....	49
<b>Elona MUSTAFARAJ,</b> Rehabilitimi me Bazë Komunitarë, Sfidë e Shërbimeve Psiko-Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuar.....	65
<b>Arbjola HALIMI,</b> Shërbimi Psikologjik në Shqipëri dhe Nevojat Psikologjike të Shqiptarëve Ndër Vite (pas vitit 1990).....	71
<b>Nuredin ÇEÇI,</b> Studimet Sociologjike Duhet të Jenë sa më Pranë Qytetarëve dhe në Shërbim të Çështjeve Publike.....	77
<b>Tidita ABDURRAHMANI,</b> Shërbimi Psiko-Social në Institucionet e Arsimit Parauniversitar në Shqipëri dhe Perceptimet e Mjedisit Shkollor mbi Këtë Shërbim.....	87



**Irena XHAFERRI**  
Universiteti "Aleksandër Xhuvani"  
Elbasan/Shqipëri

## **Impakti i Fëmijëve me Çrregullime të Zhvillimit tek Motrat e Vëllezërit e Tyre**

### **Abstrakt**

*Të gjithë pjesëtarët e familjes ndikohen kur kanë pranë një fëmijë me çrregullime. Marrëdhënia mes motrave e vëllezërve është një ndër marrëdhëniet më të rëndësishme, dinamike, ndikuese dhe afatgjatë në jetën e individit (Cox, Marshall, Mandleco, & Olsen, 2003). Kur mendohet mbi domethënien dhe rëndësinë e marrëdhënieve mes motrave e vëllezërve, një ndryshim në shëndetin apo funksionimin e fëmijës mund të ndikojë mbi motrën a vëllain e tij/saj. Shumica e studimeve dhe e kërkimeve mbi familjen janë fokusuar rreth prindërve, por kohët e fundit janë rritur interesat mbi ndikimin dhe efektet e individëve me aftësi të kufizuara tek motrat e vëllezërit. Nga shumë studime ka shumë të dhëna kontradiktore; disa tregojnë efekte dëmtuese ndërsa të tjerë tregojnë impakte neutrale ose pozitive. Fokusi i këtij studimi metaanalitik është tek motrat e vëllezërit e fëmijëve me çrregullime të zhvillimit, ku do të mblidhen të gjithë faktorët që ndikojnë në problemet përshtatjes së këtyre fëmijëve (psh emocionale, të sjelljes, vetëkonceptit) e më pas në gjetjen e mënyrave më optimale të trajtimit.*

**Fjalet kyçe:** Çrregullime të zhvillimit; Motra/vëllezër; Marrëdhënie; Aftësia sociale; Vetëkocept

## 1-Hyrje: Impakti i Fëmijëve me Çrregullime të Zhvillimit tek Motrat e Vëllezërit e Tyre

Lidhja mes motrave e vëllezërve është unike ku ndahen përvojat e njejta gjenetike, kulturore (Pruchno et al.1996). Pavarësisht ndryshimeve sipas rrethanave individuale, marrëdhënia mes motrave e vëllezërve është një ndër marrëdhëniet më jetëgjatë. Së fundmi po rritet shumë numri i divorceve e largimi i njërit prind nga familja dhe lëvizjet gjeografike janë të zakonshme, motrat e vëllezërit janë i vetmi burim i vazhdueshëm, e vetmja marrëdhënie e qëndrueshme në familje. Përveç kësaj, familjet tani kanë më pak fëmijë të cilët kanë diferencë moshore të vogël, duke e bërë këtë marrëdhënie mes tyre me të fortë e dinamike. Nga e gjithë kjo pikëpamje është mëse e kuptueshme që prania e një fëmije me paaftësi të zhvillimit ka një ndikim të gjatë e të vazhdueshëm në jetën familiare dhe sidomos tek fëmija tjetër. Marrëdhëniet mes motrave e vëllezërve janë komplekse, me emocione të përziera e ndonjëherë me efekte më pak pozitive dhe afatgjata. Këto marrëdhënie komplekse janë të pranishme edhe kur në familje është një fëmijë me aftësi ndryshe. Duke folur kaq shumë për këtë aspekt, ashtu si ndodh edhe në jetën e përditshme ne harrojmë pjesën tjetër të familjes: prindërit, motrat e vëllezërit e tjerë, e kjo është mëse e natyrshme. Kur problemet janë afatshkurtra, pavarësisht traumës që mund të shkaktojnë, ato mund të marrin një zgjidhje. Por kur problemet janë afatgjata, siç është çrregullimi i spektrit autik, vështirësia rritet më shumë. Këto probleme prekin sidomos atë lidhje më të fuqishme, dinamike, dhe afatgjatë në jetën e njeriut, lidhjen midis motrave e vëllezërve.

Në momentin që një fëmijë merr një diagnozë, të çfarëdolloji çrregullimi (psikiatrik, neurologjik, zhvillimi) prishet e gjithë dinamika familiare. E gjithë vëmendja dhe fokusi i familjes tashmë drejtohet vetëm ndaj këtij fëmije, duke lënë mënjanë fëmijët e tjerë. Kjo gjë, përveç traumës së parë, tek këta fëmijë shton dhe thëllon një tjetër traumë, të cilën prindërit nuk mund ta shohin. Shpesh herë këta fëmijë mund të marrin përsipër edhe rolin e kujdestarit për motrën/vëllain me çrregullime ose rolin kujdestarit për mbarëvajtjen e familjes. Në këtë mënyrë, duke patur përgjegjësi ndaj motrës/vëllait ata mund të humbasin përvoja dhe marrëdhënie të rëndësishme jashtë shtëpisë.

## 2-Faktorët Ndikues në Përvojën e Fëmijëve

Të paturit e një motër/vëlla me çrregullime të rënda (përfshirë këtu edhe autizmin), duket se ndikohet nga madhësia e familjes, statusi socio-ekonomik dhe besimi i tyre fetar (Powell & Gallaher, 1992; Marsh, 1992; Siegel & Silverstein, 1994). Në këtë kuadër, në familjet e mëdha në numër, motrat/vëllezërit e fëmijëve me autizëm. Fëmijët e familjeve me status socio-ekonomik të ulët mund të marrin përgjegjësi perkujdesëse të mëdha ndaj motrave/vëllezërve. Po ashtu duket se fëmijët përshtaten më mirë me çrregullimin e motrave/vëllezërve të tyre kur hapësira, diferenca moshore midis tyre është e madhe.

Motrat/vëllezërit e fëmijëve me çrregullime mund të kenë edhe nevojat e tyre të veçanta. Të paturit një motër/vëlla me çrregullime mund të ketë një ndikim negativ,



pozitiv ose neutral në vaërsi të një numri të madh faktorësh (Harry et al. 1998; Hannah & Midlarsky 1999). Disa studime raportojnë që marrëdhënia mes motrave/vëllezërve ka nivele të larta stresi; të tjerë nuk gjejnë ndryshime në vetëvlerësim, ndjenja pozitive rreth jetës së tyre apo stres krahasuar me fëmijët e tjerë nuk kanë motër/vëlla me çrregullime (Hannah & Midlarsky 1999). Prandaj, tabloja e përgjigjeve dhe reagimeve është komplekse e ndikuar nga shumë faktorë të tjerë si ashpërsia dhe lloji i çrregullimit, moshë e fëmijës, rendi i lindjes, madhësia e familjes dhe ndikimet prindërore.

### 3-Karakteristikat e çrregullimit

Karakteristikat e çrregullimit besohet se ka ndikim në marrëdhënien mes motrave e vëllezërve. Aspekti i parë është lloji i çrregullimit. Psh, një çrregullim kompleks si autizmi mund të jetë më shumë e ngatërruar dhe çorientuese për një fëmijë se një diagnozë e tjetër. Disa çrregullime mund të jenë më shumë të dukshme dhe të jenë më shumë stigmatizuese nga të tjerat – edhe pse, nga ana tjetër, sjellja e pazakontë e një fëmije që nuk ka shenja të dukshme të një çrregullimi mund të shkaktojë më shumë shqetësim e siklet tek motra/vëllai sesa kur çrregullimi i fëmijës është i dukshëm dhe e shpjegon sjelljen e papërshtatshme.

Niveli i kompetencës dhe aftësia e komunikimit e fëmijës me çrregullime duket se ka ndikim të madh në ndërveprimet mes motrave e vëllezërve (Heller et al. 1999). Në rastin e shurdhërim-verbërisë fëmijët mund të kenë vështirësi në komunikimin mes tyre dhe mund t'u nevojitet përdorimi i sistemeve alternative të komunikimit (Heller et al. 1999).

Në aspektin e dytë të ndikimit në reagimin e motravë/vëllezërve është ashpërsia e çrregullimit të fëmijës. Një fëmijë me çrregullim të rëndë, të ashpër kërkon më shumë kujdes, që mund të stresojë prindërit dhe 'ushtron presion' mbi motrat/vëllezërit për t'u kthyer në kujdestarë zëvendësues. Nga ana tjetër, faktor domethënës mund të mos jetë sasia e kohës që ka nevojë fëmija me çrregullime, por mënyra se si ky fëmijë sillet gjatë kohës që i kushtohet përkujdesja (Seligman & Darling 1997).

### 4-Moshë e fëmijës

Marrëdhënia mes motravë/vëllezërve ku një fëmijë ka një çrregullim shpesh fokusohet rreth përkujdesjes sesa lojës së bashku. Niveli i përgjegjësisë që motrat/vëllezërit ndiejnë mund të lidhet me rendin e lindjes dhe me gjininë e tyre, ku zakonisht motrat e mëdha mbajnë më shumë përgjegjësi. Duke vepruar si kujdestarë zëvendësues të prindërve atyre ukërkohet aftësi e durim dhe mund të kufizojë mundësitë e tyre për të patur aktivitete të përshtatshme sipas moshës së tyre e të kenë marrëdhënie me moshtarët e tyre (Hannah & Midlarsky 1999). Nga studimet raportohet që sa më e madhe diferenca moshore mes fëmijëve shkakton më pak stres tek prindërit e për pasojë edhe tek motrat/vëllezërit. Ndërsa fëmijët e të njejtës gjini që kanë edhe ndryshim të vogël moshor mes tyre mund të ndihen më të afërt gjë që mund të shkaktojë mundësi për konflikte e çoroditje e siklet (Powell & Gallagher 1993).

Fëmijët që janë më të vegjël se fëmija me çrregullime e keqkuptojnë çrregullimin dhe shkakun e tij (Lobato 1990), sidomos nëse çrregullimi nuk ka shenja të dukshme fizike. Po ashtu motrat/vëllezërit më të vegjël kanë më shumë mundësi të besojnë që edhe ata do ta marrin atë çrregullim ose që ata e kanë shkaktuar atë. Gjithashtu ata kanë më shumë nevojë për t'u ushqyer dhe mund të vuajnë më shumë se motra/vëllai më i madh nëse ushqimi nuk është gati nga prindërit që janë të zënë duke u përkujdesur për fëmijën me nevoja të veçata. Fëmijët më të vegjël mund ta shohin motrën/vëllanë më të madh si më të aftë dhe vihen më shumë në siklet kur ata kanë sjellje të papërshtatshme. Për më tepër, sapo zhvillohet normalisht dhe i kalon aftësitë e fëmijës me çrregullime, fëmija më i vogël ndihet fajtor pse është më i aftë se motra apo vëllai. Nga ana tjetër, fëmija i vogël është rritur me motrën a vëllain me çrregullime dhe kështu mund ta shohin atë si 'normal'.

### 5-Rrethanat familjare

Lidhja mes motrave/vëllezërve ndikohet nga rrethanat familjare. Psh., perceptimet e motrave/vëllezërve të qëndrimeve të prindërve ndaj fëmijës me çrregullime mund të jetë një ndikues shumë i madh i përshtatjes së tyre (Caldwell & Guze 1960). Është e rëndësishme që të dy prindërit të kenë të njëjtin qëndrim pozitiv, sesa vetëm njëri prind. Pritshmëritë e prindërve dhe të familjes që fëmija tjetër të kujdeset e të marrë përgjegjësi ndaj fëmijës me çrregullime, ndikojnë në mirëqenien e tij. Edhe pse mund të jetë rasti kur vajza e madhe e merr përsipër këtë përgjegjësi, karakteristikat e anëtarëve të familjes dhe historiku kulturor i familjes ndikon në marrëdhënien mes motrave e vëllezërve. Mundet që motra/vëllai e respekton dhe mirëpret përgjegjësinë e tij (ndonjëherë gjatë gjithë jetës) për motrën a vëllain me çrregullime pasi kjo është një praktikë tradicionale kulturore. Ky është rast i veçantë ku familjet kanë struktura hierarkike dhe kur fëmija me çrregullime është i vogli i fëmijëve (Harry et al. 1998). Sipas nevojave të tyre specifike, shumë familje i trajtojnë fëmijët me çrregullime dhe ata jo me çrregullime në mënyrë të veçantë. Megjithatë, fëmija pa çrregullime mund të mos jenë të kënaqur me këtë ndryshim, kur ata e shohin që ky ndryshim është i nevojshëm apo i drejtë. Faktet që një fëmijë është i favorizuar në mënyrë të padrejtë ose i jepet një trajtim preferencial mund të çojë në keqdashje dhe konflikt mes tyre (Powell & Gallagher 1993).

Fëmijët nga familjet e mëdha mund të përshtaten më mirë se fëmijët nga familjet e vogla (Powell & Gallagher 1993). Kjo mund të ndodhë pasi një numër i madh i fëmijëve mund ta ndajnë përkujdesjen mes tyre. Për më tepër, nëse është një tjetër fëmijë pa çrregullime me të cilin mund të ndajë edhe të fshehta (Lobato 1990).

Madhësia e familjes ndikon në statusin socioekonomik të saj, gjë që ndikon edhe në përvojën mes motrave dhe vëllezërve. Familjet me status të ulët socioekonomik dhe familjet e mëdha mund të kenë burime më të pakta për plotësuar të gjitha përkujdesjet dhe nevojat mjekësore të fëmijës, gjë që mund të ushtrojë më shumë presion tek e gjithë familja duke e rritur përgjegjësinë e përkujdesjes tek motrat e vëllezërit (Hannah & Midlarsky 1999).

Prindërit nga nivelet e larta socioekonomike mund të kenë vështirësi në uljen e pritshmërive të tyre ndaj fëmijës me çrregullime, një reagim që mund të kopjohet edhe nga fëmija tjetër. Nga ana tjetër, familjet e klasave të mesme shpesh i kanë fondet për të paguar ndihmës si pastrues apo kujdestare. Kjo nënkupton se prindërit janë më të lirë për të kaluar më shumë me fëmijët dhe i kushtojnë më pak kohë përkujdesjes ndaj kërkesave të fëmijëve të tyre (Stoneman et al. 1988, in Powell & Gallagher 1993). Të ardhurat e larta ekonomike të familjes i lejojnë motrat/ vëllezërit e fëmijëve me çrregullime që të kalojnë më shumë kohë me aktivitete jashtë shtëpisë, duke krijuar më shumë shoqëri dhe një rrugëdalje nga ndjenjat dhe një pushim nga kërkesat e shtëpisë.

## 6-Përgjigjet Emocionale të Motrave/Vëllezërve

Fëmijët mund të përjetojnë një numër të madh emocionesh si pasojë e çrregullimit e motrës/vëllait të tyre. Sigurisht që çështjet emocionale mund të gjenden të pranishme në marrëdhëniet mes fëmijëve në çdo familje (Powell & Gallagher 1993). Megjithatë, intensiteti i tyre mund të jetë më i madh me një motër/vëlla me çrregullime dhe vetë ndjenjat mund të jenë më të qëndrueshme, prandaj fëmija mund të ketë nevojë për mbështetje për t'u shprehur.

**Frikërat.** Fëmijët e vegjël mund të jenë të frikësuar se mos e marrin edhe ata 'sëmundjen'; fëmijët më të mëdhenj mund të përjetojnë shqetësim për të ardhmen e fëmijës me çrregullime, për reagimin e miqve të tyre dhe frikën për fëmijët e tyre. Izolimi. Shumë motra/vëllezër ndiejnë që ata janë të ndryshëm nga moshatarët e tyre dhe që familja e tyre është e ndryshme nga e të tjerëve. Kjo mund të gjenerojë një ndjenjë e të qenit special ose mund të ketë një ndikim negativ mbi vetëvlerësim dhe mirëqenie (Hannah & Midlarsky 1999). Motrat/vëllezërit mund të ndihen të izoluar nga anëtarët e tjerë të familjes. Kur një anëtar tjetër i familjes ka kaq shumë nevojë, motrat/vëllezërit mund të ngurrojnë për të kërkuar që t'u plotësohen nevojat e tyre.

**Zemërimi.** Zemërimi mund të jetë rezultat i ndjenjave të pavlerësuar dhe të injoruara e mund të drejtohen ndaj motrës a vëllait me çrregullime, prindërve, shoqërisë apo Zotit. Gjithashtu, fëmijët mund të ndihen të zemëruar nëse këtë barrë e mban nëna pa ndihmën e babait. Ata mund të ndihen të zemëruar ndaj prindërve që nuk e mbron fëmijën që të mos ketë çrregullime, të cilët duhet ta kishin parandaluar me patjetër atë. Po ashtu është e zakonshme që motrat/vëllezërit të ndihen të zemëruar ndaj moshatarëve të tyre që e keqtrajtojnë fëmijën me çrregullime. Madhësia e zemërimit varet nga një numër faktorësh: sa i përgjegjshëm motra/vëllai ndaj fëmijës me çrregullime, nëse fëmija me çrregullime manipulon apo ka avantazhe ndaj motrës/vëllait, sesa i kufizuar bëhet jeta sociale e motrës/vëllait, nëse familja mund të përballojë financiarisht shpenzimet dhe nga madhësia e familjes (Seligman & Darling 1997).

**Faj.** Motrat/vëllezërit mund të ndiejnë zemërim kur motra apo vëllai tallet apo dhunohet, por mund të jenë shumë të frikësuar nga këto situata saqë nuk mund ta mbrojnë atë. Faji mund të jetë pasojë e paaftësisë së tyre për të ndaluar talljen,

pavarësisht se kjo mund të jetë përtej aftësive që mund t'ua lejojë mosha e tyre.

**Fyerje.** Motrat/vëllezërit mund të ndihen të fyer nga sasia e kohës që prindërit u kushtojnë ndaj fëmijës me çrregullime, nuk i durojnë dot shkurtime të aktiviteteve që mund të vijën si pasojë e fëmijës me çrregullime dhe mund të fyhen nga pritshmëritë e ndryshme që kanë prindërit ndaj tyre e ndaj fëmijës me çrregullime. Xhelozia dhe fyerja mund të rriten kur arritjet e fëmijës me çrregullime priten me entuziazëm të madh, ndërsa arritjet e tyre, duke qenë se duken të thjeshta priten në mënyrë të vogullt nga prindërit. Në mënyrë të ngjajshme, fëmija mund të ndihet i fyer nga sasia e madhe e detyrave të shtëpisë që marrin në shkollë krahasuar me detyrat më të këndshme të fëmijës me çrregullime. Xhelozia mund të çojë në faj për ndjenjat negative ndaj motrës a vëllait me çrregullime, pasi presin që t'u plotësohen nevojat e veta.

**Turpërimi.** Motrat/vëllezërit mund të turpërohen nga pajisjet e pakëndshme që mund të përdorë motra a vëllai ose mund të ndihen të turpëruar kur sjellja e tyre e papërshtatshme mund të tërheqë vëmendjen e të tjerëve. Shpesh ata turpërohen kur miqtë e tyre i takojnë për herë të parë motrën a vëllain me çrregullime. Kjo mund të jetë shumë e mprehtë kur fëmija me çrregullime është më i madh dhe nuk vepron si i tillë. Ndonjëherë, motrat/vëllezërit mund të mos turpërohen nga reagimet e të tjerëve, por gjithësesi janë të vëmendshëm:

Shokët e shoqet erdhën në shtëpinë tonë për të luajtur dhe unë i vëzhgova se si ata mund të luanin me të. Ndërsa ne u rritëm, unë i testoja djemtë që kisha shokë për t'i parë se si ata mund të trajtonin vëllain tim. Shumë prej tyre nuk ishin më shokët e mi pasi ata e trajtuan atë ndryshe. Cramer et al. (1997: 46).

**Konfuzioni.** Motrat/vëllezërit mund të ndihen të ngatërruar nga rolet e tyre në familje prej ndjenjave komplekse që ata mund të përjetojnë ndaj motrës a vëllait të tyre, për prioritetet e trajtimit ndaj fëmijës me çrregullime dhe për mendimet e ndryshme për mënyrën e trajtimit të fëmijës. Konfuzioni mund të shihet sidomos kur kushtet, gjendja e motrës a vëllait nuk kanë një shkak të njohur dhe rezultatet vazhdojnë të kenë një sjellje të papërshtatshme.

**Presioni.** Motrat/vëllezërit mund të ndiejnë presion në arritjen e niveleve të larta për të kompensuar prindërit e tyre për çrregullimin e motrës a vëllait dhe sidomos vajzat e mëdha tentojnë të ndiejnë presion për t'u përkujdesur ndaj fëmijës me çrregullime tani dhe në të ardhmen.

## 7-Modelet E Stresit Familjar

### 7.1 Modeli Lazarus i stresit familjar

Lazarus & Folkman (1985) paraqitën modelin e vlerësimit të stresit ku ngjarjet stresuese dhe burimet përballuese janë të pandashme (Mezer et al, 1991). Në këtë model mund të futen burimet dhe përgjigjet përballuese si të familjes dhe të individëve të veçantë. Familje të ndryshme u përgjigjen ndryshe ndaj stresorëve dhe u duhet kushtuar vëmendje variablave ndërmjetësojnë efektet e stresit (Crnic

et al., 1983). Proçesi i stresit mund të ndahet në dy proçese: vlerësimet konjitive dhe bashkëpunuese (Lazarus & Folkman, 1985).

Sipas Lazarus & Folkman (1985), stresi shtrihet në vlerësimet individuale të marrëdhënieve midis informacioneve dhe kërkesave të mejdisit dhe axhendave, e aftësive individuale për t'u përballur, lehtësuar ose ndyshuar këto kërkesa sipas interesave të mirëqenies. Vlerësimi konjitiv i referohet proçesit ku individi ia atribuon kuptimin ngjarjes. Asgjë nuk është stresuese nëse individi nuk e vlerëson si të tillë. Vlerësimet konjitive përfishijnë dy nivele vlerësimesh: primar dhe sekondar. Vlerësimi primar përdoret për të vlerësuar një ngjarje si të pavend, pozitive ose negative. Nëse motra/vëllai është me aftësi të kufizuar, kjo gjë mund të vlerësohet si një ngjarje negative e më pas shihen si një situatë e dëmtimit apo humbjes së mundshme. Në vlerësimin sekondar, individi vlerëson burimet dhe mundësitë e tij bashkëpunuese kur përballlet me një ngjarje stresuese (Lazarus & Folkman 1985; Luiz, Fullard, Sewart, Lombard, Corna, Jansen, Wiehan, 1994). Vlerësimet primare ose sekondare funksionojnë në mënyrë të pavarur. Për shembull, një motër/vëlla me çrregullime shihen si kërcënuese, por burimet bashkëpunuese të fëmijës janë të përshtatshme për t'u përballur me të, shkalla e kërcënimit të reagimit të stresit është e ulët (Lazarus & Folkman, 1985).

### **7.2-Modeli i dyfishtë i ABCX i pështatjes dhe adaptimit**

Cherry (1989), përblodhi modelin ABCX të stresit familiar të Hill (1949). Modeli ABCX ilustron përgjigjet fillestare të familjes ndaj një stresori që rëzulton në perceptimin e një stresori nëse është krizë ose jo. Ky model përfshin katër komponentë: A- ngjarja stresuese, B- burimet e rezistencës familjare, C- përkufizimi familiar ndaj stresorit dhe X- kriza. Kriza mund të ndodhë nëse familja nuk është e aftë të vendosë qëndrueshmërinë dhe nëse qëndron për kohë të gjatë ndaj një presioni të vazhdueshëm i cili tenton të bëjë ndryshime në strukturën familiare.

McCubbin dhe Patterson (1983) e zgjeruan këtë model, Modeli i Dyfishtë ABCX, merr parasysh që efekti i vetë stresorit mund të përzihet e bashkohet me kalimin e kohës dhe ndërsa familja përpiqet të përballojë atë, rezultati përfundimtar i adaptimit të vazhdueshëm nga i mirë shkon në keq. Komponentët paralelë ndaj modelit ABCX, i aplikuar ndaj motrave/vëllezërve i fëmijëve me aftësi të kufizuar janë si më poshtë:

Faktori A – përbërësi i stresit të grumbulluar i të paturit një motër/vëlla me çrregullime të ashpra.

Faktori B – burimet përballuese të familjes psh, statusi socio-ekonomik, mbështetja sociale etj

Faktori C – përkufizimi dhe perceptimi familiar ndaj situatës së plotë, përfshi stresorin e grumbulluar p.sh., një mori e kërkesave përkujdesëse dhe i burimeve të reja e të vjetra të anëtarëve të familjes, pasi me kalimin e kohës familja fillon ta perceptojë situatën në mënyrë të ndryshme.

Faktori X – adaptimi i orëvajtjeve përballuese të familjes duke ruajtur balancën në adaptimin familiar.

Modeli i Dyfishtë ABCX na jep një formë të konceptualizimit të faktorëve në

adaptimin e familjes ndaj një stresori. Na jep mundësinë t'i kuptojmë këto familje dhe përgjigjet e përballimi i stresit individuale i çdo anëtar të familjes, vetë çrregullimi dhe vështirësitë e tij, mbliidhen nga kroniciteti i problemit dhe nga burimet brenda familjes e nga shoqëria duke ndikuar kështu në adaptimin e secilit prej tyre (Cherry, 1989). Duke aplikuar modelin e dyfishtë ABCXtë përshtatjes dhe adaptimit, motrat/vëllezërit e e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duhet të shihen edhe ndryshimet në funksionimin konjitiv të tyre gjatë rritjes (Seiffge-Krenke & Shulman, 1993).

### **7.3-Një model adaptues**

Crinn et al (1983) propozoi një model përshtatës që integron tri koncepte bazë: stresi, përballja individuale dhe ndikimet ekologjike në zhvillim dhe funksionim. Sipas këtij modeli, prania e një fëmije me çrregullime është një stresor i vazhdueshëm që përshpejton kriza të shumta. Përgjigja familiare ndaj stresit angazhohen burime të ndryshme përbaluese si nga individit edhe nga familja. Këto burime përbaluese ndërmjetësohen nga fusha të ndryshme ekologjike, ku ndërveprojnë anëtarët e familjes, po ashtu shihen edhe ndërveprimet ndërmjet këtyre fushave. Adaptimi familiar ndaj stresorit i të paturit një fëmijë me autizëm mund të qarkojë strategji të ndryshme që angazhohen në adaptimin e këtij stresori, ku përfshihen: mekanizmat mbrojtës, përballimi dhe aftësia ripërtëritëse (Marsh, 1992).

## **8-Konkluzione**

Ndërsa studimet na thonë shumë rreth marrëdhënive të motrave e vëllezërve kur një prej fëmijëve ka një çrregullim, informacioni duhet jetë edukues. Mënyra e përjetimit të stresit është e ndryshme dhe ajo ndikon të gjithë anëtarët e familjes (Sherman, 1997). Impakti i të paturit një motër a vëlla me çrregullime keqësojë problemet në përshtatjen psikologjike të fëmijëve, pasi ata janë të prirur të përjetojnë turp, faj, stigmatizim, përgjegjësi shumë të mëdha të përkujdesjes etj (Labato, 1990; Abell & Gecas, 1997)

Labato (1990) na porositi të tregojmë kujdes kundër kontribuit të vështirësive të fëmijëve që janë rritur me një motër a vëlla me çrregullime, pasi ato vështirësi mund të ndodhnin gjithësesi. Është shumë e lehtë të fajësosh të dukshmen – në këtë rast fëmijën me çrregullime – për vështirësitë që përjetojnë anëtarët e familjes, individët janë më kompleksë dhe emocionet e tyre ndikojnë shumë në marrëdhëniet që krijojnë(Hayes 1998).

## Referenca

Bagenholm, A., & Gillberg, C. (1991). Psychosocial effects on siblings of children with autism and mental retardation: A population-based study. *Journal of Mental Deficiency Research*, 35, 291-307.

Benderix Y. and Sivberg, B. (2007). "Siblings' experiences of having a brother or sister with autism and mental retardation. A case study of 14 siblings from 5 families," *Journal of Pediatric Nursing*, vol. 22, no. 5, pp. 410-418

Beyer, J. F. (2009) "Autism spectrum disorders and sibling relationships: research and strategies," *Education and Training in Developmental Disabilities*, vol. 44, no. 4, pp. 444-452,

Burke, P., and Montgomery, S. (2000). Siblings of children with disabilities: A pilot study. *Journal of Intellectual Disabilities*. 4. 227-236

Burke, P. (2004). *Brothers and Sisters of Disabled Children*. London. Jessica Kingsley

Dyson, L. (1989). Adjustment of Siblings of Handicapped Children: A Comparison. *Journal of Pediatric Psychology*. 14, 2. 215-229

Evans, J., Jones, J., & Mansell, I. (2001). Supporting siblings: Evaluation of support groups for brothers and sisters of children with learning disabilities and challenging behaviour. *Journal of Learning Disabilities*, 5, 69-78.

Ferrari, M. (1984). Chronic illness: Psychosocial effects on siblings - I. Chronically ill boys. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 25, 459-476.

Fisman, S., Wolf, L., Ellison, D., Gillis, B., Freeman, T., & Szatmari, P. (1996). Risk and protective factors affecting the adjustment of siblings of children with chronic disabilities. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 35, 1532-1541.

Hannah, M. E., & Midlarsky, E. (1985). Siblings of the handicapped: A literature review for school psychologists. *School Psychology Review*, 14, 510-520.

Hastings, R. (2007). Longitudinal Relationships Between Sibling Behavioral Adjustment and Behavior Problems of children with Developmental Disabilities. *Journal of Autism and Developmental Disorders*. 37. 1485-1492

Joseph Rowntree Foundation. [online]. (2010). Children's Understanding of their Sibling Relationship. Available from: <http://www.jrf.org.uk/publications/childrens->

understanding-their-sibling-relationships. Accessed 13 January 2010

Lobato, D. (1983). Siblings of handicapped children: A review. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 13, 347-364.

Lobato, D. J., & Kao, B. T. (2002). Integrated sibling-parent group intervention to improve sibling knowledge and adjustment to chronic illness and disability. *Journal of Pediatric Psychology*, 27, 711-716.

Perry, A. (1989). What it's like to have a brother or sister with a developmental disorder. Unpublished, Toronto: Thistletown Regional Centre

Pit-Ten Cate, I., and Loots, G. (2000). Experiences of siblings of children with physical disabilities: an empirical investigation. *Disability and Rehabilitation*, 22, 9, 399-408

Porter, L. & McKenzie, S. (2000). Professional collaboration with parents of children with disabilities. London, Wiley.

Rodrigue, J. R., Geffken, G. R., & Morgan, S. B. (1993). Perceived competence and behavioral adjustment of siblings of children with autism. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 23, 665-674.

Sage, K. D. and Jegatheesan, B. (2010) "Perceptions of siblings with autism and relationships with them: European American and Asian American siblings draw and tell," *Journal of Intellectual and Developmental Disability*, vol. 35, no. 2, pp. 92–103.

Seligman, M. (1983). Sources of psychological disturbance among siblings of handicapped children. *The Personnel and Guidance Journal*, 61, 529-531.



**Elida TABAKU**  
 Universiteti i Tiranës  
 Tirana/Albania

## **Mesuesi si Punonjës Social dhe si Mësimdhënës: Sfidë Për Programet e Mësuesisë**

### **Abstrakt**

*Shkolla ka si mision kryesor pajisjen me dije, dhe përgatitjen e brezit të ri me aftësi dhe vlera duke krijuar një ambient motivues e përfshirës për të gjithë nxënësit, gjë që realizohet nga shërbimet e ofruara në shkolla, por në rradhë të parë nga mësuesit të cilët me qëndrimet dhe veprimet e tyre ndikojnë fuqimisht në edukimin e nxënësve.*

*Mësuesi ka detyrë dhe përgjegjësi të ofrojë arsim, edukim dhe mundësi të barabarta për secilin nxënës, pavarësisht nga niveli ekonomik, prejardhja familjare ose niveli kulturor.*

*Kjo gjë kërkon një përgatitje më të mirë të mësuesve në programet e mësuesisë, ku shpesh mësohet fakti i përgatitjes së tyre me aftësitë e nevojshme shkencore dhe metodike të lëndës së caktuar dhe jo aq sa duhet në krijimin e profesionistëve autonom dhe të aftë të reflektojnë për të vepruar si punonjës social me klasën e tyre, për të punuar me efikasitet në një realitet për ditë në ndryshim.*

*Mësuesit i duhet të trajtojë mjaft probleme të etikës në klasë, zgjidhja e të cilave varet nga mënyra se si ai i transmeton normat dhe vlerat e shoqërisë demokratike, sa i lidh këto dhe i trajton në një kuadër më të gjerë si janë familja dhe shoqëria e nxënësve.*

*Diskutimi lidhet vecanërisht në rëndësinë që merr arsimimi i mësuesve të ardhshëm për të ndërtuar një mësim ku secili nxënës të ndjehet i mirëpritur, të marrë pjesë aktive në klasë, të trajtohet si individ i veçantë dhe në mënyrë të barabartë.*

*Mos respektimi i nxënësit dhe trajtimi i tij si një individ me probleme çon jo vetëm në uljen e dashurisë së tij për lëndën dhe mësimin në përgjithësi, por e bën atë të predispozuar për zhvillimin e problemeve të ndryshme psikologjike dhe sociale.*

**Fjale Kyc:** *Mësuesi; Mësimdhënie; Programet e mësuesisë; punonjës social*

## 1-Hyrje

Shkolla ka si mision përgatitjen me dije, aftësi dhe vlera të brezit të ri duke krijuar një ambient motivues e përfshirës për të gjithë nxënësit, gjë që realizohet nga shërbimet e ofruara në shkolla, por në rradhë të parë nga mësuesit të cilët me qëndrimet dhe veprimet e tyre ndikojnë fuqimisht në edukimin e nxënësve.

Mësuesi ka detyrë dhe përgjegjësi të ofrojë arsim, edukim dhe mundësi të barabarta për secilin nxënës, pavarësisht nga niveli ekonomik, prejardhja familjare ose niveli kulturor.

Kjo gjë kërkon një përgatitje më të mirë të mësuesve në programet e mësuesisë, ku shpesh mëshohet fakti i përgatitjes së tyre me aftësitë e nevojshme shkencore dhe metodike të lëndës së caktuar dhe jo aq sa duhet në krijimin e profesionistëve autonom dhe të aftë të reflektojnë për të vepruar si punonjës social me klasën e tyre, për të punuar me efikasitet në një realitet për ditë në ndryshim.

Programet e mësuesisë synojnë të përgatisin mësues me kompetenca profesionale në gjendje për të përdorur njohuritë dhe aftësitë tyre në veprimtarinë e tyre profesionale (Laursen, 2006). Kompetencat profesionale përfshijnë tre grupe : kompetencat kyçe, kompetencat themelore dhe kompetencat speciale ose të lëndës. Një mësues kompetent do jetë i aftë të përçojë dijet dhe aftësitë të nxënësit, por njëkohësisht të shërbejë si model roli për ta.

Në "Parimet e përbashkëta evropiane për kompetencat dhe kualifikimin e mësuesve" midis të tjerave theksohet

a) nëpërmjet arsimit shumëdisiplinor të mësuesve të sigurohen: njohuri për lëndën, njohuri për pedagogjinë, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për të drejtuar dhe mbështetur nxënësit dhe kuptim të dimensionit shoqëror dhe kulturor të arsimit; b) profesioni i mësuesit të jetë një profesion i bazuar në kontekstin e të nxënësit gjatë gjithë jetës; c) një profesion që mundëson mobilitetin; d) një profesion i bazuar në bashkëpunim.

Kompetencat kyçe të mësuesve përfshijnë: 1) Kompetenca për komunikim të informacionit. 2) Kompetenca të punës shoqërore. 3) Kompetenca gjuhësore. 4) Vlerat si si individ. 5) Kompetenca kulturore. (Hutmacher, 1996).

Ndërsa kompetencat themelore përfshijnë: Kompetenca organizative, që kanë të bëjnë me aftësitë e mësuesit për të organizuar nxënësit në mënyrë efektive, për të menaxhuar dhe kontrolluar veprimtaritë e tyre mësimore dhe për të planifikuar dhe përmirësuar veprimtarinë e vet të mësimdhënies.

Kompetenca didaktike lidhet me aftësinë e mësuesit për të përçuar njohuri që e tërheqin nxënësin në lëndën mësimore, për t'ju mundësuar atyre për të vazhduar veprimtarinë mësimore në mënyrë të pavarur.

Kompetencë e mendimit pedagogjik, që lidhet me aftësinë e mësuesit për të reflektuar për veprimtarinë e tij mësimore edukative; për të parashikuar rezultatet e veprimtarisë së tij dhe për të mësuar vetë, duke kuptuar çfarë është e nevojshme për një nxënës.

Kompetencë psikologjike. Mësuesi i sotëm duhet të jetë i formuar psikologjikisht që të pranojë jetën e brendshme të nxënësit; të kuptojë personalitetin e tij unik; të ndiejë vështirësitë psikologjike të tij dhe, kur të jetë e nevojshme, të ofrojë ndihmë psikologjike.

Kompetenca si vlerësues. Mësuesi duhet të jetë i aftë për të shqyrtuar objektivisht rezultatet e nxënësve, arritjet, efikasitetin e punës së tij dhe punën e kolegëve të tij.

Kompetenca këshilluese. Mësuesi të jetë i aftë për të siguruar këshillime dhe forma të ndryshme të asistencës psikologjike-pedagogjike në procesin mësimor.

Kompetenca të zhvillimit gjatë gjithë jetës. Mësuesi të krijojë bindjen për të zhvilluar aftësitë profesionale, njohuritë dhe kompetenca gjatë gjithë jetës së tij. (European Commission, 2005).

Kompetencat e lëndës konsiderohen aftësitë e mësuesit për të realizuar kompetencat kyçe në procesin e mësimdhënies së lëndëve në shkollë. Këto përfshijnë dy komponentë: kompetenca për lëndën dhe kompetenca kërkimore.

Duke ju referuar këtyre kërkesave dhe misionit që ka arsimi në vendin tonë janë ndërtuar programet e mësuesisë të cilat ndërthurin përgatitjen e përgjithshme psikopedagogjike të mësuesit, përgatitjen e tij për lëndën si dhe aftësimin praktik dhe kërkimin. Synimi i këtyre programeve është të formohet një mësues i aftë nga ana shkencore dhe metodike, por edhe si një qytetar aktiv që synon të edukojnë me qendrimit dhe veprimet e tij.

Përgatitja e mësuesit si qytetar aktiv në edukimin e nxënësve lidhet ngushtë me kompetencat psikologjike, kompetenca si vlerësues dhe kompetenca këshilluese.

## **2-Roli i mësuesit si punonjës social**

Shoqëria sotme dhe nevojat e individit për të mësuar gjatë gjithë jetës kërkojnë një rol të ri të mësuesit, atë të trajtimit të problemeve psikosociale që lidhen me të nxënët dhe ecurinë e nxënësve në shkollë. Ky rol i ri që merr mësuesi nuk zëvendëson rolin e shërbimit psikosocial që ofrohet në shkollë, por ai ndihmon në parandalimin e problemeve të ndryshme, duke i trajtuar ato në mënyrë sistematike dhe në tërësinë e tyre.

Ky rol i ri është i lidhur ngushtë me mënyrën e shpjegimit të mësimit, me kontrollin dhe vlerësimin, me mënyrën e organizimit të orës së mësimit, gjuhës që përdoret nga mësuesi në klasë si dhe me lidhjet që krijohen me prindërit dhe me nxënësit jashtë procesit mësimor.

Në pamje të parë duket sikur këto çështje i përkasin thjesht metodikës së mësimit të një lëndë të caktuar, por qasja e tyre nga mësuesi mund të ndikojë pozitivisht e të kontribuojë në formimin e nxënësve ose ta dëmtojë rëndë atë deri në krijimin e një nxënësi me probleme psikosociale.

Ka ndodhur shpesh që dëgjojmë për një nxënësi adoleshent me probleme psikosociale, të cilin e kemi njohur ose mësuar në një moshë më të vogël, dhe ndjejmë keqardhje dhe pikëllim të thellë, por edhe zemërim për vete dhe për të tjerët, se të gjithë bashkë jemi pak fajtor që një fëmi, nxënës shumë i mirë, shfaq të tilla probleme, por nuk dihet se kur filloi problemi. Pse ndodh? Por a mund të zhbëhet kjo gjë?

Dhe këto raste na bëjnë të mendojmë dhe reflektojmë se detyra e formimit të nxënësve nuk është vetëm e psikologut dhe punonjësit social, as vetëm e familjes, në një kohë kur nxënësit e kalojnë kohën më të madhe me bashkëmoshatarët e tyre, ose në raste jo të pakta me shokë më të mëdhenj në moshë, si dhe kohën që kanë më vete e kalojnë në shoqërinë e tyre virtuale në Facebook, Twitter, What's ap. Është mësuesi ai që qëndron më shumë me nxënësit dhe më aftësitë e mjeshtërinë e tij mund të njohë më mirë nevojat e tyre dhe të këshillojë mënyra efikase për plotësimin e tyre. Mësuesi nuk duhet ta shikojë nxënësin si një mendje të re dhe bosh të cilën ka për detyrë ta mbush me njohuri, por ta shikojë e trajtojë si një individ unik, që pavarësisht nga mosha ka dëshirat, nevojat dhe përvojën e tij.

Problemet e etikës në klasë që duhet të trajtohen nga mësuesit janë të shumta dhe zgjidhja e tyre varet nga mënyra se si ai i transmeton normat dhe vlerat e shoqërisë demokratike, sa dhe si i trajton shqetësimet që shfaqen në një kuadër më të gjerë si familja dhe shoqëria e nxënësve.

### **3-Përgatitja e mësuesve të rinj në programet e mësuesisë**

Arsimimi i mësuesve të ardhshëm është baza e përgatitjes së mësuesve si profesionistë dhe punonjës shoqëror. Në këtë fazë të përgatitjes së tyre ata mësojnë si të organizojnë e zhvillojnë një mësim ku secili nxënës të ndjehet i mirëpritur, të marrë pjesë aktive në klasë, të trajtohet si individ i veçantë dhe të trajtohet drejtë. Mos respektimi i nxënësit dhe trajtimi i tij si një individ me probleme çon jo vetëm në uljen e dashurisë së tij për lëndën dhe mësimin në përgjithësi, por e bën atë të predispozuar për zhvillimin e problemeve të ndryshme psikologjike dhe sociale.

Është më mirë të ndërtohet diçka mirë, të parandalohet, sesa të kurohet me masa të tjera disiplinore ose këshillimore.

Lëndët e parashikuara në kurrikulat e arsimit parauniversitar ndikojnë fuqimisht në përgatitjen e gjithanshme të nxënësve, si me njohuri dhe aftësi të shkencave të ndryshme ashtu edhe si qytetarë të së nesërme. Shprehinë dhe aftësitë e parë të mësimdhënjes studentët e mësuesisë i marrin gjatë ndjekjes së orëve praktike të seminareve dhe gjatë praktikës në shkollat e ndryshme. Atyre u mësohet të tregojnë vëmendje si për anën metodike ashtu edhe për ndjekjen e ecurisë së secilit nxënës.

Studentët e mësuesisë ndihmohen të jenë më të vetëdijshëm ndaj problemeve që mund të vihen re në klasë dhe shënjave të shfaqjes së tyre. Problemet kryesore që disa herë nënvlerësohen janë:

1. Vështirësi emocionale si izolim, ose vetpërjashtim, të qënë i papërmbytur ose tepër i mbyllur, mungesë përqëndrimi, mungesë vet besimi, frikë ose ndjenja e pasigurisë, turp, vështirësi të përshtatjes si ankthi nga testet, zili për shokët e klasës, gjendje depresive, vështirësi për t'u shprehur.

2. Probleme të sjelljes si sjellje agresive (ngacmimi dhe dëmtimi i të tjerëve, prishja e orendive të klasës, rebelim në klasë ose shkollë, thenja e gënjeshtrove, superaktiviteti, pasivitet në klasë ose gjendje e përhumbur etj.

3. Vështirësi në mësim si mungesa e motivimit dhe interesit, qëndrim negativ ndaj shkollës dhe lëndës, frikë nga ngelja ose dështimi në realizimin e detyrave të caktuara, nota shumë të ulta, mos bërja e detyrave etj.

4. Vështirësi të komunikimit me të tjerët si konflikte me shokët e klasës, ose me mësuesit, mos krijimi i marrëdhënjeve të drejta me moshatarët duke sunduar mbi ata, paaftësi për të bërë shokë, ose për të ruajtur shoqërinë, etj.

Mos përdorimi i strategjive të drejta, ose përdorimi i kritikës së individualizuar para klasës rrezikon që këto probleme të thellohen. Probleme të tilla trajtohen veç e veç. Studentëve ju mësohen strategjitë e nderhyrjeve dhe të trajtimit të këtyre problemeve, që në fakt janë teknika të organizimit të mësimit.

### **3.1-Mënyra e organizimit të mësimit**

Mësuesi flet ballë për ballë me nxënësit, duke i inkurajuar ata dhe duke nxitur të marrin pjesë në punë në grup dhe në projekte të ndryshme. Gjatë përcaktimit të detyrës së përbashkët mësuesi vendos një detyrë për secilin nxënësi, për të cilën ai mban përgjegjësi dhe duhet të raportojë. Në këtë rast secili i ndjen veten të përfshirë në mësim dhe jo të anashkaluar.

Krijimi i një ambienti të ngrohtë, mbështetës dhe gjithë përfshirës ndikon pozitivisht te ata nxënësi që shfaqin problemet e sipërpermendura. Në këtë rast ata ndjejnë dhe kuptojnë se vlerësohen dhe respektohen nga mësuesi dhe shokët e klasës, dhe nuk janë gjithnjë dështakë.

Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësisive lidhet me dhenjen e udhëzimeve të cilat duhet të jenë të qarta e të kuptueshme. Në mjaft raste përgjigjet e dobta dhe reagimi negativ i nxënësve lidhen me mos kuptimin e kërkesës së dhënë nga mësuesi, se sa me mungesën e njohurive, ose dëshirës së nxënësve për të marrë pjesë në mësim. Nëse komunikimi për detyrën bëhet individualisht, sidomos për nxënësit që kanë vështirësi, ata e ndjejnë se mësuesi i trajton si të tjerë. Është praktikë e gabuar pyetja e përgjithshme “ E kuptuat detyrën?”, e cila sigurisht merr një përgjigje pozitive PO nga një ose dy nxënësi të përparuar, por në fakt ajo është një detyrë e pakuptuar nga pjesa më e madhe e klasës.

Një strategji tjetër e theksuar është përdorimi i lavdërimeve dhe përforsimit. Nëse vihet re çdo ndryshim pozitiv dhe ai vihet në dukje, nxënësi është më i motivuar të ndryshojë sjelljen dhe qëndrimin e tij ndaj shkolles, shokëve dhe punës.

Lidhur ngushtë me lavdërimet është edhe vlerësimi i nxënësve i cili është pjesë e pandarë e mësimit. Vlerësimi i referohet veprimtarive të ndërmarra nga mësuesi si dhe nga nxënësit ( gjatë vetvlerësimit), të cilat të japin fidbek për të modifikuar mësimdhenjen dhe të nxënësve (Black, 1998). Arritja e qëllimeve përfundimtare të vlerësimit bëhet kur mësuesi vë në dukje vlerat e punës, atë që është përvetsuar. Por gabimisht vlerësimi barazohet nga mësuesit si qortimi, dhe si rrjedhim nxënësit i shikojnë testet periodike si kurthe për ta. atyre ju shtohet ndjenja e frikës dhe pasigurisë.

Kjo situatë kërkon që mësuesi të zhvillojë një vlerësim të vazhdueshëm, konstruktiv, duke theksuar anët pozitive dhe jo dobësitë. Kjo duhet të lidhet me krijimin e atmosferës pozitive dhe interesante në klasë ku nxënësit të shijojnë suksesin dhe t'ju rritet vetbesimi.

#### 4-Lidhja me familjen

Njihet dhe theksohet prej një periudhe shuma të gjatë që prindërit luajnë një rol të rëndësishëm në suksesin e fëmijëve të tyre në shkollë dhe në përmisimin e shkollës (Epstein, 1996, Safran, 1996). Nëse shkolla bashkëpunon me familjen përfutuesit e parë janë nxënësit, dhe patjetër shoqëria. Nëse krijohet një lidhje e mira shkolla, familje dhe komunitet mësuesit janë më të mbështetur në punën e tyre, përmisohet shumë aftësia e nxënësve për të mësuar, lidhet me shumë familja me shkollën, ofrohen shërbime dhe mbështetje për familjet dhe krijohet një ambient më i sigurt në shkollë.

Lidhja me familjen nuk duhet reduktuar në një lajmërim me mesazh ose telefon për vërejtje në lidhje me mospërgatitjen e duhur, ose për thyerje të disiplinës shkollore si thithja e duhanit, lënja e orëve të caktuara të mësimit, prishja e disiplinës në klasë, ose zenkat midis adoleshentëve. Sigurisht këto kanë vlerën e tyre, por nuk mund të zëvendesojnë takimin e prindërve ballë për ballë me mësuesin dhe fëmijët e tyre. Këtu duhet nënvizuar fakti që këto takime nuk duhet të kthehen në takime gjykimesh që shpesh shmangen nga prindërit, sepse presin të dëgjojnë vetëm ankesa dhe kritika nga mësuesit e ndryshëm.

Forma më e mira që sugjerohet në praktikat me studentë është organizimi i takimeve të përbashkëta me prindër e nxënës ku të diskutohen mendime se si mund të zgjidhen vështirësitë që kanë të gjithë në klasë, pa i identifikuar këto si të një nxënësi të veçantë. Gjithashtu me interes është pjesëmarrja e tyre në veprimtari ku fëmijët e tyre janë aktorë. Kjo rekomandohet për koncerte ose konkurse në lëndë të ndryshme, për ekspozita dhe veçanërisht në paraqitjen e projekteve të ndryshme. Tani është bërë traditë që në të gjitha lëndët nxënësit punojnë me projekte, dhe në shumë raste prindërit ndihmojnë ose japin mbështetje të tyre. Përfitimet nga këto projekte janë edhe më të mëdha, nëse ftohen prindërit për të

dëgjuar nxënësit gjatë prezantimit të tyre.

Në perfundim, është e vërtetë se kurrikulat e mësuesisë janë përmisuar dhe janë ndërtuar në përputhje me kërkesat e këshillit Evropian, por edukimi i mësuesve të rinj me kodin e etikës dhe me strategji të trajtimit të problemeve psikosociale kërkon që çdo lëndë që zhvillohet në Master ta trajtojë lëndën në mënyrë të integruar, sepse objekti i të gjitha lendeve është nxënësi që nuk ka nevojë thjesht për njohuri, por për aftësi se si të veprojë si një qytetar i shekullit të komunikimit nderkulturor dhe të internetit. Atyre duhet t'u jepen aftësi se si të mësojnë gjatë gjithë jetës dhe se si të mënazhojnë stresin. Nëpërmjet reflektimit dhe ndihmës nga pedagogët mësuesit e rinj marrin jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësi se si të komunikojnë me nxënësit, sit ë përdorin gjuhën për të tërhequr dhe edukuar ata. Kjo arrihet kur mësuesi e do profesionin dhe nxënësin. Gëtë ka thënë "Trajto njërëzit sikur të ishin çfarë duhet të jenë dhe ndihmoji ata të bëhen çfarë janë të aftë të bëhen."

Krijimi i profesionistëve autonom dhe të aftë të reflektojnë për të vepruar si punonjës social me klasën e tyre, për të punuar me efikasitet në një realitet për ditë në ndryshim, për të lidhur mësimin me jetën është synimi i programeve të mësuesisë.

**Referenca**

Black, P.J. & Wiliam, D. (1998) *Inside the Black Box: Raising standards through classroom assessment*. King's College, London.

Common European Principles for Teacher Competencies and Qualifications. –  
Brussel:  
European Commission

Common European Principles for Teacher Competencies and Qualifications. –  
Brussels:  
European Commission European Commission. *Education and Training 2010: Progress Report*

Epstein, (1996) 'School family and Community partnerships: Overview and International Perspectives', paper presented to the Education is Partnership Conference, Copenhagen, Denmark, November 21-24 1996.

Hutmacher, W. (1996). *Key competencies for Europe Report of the Symposium*. Berne, Sëitlerland 27-3- March, 1996. Council for Cultural Cooperation (CDCC) a Secondary Education for Europe. *European journal of education*, Vol. 32 No1 pp. 45-58.

Laursen, P.F. (2006). *Educating the Authentic Teacher* In Lindgren, Ulla (ed.), *A Nordic Perspective on Teacher Education in a time of Societal Change: contributions from a Nordic conference that focused on the professional teacher role*. Umea University Publ., pp. 65-76.

Safran, D. (1996) *The Psychology and Politics of Parental Involvement*, Paper presented to the Education is Partnership Conference, Copenhagen, Denmark, November 21-24 1996.



**Zenel ORHANI**  
University of Tirana  
Tirana/Albania

**Valbona MUÇA**  
"A.Xhuvani, University of Elbasan  
Elbasan/Albania

**Edlir ORHANI**  
"A.Xhuvani,, University of Elbasan  
Elbasan/Albania

## Disa Çështje Themelore të Zhvillimit të Etno-Psikologjisë Shqiptare

### Abstrakt

*Në qendër të studimit me temë "Çështje themelore të zhvillimit të etno-psikologjisë shqiptare,, vihen probleme që lidhen me zhvillimin e shkencës së etno-psikologjisë në Shqipëri. Për trajtimin e kësaj teme udhëhiqemi nga parimi i historizmit, duke e vlerësuar këtë si kërkesë për të shqyrtuar me objektivitet veçoritë etno-psikologjike të kombit tonë, të cilat, parasëgjithash, janë produkt i kushteve shoqërore e historike dhe që ndryshojnë së bashku me to.*

*Studimi merr shkas nga zhvillimet e vrullshme që ndodhin në shoqërinë e sotme moderne, nga kërkesa dhe përpjekjet për integrimin e shoqërisë shqiptare, nga nevoja për t'i shqyrtuar veçoritë etno-psikologjike të shqiptarit në kushte të reja historike, duke parë në mënyrë kritike mënyrën si kanë evoluar, cilat janë format dhe risitë e reja të shprehjes së tyre. Çështjet kryesore që trajtohen në këtë temë studimore janë: traditat kulturore të shqiptarëve, funksionet e vetëdijes kombëtare, veçori të temperamentit dhe të karakterit të shqiptarit, krenaria kombëtare, veçori të sjelljes dhe jetës psikike të bashkësisë etnike shqiptare, stereotipet e sjelljes së shqiptarit e të tjera, që e dallojnë atë nga nga popujt e tjerë.*

*Tema ndërtohet mbi mjaft të dhëna e dokumente të shkruara, duke bërë analiza kritike e reflektive realiste rreth trashëgimisë etno-psikologjike dhe duke patur ambicie për ruajtjen dhe vazhdimësinë e saj në ardhmen. Ajo synon të orientojë drejt, sidomos brezat e rinj, duke përcjellë tek ata mesazhin për të njohur e mësuar më mirë historinë e popullit tonë, kulturën e tij shpirtërore, ruajtjen e origjinalitetit, të dokeve, zakoneve dhe tipareve të veçanta të personalitetit.*

**Fjalë kyç:** *Etno-psikologji; Tradita kulturore; Veçori të Temperamentit dhe të karakterit; Krenari kombëtare; Doke; Stereotipe të sjelljes e të tjera.*

## 1-Hyrje

Në qendër të studimit me temë “Disa çështje themelore të zhvillimit të etno-psikologjisë shqiptare,, vihen probleme që lidhen me zhvillimin e shkencës së etno-psikologjisë në Shqipëri. Në trajtimin e kësaj teme udhëhiqemi nga parimi i historizmit, duke e vlerësuar këtë si kërkesë për të shqyrtuar me objektivitet veçoritë etno-psikologjike të popullit tonë, të cilat, parasëgjithash, janë produkt i kushteve shoqërore e historike dhe që ndryshojnë së bashku me to.

Studimi merr shkas nga zhvillimet e vullshme që ndodhin në shoqërinë e sotme moderne, nga kërkesa dhe përpjekjet për integrimin e shoqërisë shqiptare, nga nevoja për t’i shqyrtuar veçoritë etno-psikologjike të shqiptarit në kushtet e reja historike, duke parë në mënyrë kritike mënyrën si kanë evoluar, cilat janë format dhe risitë e reja të shprehjes së tyre. Çështjet që trajtohen në këtë temë studimore lidhen ngushtë me traditat kulturore të shqiptarëve, me funksionin e vetëdijes kombëtare, me veçori të sjelljes dhe jetës psikike të bashkësisë etnike shqiptare, me veçori të temperamentit dhe të karakterit shqiptar e të tjera. Në këtë vështrim, tema synon të përcjellë sidomos tek brezat e rinj mesazhin për të njohur e mësuar më mirë historinë e popullit tonë, kulturën e tij shpirtërore, ruajtjen e origjinalitetit dhe tipareve që e bëjnë atë të veçantë.

Tema ndërtohet mbi mjaft të dhëna e dokumente të shkruara, bën analiza kritike e reflektive realiste rreth cilësive etno-psikologjike të popullit shqiptar dhe synon të zgjojë ambicie më të forta për ruajtjen dhe vazhdimësinë e tyre në ardhmen. Studiuesit tanë të kësaj fushe theksojnë se “historia e zhvillimit të mendimit etno-psikologjik shqiptar mbetet ende e hapur, detyrë e së ardhmes,, (Abdiu, 1939). Tek ne ka pak studime të mirëfillta e thelluara dhe, veçanërisht në kushtet e sotme që përjeton populli ynë, bëhet mëse e nevojshme që të nxiten kërkimet edhe në këtë fushë. Punimi ynë synon të japë një kontribut modest në këtë drejtim, duke bërë një sistemim të disa çështjeve themelore të lidhura me problematikën specifike që paraqet kjo fushë interesante kërkimi.

E vërteta është se çështje të etno-psikologjisë janë ngritur me forcë në periudha të vështira historike që ka kaluar kombi shqiptar. Pikërisht në momente të tilla historike ka lindur nevoja për të evokuar të kaluarën, vlerat dhe cilësitë e veçanta të shqiptarit. Edhe rrethanat e sotme historike që përjeton populli ynë e kërkojnë një gjë të tillë. Për të konkretizuar këtë ide, mjafton të kemi parasysh fakte apo të dhëna të tilla që nxitin mendimin dhe gjykimin tonë rreth çështjeve të etno-psikologjisë shqiptare:

Së pari, përpjekjet e para për trajtimin e çështjeve të etno-psikologjisë së popullit tonë i gjejmë tek veprat e autorëve të vjetër shqiptarë si Gj. Buzuku, M. Barleti, F. Bardhi, P. Bogdani e të tjerë si dhe tek rilindasit tanë. Të gjithë këta, në veprat e tyre letrare apo dhe me karakter historik, vlerësojnë dhe përpiqen të lartësojnë cilësi të tilla të konstitucionit psikik apo shpirtëror të shqiptarit si dashuria për atdheun, ndjenja e gatishmërisë për të sakrifikuar për të, krenaria kombëtare, trimëria, dëshira për të qenë i lirë dhe i pavarur, mençuria apo zgjuarsia e të tjera. Abdyl Frashëri psh. në kohën e tij shkruante se “shqiptarët kanë ruajtur atdheun e tyre, kombësinë

e tyre, gjuhën e tyre dhe zakonet e tyre, duke sprapsur në kohët barbare sulmet e romakëve, të bizantinëve dhe venedikasve. Si mund të lejohet që në këtë shekull të diturisë dhe të qytetërimit një komb kaq trim dhe kaq i lidhur me truallin e tij të sakrifikohet...,, (Akte, 1978, p. 83) Po kështu, jo pa qëllim, rilindasit tanë kanë vënë në dukje, duke argumentuar lashtësinë dhe vitalitetin e popullit shqiptar. Ata theksonin se përbërësit e strukturës psikike të popullit tonë janë të lashtë, ndërsa popujt e vendeve të zhvilluara i kanë humbur me kohë cilësi të tilla. Si reagim ndaj një dukurie të tillë, Pashko Vasa në veprën e tij "Shqypnia dhe shqyptarët,, shprehet se populli shqiptar nuk duhet "të humbasë tipin e tij karakteristik, doket, legjendat dhe gjuhën e vet. Këto janë të vetmet që na lanë trashëgim etërit tanë. Dëshirojmë t'i ruajmë,, (Vasa, 1987). Kjo ishte një dëshirë jo vetëm e tij, por e gjithë shqiptarëve që jetonin brenda apo jashtë vendit të tyre. Në këtë kohë, edhe Zef Jubani, duke iu referuar shqiptarëve të shpërngulur në Itali i vlerëson ata si njerëz me karakter të fortë dhe që "kanë ditë me ruejtë krejt të pa prekura cilësitë morale nga stërgjyshërit, megjithëse të shpërngulur në dhena të tjera, të banueme nga njerëz me doke të tjera, me zakone të tjera dhe me prirje të tjera,, (Zef, 1966). Theksojmë se vlerësime të tilla marrin vlerë aktuale, po të kemi parasysh lëvizjet e mëdha të popullsisë shqiptare në vitet e tranzicionit historik, brenda dhe jashtë vendit.

Së dyti, sot, në kohët moderne, pranohet se shekulli XXI ka nisur të flasë më shumë për shqiptarët, të cilët duhet të ndjekin rrugën paqësore e demokratike të integritimit europian, rrugën e bashkëpunimit, të dialogut, të tolerancës e miqësisë sidomos me popujt e Ballkanit. Nuk duhet harruar se në këto kohë shqiptari, në mjaft raste, ndjehet edhe i fyer dhe i poshtëruar nga fqinjët. Shpesh, i mohohet e kaluara e tij historike, cilësohet si i egër dhe pa kulturë. Madje sot, në kohët e civilizimit modern, vihen re edhe përpjekje nacionaliste apo ksenocentriste për të eliminuar vlera dhe cilësi të popullit tonë, të cilat i gjejmë të gdhendura në veprat e trashëgimisë kulturore apo në simbolet e historisë tonë. I theksojmë këto fakte, pasi në vështrimin tonë etno-psikologjik, nga njera anë, vitet e fundit në psikologjinë e njerëzve tanë, nga pasiguria e jetës dhe disniveli ekonomik vazhdojnë të ngrehin krye mjaft shfaqje të theksuara të intolerancës, ndjenja të armiqësisë, të hakmarrjes dhe të urrejtjes ndaj njeri - tjetrit e të tjera. Të gjitha këto favorizohen nga varfëria ekonomike, nga lëvizjet e pakontrolluara urbane dhe përzjerja e popullsisë, nga dallimet krahinore dhe kulturore, nga probleme të pronësisë ende të pazgjdhura, nga lufta e ashpër politike dhe polarizimi artificial që i bëhet shoqërisë nga forcat politike, nga dëshira e një shtrese të shoqërisë për pasurim të shpejtë në dëm të pjesës tjetër e të tjera dukuri negative. Pra, procesi integrues ka evidentuar edhe një varg problemesh, mendësish e paragjykime sociale, të cilat evidentohen mjaft qartë në këtë stad të zhvillimit, prandaj është mëse e nevojshme që këto dukuri të bëhen objekt i analizave, pse jo, dhe i qëndrimeve kritike nga studiuesit e specialistët tanë. Nga ana tjetër, procesi integrues i vendit tonë ka hapur vizione të reja në fushën e edukimit demokratik qytetar dhe kërkon zhvillimin e vlerave të reja qytetare për të arritur nivele të përafërta me ato të vendeve të demokracive perëndimore. Një gjë e tillë shtron me forcë detyrën e ngritjes cilësore të punës së strukturave që merren me edukimin qytetar, dikton politika të qarta sociale e kulturore, detyra më specifike për punën e shkollës si institucion i specializuar edukimi e të tjera.

Së treti, integrimi ka krijuar mundësi reale për lëvizjen e lirë të njerëzve tanë. Tani mund të thuhet se edhe për shqiptarët ka mundësi më të mëdha komunikimi, për shkëmbim vlerash, për punësim e shkollim edhe jashtë vendit. Bashkë me këto lëvizje shprehen dhe transmetohen edhe vlera, pse jo edhe antivlera, ndaj të cilave duhen bërë vlerësime e analiza shkencore, por duhen mbajtur edhe qëndrime të matura ndaj dukurive negative. Në këtë drejtim, është e nevojshme të merren edhe një varg masa mbështetëse nga shteti shqiptar për qytetarët tanë, që këta të ndjehen edhe më të sigurtë, të ruajnë dinjitetin dhe krenarinë kombëtare ngado e kudo shkojnë.

## 2-Disa veçori tipike etno-psikologjike të popullit shqiptar

Zhvillimi i karakterit dhe tipareve të një populli janë të lidhura ngushtë me kushtet historike e gjeografike, me nivelin e zhvillimit ekonomik e kulturor dhe ndryshojnë gjatë etapave të ndryshme të historisë së një populli. Ato kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në formësimin e dokeve, mënyrave të jetesës, të organizimit shoqëror dhe në formimin e ndërgjegjes kombëtare e të moralit shoqëror, i cili në rrjedhat e historisë ka përcaktuar se ç'është e mirë apo e keqe, ç'është e pranueshme apo e papranueshme në shoqërinë shqiptare, duke krijuar kështu individualitetin, shije origjinale, mendësi, doke, zakone e paragjykime të caktuara. Në këtë kuptim, sipas studiuesve tanë "Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut,, jep një kuadër mjaft të gjerë të botës shqiptare. Në të ka të dhëna që kanë të bëjnë me psikologjinë e popullit, sidomos me vetëdijen e lartë patriotike të shqiptarëve, me doket e zakonet, me legjendat e folklorin, me botën dhe jetën e tij shpirtërore,, (Aleks, 1985). Por e veçanta është se, në përgjithësi, në kontekstin shqiptar për shekuj e vite të tëra "ndërgjegja e popullit shqiptar ngre krye kundër idesë së nënshtrimit,,(Akte et al., 1978, p. 67). Prandaj, gjatë procesit historik, për zhvillimin e etnisë dhe për formimin e kombit shqiptar, duhet theksuar se tiparet etno-psikologjike të shqiptarëve në tërësi janë formësuar e zhvilluar nën presione të jashtme sistematike, duke u shoqëruar me reagime e rezistencë popullore për të siguruar vetëkëmbësishmësinë e mbijetesën si popull. Në këtë vështrim, mendojmë se një rol të rëndësishëm në kultivimin e tipareve etno-psikologjike të popullit tonë kanë luajtur edhe kuvendet e burrave shqiptarë. E veçantë për to ka qenë se respektonin elementet etnografikë, normat etiko-morale që ishin të njohura e të pranuar prej të gjithëve. Ato zhvilloheshin, sipas traditave e dokeve thjesht shqiptare në përputhje me mentalitetin e lashtë, me normat kanunore e sjellje të veçanta shqiptare. Në fakt, kuvendet kanë qenë ndër përbërësit kryesorë të veteqeverisjes sipas zakoneve dokësore shqiptare të ruajtura deri në mesin e shekullit XX. Mënyra se si shqiptarët e asaj kohe komunikonin e merreshin vesh, maturia në pleqërimin e problemeve, shoshitja mirë e çështjeve të luftës, respekti për mendimet dhe personalitetin e bashkëbiseduesit, kolegjaliteti në marrjen e vendimeve përfundimtare, gatishmëria për të vepruar në përputhje me to e të tjera, të gjitha këto, flasin edhe për vlera etno-psikologjike që shpreheshin e kultivoheshin brez pas brezi. Ato dëshmojnë për një traditë etno-kulturore të vyer, për një model në organizimin dhe zhvillimin e këtyre kuvendeve në shkallë rajonale e kombëtare. Këto tradita dokësore shqiptare pasqyrohen mjaft qartë dhe me mjeshtëri artistike nga Gjergj Fishta, autori i Lahutës së Malsisë, sidomos në vargjet kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e plot

tubimeve të tjera të shqiptarëve si dhe në vargjet kushtuar figurës së luftëtarëve shqiptarë. Më poshtë, e ndjemë të nevojshme të përmbledhim dhe të përshkruajmë më konkretisht disa nga veçoritë më tipike etno-psikologjike të popullit tonë, të cilat janë ngulitur thellë në psikologjinë e tij, por duke nënvizuar edhe aspekte të evoluimit të tyre në përshtatje me kushtet dhe rrethanat historike që ndryshojnë.

### **2.1 Lidhja me tokën**

Shqiptarët, si popull autokton, tradicionalisht kanë si tipar kryesor të qenit lidhur fort me tokën, me trojet dhe vendlindjen e tyre. Ata dëshironin të ndjeheshin të lirë dhe të qetë vetëm në tokën e tyre dhe për këtë kanë krijuar plot këngë, legjenda e mite. Në rast rreziku ngriheshin të gjithë me armë në dorë për mbrojtjen e lirisë dhe vatrave apo territoreve, të cilat bëheshin pre e synimeve shoviniste të fqinjëve, duke ruajtur nderin dhe dinjitetin, krenarinë kombëtare dhe shpirtin e mos-nënshtimit përpara të huajit. E vërteta është se shqiptarët e kanë përjetuar dramën e coptimit të trojeve të tyre nga fuqitë e mëdha. Këshu ndodhi psh. në vitin 1913, por pavarësisht nga kjo, etnitë shqiptare që mbetën jashtë kufijeve të tokës mëmë kanë ruajtur me fanatizëm veçoritë karakteristike të shqiptarit dhe dëshira e tyre ka qenë ribashkimi i trojeve tona. Rrethanat janë të tilla që sot po ngrihet më fort kërkesa për të korrigjuar këtë gabim të historisë që kanë bërë fuqitë e mëdha. Aktualisht sot, bashkimi i trojeve dhe etnive shqiptare në një territor të vetëm po bëhet çështje dhe problem që kërkon zgjidhje. Sjellim nëpër mend përpjekjet që bëhen sot në këtë drejtim nga grupime apo forca të ndryshme politike për bashkimin e etnisë dhe trojeve shqiptare.

### **2.2 Atdhedashuria.**

Dashuria për atdheun është një veçori tjetër e shqiptarit. Kjo lidhet ngushtë me kushtet e veçanta gjeografike të trojeve shqiptare. Vetë pozicioni gjeografik i Shqipërisë ofron një territor të larmishëm, me male, fusha, det, burime të pasura mbitorësore e nëntokësore, klimë mesdhetare e të tjera. Por, Shqipëria ka një pozicion gjeo-politik delikat, i cili, nga njera anë, ka pasuruar karakterin e shqiptarit, veçoritë e tij etnike dhe, nga ana tjetër, ky pozicion gjeografik ka qenë i lakmuar nga pushtuesit. Vetë shqiptarët e pëlqejnë natyrën e tyre të bukur, e duan, e mbrojnë dhe kanë sakrifikuar për të. Ata e kanë shprehur dashurinë për atdheun sa herë ai është kërcënuar nga jashtë (Kështu ka ndodhur nga Lashtësia deri në Luftën e Dytë Botërore), i kanë shërbyer atdheut atje ku ai ka pasur nevojë (Kështu ka ndodhur në periudhën e socializmit), përpiqen të ruajnë dinjitetin dhe krenarinë e të qenit shqiptar (Në kushtet e lëvizjes së lirë dhe integritit të sotëm).

### **2.3 Burrëria e trimëria**

Burrëria dhe trimëria janë tipar tjetër i moralit popullor dhe karakterit të shqiptarit. Këto cilësi kanë evoluuar, duke marrë një kuptim më të gjerë. Të jesh burrë apo trim nuk do të thotë vetëm t'i dalësh zot dhe ta mbrosh atdheun me armë në dorë, nëse atij i kanosen rreziqe nga jashtë. Kuptimi tjetër është të jesh njeri i fjalës dhe i veprave, të jesh i mençur, të përdorësh diplomacinë, të jesh këmbëngulës, t'u vësh gjoksin vështirësive dhe jo të fshihesh prej tyre e të tjera. Kështu, duke iu referuar historisë së të parëve, rilindasit tanë synonin të ngjallnin tek bashkëatdhetarët ndjenjat e dashurisë e krenarisë kombëtare dhe i ftonin ata për të treguar guxim e trimëri për

mbrojtjen e trojeve arbërore, ashtu siç kishin treguar të parët tanë ndër shekuj. Pra, në rrjedhën e shekujve, karaktere të tilla etnike, burrërore, të forta trashëgonin dhe kultivonin shqiptarët ndër breza. Ky karakter solid e i papërkur i shqiptarëve me shpirtin luftarak e liridashës, krahas gjuhës shqipe, ka qenë, ndër shekuj një prej atyre faktoreve determinantë të ruajtjes së identitetit të shqiptarëve (Kolë, 2011).

#### **2.4 Qytetërimi dhe besa e shqiptarit**

Tek shqiptarët besa konsiderohet si një akt njerëzor, si tregues i mirëkuptimit dhe civilizimit shqiptar. Vlerësime të shumta për këtë cilësi gjejmë në urtësinë popullore, në këngët popullore të trimërisë ku u thuren lavdi trimave, në përralla e proverbat popullore. Besa ishte një premtim i dhënë dhe vepronte fuqishëm edhe pse nuk ishte e shkruar në ndonjë dokument apo traktat të veçantë. Sipas studuesve tanë “Besa në anë të thelbësore pozitive ka luajtur rol si mjet lidhesh shoqërore, krahinore e ndërkrahinore për kapërcimin e grindjeve dhe vllazërimit në luftën për çlirimin kombëtar e shoqëror dhe ka ndikuar në përpunimin e ndërgjegjes kombëtare,, (FESH, 1985).

Historikisht, besa ka qenë testamenti moral i shqiptarëve qysh prej periudhave të hershme mitologjike. Dy baladat më të rëndësishme të folklorit shqiptar, me motivin e murimit dhe motivin e ringjalljes (flijimi për ngritjen e një kalaje dhe ngritja e vëllait nga varri për të kthyer motrën në familje) lidhen me mbajtjen e fjalës së dhënë. Nëse merret në analizë e kaluara e popullit shqiptar, të gjitha momentet kulmore të historisë sonë kombëtare janë shoqëruar me besëlidhje. Ideali kombëtar, bashkimi dhe besa shihen si hallka të pashkëputura të një zinxhiri që lidheshin drejtpërdrejt me atdhetarizmin e popullit tonë dhe me mbijetesën e tij. Kështu ka ndodhur gjatë rezistencës shqiptare në kohën e Skënderbeut për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit osmanë, kështu ndodhi në vitet e Lidhjes së Prizrenit gjatë lëvizjes mbarëkombëtare për liri e shpalljen e shtetit të pavarur shqiptar në Vlorë më 1912 e të tjera. Veç kësaj, shqiptarët e kanë përdorur besën edhe për të eliminuar apo për të pakësuar mjaft dukuri negative të shfaqura në shoqëri si lakmia, hakmarrja, smira, egoizmi e të tjera. Sot, në kohët moderne, ka prirje nënvleftësuese, duke e quajtur besën si cilësi që u takon kohëve të shkuara. Duket se kjo cilësi e shqiptarëve merr prirjen e tolerancës, të mirëkuptimit e dakortësisë e bashkëpunimit.

#### **2.5 Mikpritja**

Mikpritja ka qenë dhe është një cilësi tradicionale e shqiptarit. Ajo cilësohet si kodi i nderit tek shqiptarët dhe është e shprehur edhe në Kanun. Për të paraqitur vlerat e nderit e “derës” së tij, shqiptari vendoste që në momentin kur fillonte të ndërtonte shtëpinë. Ai rezervonte vendin më të mirë, Odën e miqve, e cila duhej të plotësonte disa kushte: t’i binte drita e dielli, të ishte e suvatuar, e shtruar, e gdhendur bukur, e pajisur mirë me shtroje. Madje, kafja, sheqeri dhe rakia duhet të ishin të pranishme në çdo kohë në odën e miqve. Miku pritej me të gjitha nderet e me ushqimet më të mira që kishte shtëpia. Shqiptarët e kultivojnë dhe e zbatojnë virytin e mikpritjes, respektimin e sigurimin e mikut që u ka ra në prag, me gatishmërinë për të sakrifikuar gjithçka, pasurinë e deri edhe jetën për të. Shumë të huaj i kanë vlerësuar mikpritjen dhe bujarinë e shqiptarit. Ata kanë lenë dhe mjaft dokumente të shkruara për këtë cilësi, duke i vlerësuar shqiptarët si dashamirës dhe njerëzorë nga vetë natyra, si besnikë, të përzemërt, shumë të sinqertë dhe gjithmonë krenarë

për origjinën e tyre. Kështu psh. në veprën “Shqipëria e lashtë”, Ugolini L. shkruan: “Shqiptari pret mysafirë me shumë kënaqësi. Edhe kur është i varfër, ai mirëpret në mënyrë shumë dinjitoze dhe të përzemërt udhëtarin e panjohur që troket në portën e tij”, (Ugolini, 2009). Me këtë cilësi karakteristike shqiptari shpreh shpirtin e një qenie njerëzore të civilizuar dhe karakterin e tij human, që shkon përshtat me vlerat e shoqërisë së sotme moderne, prandaj vlerësohet shumë nga të huajt që vizitojnë Shqipërinë e sotme.

## **2.6 Toleranca fetare**

Edhe pse rrethanat historike i kanë ndarë shqiptarët në fe të ndryshme, ata kanë kultivuar tolerancën fetare midis tyre, duke e kthyer këtë në një cilësi që i bën disi të veçantë nga kombet e tjera. Shqipëria është ndoshta i vetmi vend ku kanë jetuar e jetojnë 3-4 grupime të mëdha të komuniteteve fetare: myslimanë 60-70%, katolikë 10%, ortodoksë 20% si dhe bektashinjtë. Shembuj të shumtë tregojnë e ilustrojnë harmoninë fetare të shqiptarëve dhe besimeve të tyre. Shqiptarët festat fetare i bëjnë së bashku, brenda dhe jashtë familjes, duke qenë në harmoni me njeri tjetrin. Sipas studiuesve tanë, megjithëse jemi një popullsi me afro 70% myslimanë, kjo nuk

është tradicionalisht origjinale, pasi kujtesa e largët fetare shqiptare është kristianizmi, i cili ruhet ende në kujtesën e popullit. “Shqiptari, qoftë katolik, ortodoks ose mysliman e urren si sundimin turk, ashtu edhe çdo sundim tjetër të huaj. Ashtu si nuk jemi dhe nuk duam të jemi turq, ashtu e kundërshtojmë me të gjitha forcat tona cilindo që do të na bënte sllavë ose austriakë a grekë. Ne duam të jemi vetëm shqipëtarë”, (Akte et al., 1978, p. 21,23). Pra, historikisht, ndarja e shqiptarëve në fe të ndryshme ka qenë strategji përçarëse e pushtuesve, pasi duke i përçarë, mund t'i sundoje më mirë shqiptarët. Toleranca fetare si cilësi e shqiptarit është konkretizuar në momente të vështira, kur shqiptarët janë bashkuar pa dallim feje, krahine apo ideje. Në këtë vështrim, feja e shqiptarit ka qenë dhe është shqiptaria.

## **2.7 Ndhima shoqërore e solidaritetit**

Shqiptarët kanë patur dhe e ruajnë prirjen e të gjendurit pranë njeri tjetrit, duke marrë pjesë në gëzime e sidomos në hidhërimet. Kjo cilësi është trashëguar ndër breza dhe ka vlerë, pasi shërben si një mbështetje psikologjike sidomos për atë derë që i ka ndodhur fatkeqësia. Ky mentalitet gjen shprehjen e tij në thënien “dasma e morti nuk kalohen pa miq e pa shokë”. Pra, në vetvete, një cilësi e tillë është shprehje e humanizimit, e solidaritetit dhe afekcionit njerëzor. Kjo cilësi e shqiptarit bie në sy edhe në mjaft situata të tjera kur njerëzit përfetojnë ceremoni e rite zakonore të gëzueshme apo kur dëmtohen nga fatkeqësi të ndryshme natyrore.

## **2.8 Përsëndetjet, betimet, urimet, falenderimet dhe mallkimet.**

Në konstitucionin shpirtëror e psikik të shqiptarit zënë vend edhe një larmi përsëndetjesh, betimesh, urime, falenderime dhe mallkime të ndryshme, të cilat janë disi të veçanta. Të gjitha këto bëjnë pjesë në mënyrat stereotipe të sjelljes dhe të qëndrimeve që mbajnë shqiptarët, jo vetëm ndaj bëmave e sjelljes së njerëzve të njohur, por edhe ndaj të panjohurve. Ato, duke shënuar cilësi karakteristike të tij, shprehin mbështetje, gatishmëri, sinqeritet, vetshpreje, siguri, anagazhim, miratim,

dakortësi apo jodakortësi si dhe marrje përgjegjësie. Le të përmendim disa prej tyre:

- Përsëritjet e tilla si: Tungjatjeta, Mbetsh me shëndet, Qofsh mirë, A je burrë, Si u gdhive,
- Si u ngryse e të tjera janë shumë interesante, njerëzore dhe të bukura.
- Betimet kanë forma të tilla si psh. “Për këtë qiell e për këtë dhe!”, “Pashë një a’t diell!”, “Më djegtë e më përvëltoftë!”, “Për a’t diell që është lodh!”, “ Për Tomorr!”, “ Për flamur!” etj.
- Urimet, falenderimet dhe mallkimet e shqiptarit që janë disi të veçanta. Letë përmendim disa

prej tyre: “Qofshi faqe-bardhë!”, “Qofsh i nderuar!”, “U trashëgoftsh!”, “U bëftë katund!” (thuhet kur lind djalë). Për një derë pa dinjitet thuhet “Ju mbylltë dera!”, “Ju shoftë zjarri në vatër!”, “Mos pafsh ditë të bardhë me sy!,,. Në Myzeqe “Mbeç pa grua në pleqëri, pa gunë në dimër, pa dhallë në verë!”.

Pra, të gjitha këto fjalë e shprehje janë me ngarkesë emocionale janë pjesë e jetës dhe komunikimit të përditshëm, shprehin përmbajtje të caktuara, krijojnë atmosferë miqësore, mbështetje e ngrohtësi shoqërore, përjetime estetike e të tjera.

### 3-Konkluzione

- Etno-psikologjia shqiptare është shkencë e re, por mendimi etno-psikologjik shqiptar është i lashtë dhe mjaft i pasur. Nuk janë bërë përpjekje serioze për ta sistemuar dhe për ta studiuar në prizmin historik. Atë ne e gjejmë kryesisht në vepra të figurave të shquara të kombit shqiptar, në
- veprat letrare të krijuesve tanë, si dhe në vlerësime që bëjnë personalitete të huaja, të cilët kanë vizituar Shqipërinë para çlirimit dhe më vonë.
- Hapat e para për përshkrimin e veçorive etno-psikologjike të popullit tonë i gjejmë tek veprat e autorëve të vjetër shqiptarë si Gj. Buzuku, M. Barleti, F. Bardhi, P. Bogdani e të tjerë. Këta vlerësojnë dhe lartësojnë mjaft cilësi të konstitucionit psikik apo shpirtëror të shqiptarit si dashuria për atdheun, ndjenja e gatishmërisë për të sakrifikuar për të, krenaria kombëtare, trimëria, dëshira për të qenë i lirë dhe i pavarur, mençuria apo zgjuarsia e të tjera.
- Në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare rilindasit tanë kanë vënë në dukje dhe kanë argumentuar lashtësinë dhe vitalitetin e popullit shqiptar. Në kohën e tyre ata theksonin se përbërësit e strukturës psikike të popullit shqiptar janë të lashtë dhe bënin thirrje për t’i ruajtur ato, ndërkohë që disa popuj të vendeve të zhvilluara i kishin humbur me kohë cilësi të tilla. (Kujtojmë këtu kontributin e Z. Jubani, J. De Rada, P. Vasa, N. Frashëri. Më pas, në vitet e Pavarësisë L. Gurakuqi, N. Mjeda, F. Noli, A. Xhuvani e të tjerë).
- Në stadin e sotëm të zhvillimit vihen re prirje që synojnë zbehjen dhe shpërftyrimin e mjaft cilësive të vyera që kanë karakterizuar shqiptarin në shekuj. Në këtë stad të zhvillimit dhe të demokracisë në realitetin shqiptar, në komunikimet midis njerëzve, në marrëdhëniet familjare dhe ato shoqërore, në debatet publike e të tjera vihen re shfaqje të arrogancës, mosrespektim i mendimeve të tjetrit, mungesë e theksuar tolerance, nivel i ulët socializimi.
- Në kohët moderne vihen re edhe përpjekje nacionaliste apo ksenocentriste për të eliminuar vlera dhe cilësi të popullit tonë, të cilat janë gdhendur në



veprat e trashëgimisë kulturore apo në simbolet e historisë tonë. Sot besa, nderi e burrëria po quhen si cilësi të vjetëruara dhe si tregues të prapambetjes shoqërore” (!). Veç kësaj, në kohët moderne vihen re edhe lëvizje apo emigrime të popullsisë shqiptare, shprehen edhe vlera apo antivlera, ndaj të cilave duhen mbajtur qëndrime e duhen bërë analiza shkencore.

- Është mëse e nevojshme të mësohet më mirë historia e popullit tonë, të transmetohet më shumë informacion për kulturën shpirtërore, për vlerat kombëtare që kemi si popull. Në këtë nismë duhet të marrin pjesë dhe të anagazhohen forca të tilla intelektuale si sociologë, etnologë, politologë, shkrimtarë e studiues të tjerë të fushave të albanologjisë.
- Duke goditur me fakte dukuritë negative që vihen re në shoqërinë e sotme, është e nevojshme që shkolla, institucionet e tjera edukative në Shqipëri e në trojet shqiptare, të këmbëngulin për t’u mësuar të rinjve qytetërimin shqiptar, vlerat pozitive të etno-psikologjisë tonë shekullore, të cilat janë ruajtur e transmetohen brez pas brezi.

**Referenca**

Abdiu, N. Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939), faqe 140.

Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912, Tiranë, 1978, faqe 21,23.

Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912, Tiranë, 1978, Memorandumi i Lidhjes Shqiptare dërguar Fuqive nënshruese të Traktatit të Berlinit, dokumenti 43, faqe 83.

Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912, Tiranë, 1978, Memorandumi i 22 tetorit 1878, dokumenti 32, faqe 67.

Buda Aleks. Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut,, FESH, Tiranë, 1985, faqe 375.

FESH. Zëri "Besa,, Tiranë 1985, faqe 80.

Jubani Zef. Kundrime mbi gjendjen morale e mbi kulturën intelektuale të popullit shqiptar, Vepra të zgjedhura, Tiranë, 1966, faqe 83-84.

Pashko Vasa. Shqypnia dhe shqyptarët, Vepra letrare 1, Tiranë 1987, faqe 133.

Tahiri Kolë. Dukuri etno-psikologjike në Lahutën e Malësisë të Gjergj Fishtës (III), 2011, faqe.

Ugolini L. Shqipëria e lashtë, Tiranë, 2009, faqe 16,17.

**Ledia KASHAHU (XHELILAJ)**  
 Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës,  
 Durres/Albania

**Theodhori KARAJ**  
 Universiteti i Tiranës  
 Tirana/Albania

## **Perceptimet dhe Qendrimet e Mësuesve dhe Drejtuesve të Shkollave 9-Vjeçare mbi Fenomenin e Bullizmit**

### **Abstrakt**

*Bullizmi është cilësuar në të gjithë botën si një problem tepër i mprehtë dhe shqetësues (Nicolaides, Toda, dhe Smith, 2002). Kohët e fundit opinionin publik është tronditur, por edhe profesionistët kanë filluar të shqetësohen për aktet e dhunshme dhe sigurinë në shkollat shqiptare. Studimi në fjalë është një përpjekje modeste për të kuptuar në mënyrë empirike këtë fenomen në shkollat tona.*

*Ky studim ka natyrë eksploruese dhe synon që përmes metodave cilësore të zbulojë njohjen që kanë mësuesit dhe drejtuesit e shkollave 9-vjeçare mbi fenomenin e bullizmit, perceptimet dhe qëndrimet e tyre mbi të, si dhe të shqyrtojë programet e kurseve të fakulteteve të mësuesisë në të dy nivelet, për të parë nëse në të përfshihen ose jo njohuri teorike apo praktike mbi fenomenin. Kampioni i këtij studimi janë mësuesit (N=44) dhe drejtuesit e shkollave 9-vjeçare të qarkut të Durrësit, Fierit dhe Beratit (N=9). Për realizimin e këtyre qëllimeve kërkimore u shqyrtua literatura e fushës, u studiuan programet universitare të fakulteteve që përgatisin mësues si dhe u realizuan intervista të gjysmë të strukturuar nga intervistues të cilët u trajnuan për këtë qëllim.*

*Rezultatet tregojnë se edhe pse fenomeni është i pranishëm në punën e përditshme të mësuesve dhe drejtuesve, mungesa e njohjes së thelluar ndaj tij, i bën mësuesit dhe drejtuesit të mbajnë qëndrime rastësore dhe kryesisht ekstreme (indiferentizëm, ose masa ekstreme për ndërprerjen e fenomenit). Pjesa më e madhe e mësuesve mendojnë se këto situata mund të zgjidhen nga ata, në disa raste edhe në bashkëpunim me prindërit. Ndërsa drejtuesit kryesisht mendojnë se si bullët edhe viktimat kanë nevojë për t'u trajtuar nga psikologët e shkollave. Nga shqyrtimi i programeve universitare të fakulteteve që përgatitin mësues (BA dhe MND) rezulton se në asnjë prej kurseve nuk është planifikuar të trajtohet ky fenomen edhe pse është një çështje që lidhet drejtpërdrejt me menaxhimin e klasës dhe kompetencat profesionale të mësuesit.*

*Bazuar në gjetjet e këtij studimi rekomandohet një fushatë sensibilizuese për nxënës, prindër dhe personelin pedagogjik, si dhe trajnimi i drejtuesve dhe i mësuesve për njohjen në baza shkencore të fenomenit, pasojat e tij afatgjata si dhe të mënyrave me efikase për trajtimin e nxënësve. Për të pasur një perspektivë me të mirë në të ardhmen duhet të rishikohen kurrikulat e fakulteteve të edukimit në të gjithë vendin, me qëllim që në to të përshihen njohuri të teorike dhe praktike mbi fenomenin e bullizmit, në mënyrë që të mësuesit dhe drejtuesit e së ardhmes të kenë përgatitjen e nevojshme për t'u përballur me sukses me këtë fenomen.*

**Fjalët Kyçe:** *Fenomenii Bullizmit; Perceptimet e Mësuesve; Qëndrimet e Mësuesve; Perceptimet e Drejtuesve; Qëndrimet e Drejtuesve.*

## 1-Hyrje: Vështrim i përgjithshëm

Kohët e fundit kanë ndodhur një varg ngjarjesh të rënda në shkollat shqiptare, të cilat kanë tronditur jo vetëm nxënësit e shkollave dhe prindërit e tyre, por edhe mësuesit drejtuesit e arsimit dhe mbarë publikun. Kështu psh. në datën 13 dhjetor, 2013 18-vjeçari, A. Gj. nxënës i shkollës profesionale “Kolin Gjoka”, të Lezhës pas një sherri banal me një nxënës tjetër u plagos rëndë me thikë pranë ambienteve të kësaj shkolle (Vizion Plus 13.12.13). Në datën 16 dhjetor, 2013 vritet brenda i shkollës “Beqir Çela” me armë zjarri nga një nxënës 15 vjeçar, një i ri 16 vjeçar dhe në 27.02.14, një adoleshent u plagos në gjimnazin “Partizani” në Tiranë nga shoku i klasës.

Sipas një raporti studimor për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013 të kryer nga “Save the Children” dhe Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve rezulton se nga 1435 fëmijë të anketuar, 28% e tyre janë përfshirë në konflikte serioze në mjediset shkollore, ndërsa 42% nuk ndihen të sigurt në klasa.

Sipas statistikave të Ministrisë së Drejtësisë:

- Gjatë vitit 2011 numri i të burgosurve të mitur ishte rreth 656.
- Në vitin 2012, numri i të miturve 14-18 vjeçare të dënur nga sistemi i drejtësisë ishte rreth 800,
- Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2013, konstatohet se shkalla e konfliktualitetit në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit të Tiranës, ka ardhur në rritje nga 6-8% në krahasim me vitet e mëparshme.

Në reagim të kësaj situate të shoqëruar me tension dhe pasiguri në datën 29.02.2014, Ministria e Arsimit Zj. Lindita Nikolla deklaroi për publikun:

“Është drithëruese ajo që po ndodh në shkollat shqiptare, ku vetë shifrat e studimeve janë alarmante. Masat duhet të jenë emergjente duke nisur që nga; adresimi i plotë dhe drejtimi i gishtit tek vetja; zhvillimi i përgjegjësive të reja për të ndërtuar një komunikim të ri brenda shkollës; dënimi i aktit të dhunës kur vijnë nga mësuesit dhe parja në sy e problemeve; thënia e të vërtetave si dhe marrja e përgjegjësive, bashke me ndërtimin e një partneriteti të ri,” (AS, 29.02.14)

## 2-Shqyrtimi i literaturës

Studimet që kanë eksploruar qëndrimet dhe perceptimet e mësues dhe drejtuesve të shkollave ndaj fenomenit të bullizmit janë rralla (Benbenishty & Astor, 2005; Marachi, Astor, dhe Benbenishty, 2007). Megjithatë, në këto pak studime tregohet se mësuesit janë shpesh në dijeni të problemeve sulmeve /bulling (Kinan 2010). Studiuesit Craig dhe Pepler, (1997) kanë raportuar se mësuesit ndërhyjnë për të ndaluar ngacmimin në vetëm 4% të incidenteve ndërsa Craig, Pepler, dhe Atlas (2000), përmes një studimi ku midis metodave të tjera u bazuan edhe në vëzhgim, vunë re se mësuesit ndërhyjnë në ndërprerje të fenomenit vetëm në 15-18 për qind të incidenteve.

Studiuesit Cohn dhe Canter, (2002) kanë gjetur në studimin e tyre të njëjtën

përqindje të ndërhyrjes që bëjnë mësuesit në ndërprerje të bullizmit, si edhe studiuesit Craig dhe Pepler (1997), por ata shkojnë edhe më tej me gjetjet e tyre, duke zbuluar se një në katër mësues nuk shohin asgjë të keqe të ngacmimi apo bullizmi, dhe si pasojë ndërhyjnë vetëm në 4% të incidenteve bullizmit (Cohn dhe Canter, 2002). Perceptimet e mësuesve ndaj bullizmit të të gjitha formave ndikojnë në përfshirjen e tyre për të ndërhyrë. Studiuesit e fushës, argumentojnë se dinamikat e sjelljeve bulliste midis nxënësve mund të ndryshojnë vetëm përmes rritjes së ndërgjegjësimit të rriturve dhe ndërhyrjeve të tyre, zhvillimit të politikave të qarta e shkollës, si dhe koordinimin për ndjekjen e procedurave për t’iu përgjigjur raporteve të ngacmimi/bullizmit (Dedousis - Wallace dhe Shute, 2009).

Një numër i konsiderueshëm studimesh kanë dëshmuar se mësuesit raportojnë një nivel më të ulët të bullizmit duke e krahasuar këtë më nivelin e bullizmit që raportojnë nxënësit (Stockdale etj 2002). Psh nga një studim i kryer në Angli prej Pervin dhe Turner (1994) në të cilin u mat incidenca e bullizmit e raportuar si nga nxënësit ashtu edhe nga mësuesit, rezultoi se nxënësit raportojnë incidence në 26% ndërsa mësuesi nga 5-10%. Po kështu, në një studim ku është hulumtuar perceptimi i nxënësve mbi atë ç’ka bëjnë mësuesit për të ndërprerë bulling që ndodh mes nxënësve, u zbulua se nxënësi raportojnë se mësuesit e tyre bëjnë shumë pak për të ndërprerë fenomenin (Unnever dhe Cornell 2003).

Edhe sipas studiueseve Holt dhe Keyes (2004) ka mospërputhje midis bullizmit të raportuar nga nxënësit krahasuar kjo me atë që raportojnë mësuesit. Sipas tyre, kjo mospërputhje e gjetjeve lidhet edhe me mënyrën se si mësuesit e përkufizojnë bullizmin, ku përgjithësisht mësuesit janë më vigjilent dhe të ndjeshëm ndaj dhunës fizike dhe verbale por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për sa i përket përjashtimit social. Në të njëjtin përfundim kanë arritur edhe studiuesit Byers, Caltabiano, Caltabiano (2011). Edhe pse ka disa karakteristika të qarta për sjelljet bulliste si synimi, intensiteti, vazhdueshmëria dhe asimetria pushtet-forcë nga studiuesit Olweus (2001), dhe Smith e Brain (2000), mësuesit jo gjithmonë i konsiderojnë këta faktorë. Holt dhe Keyes (2004) përmendin gjetjet e studiuesve anglezë si Siann Callaghan dhe Lockhart në vitet 1993, të cilët me studimin e tyre treguan se mësuesit e shohin bullizmin në dy aspekte: së pari si dhunë fizike dhe së dyti si dhunë psikologjike, pa marrë parasysh faktorë të rëndësishme e lartpërmendur nga studiuesit Olweus (2001), dhe Smith e Brain (2000).

Studiuesit Bauman dhe Del Rio (2006) deklarojnë se prania e dhunës në shkollë ndikon negativisht në klimën e saj duke shkaktuar tek nxënësit prishje të ekuilibrave, dhe shfaqje të frikës, depresionit, çrregullime psiko-somatike dhe dëmtim të shëndetit fizik. Këta faktorë, sipas studiuesve ndikojnë negativisht në përqendrimin e vëmendjes e nxënësve, dhe për rrjedhojë në performancën akademike. Ndërsa, Siris dhe Osterman (2004) treguan se mësuesit e kanë të qartë se përveç sigurisë emocionale, psikologjike, fizike të nxënësve, mbrojtja e fëmijëve nga aktet bulliste krijon mundësinë për mësim të efektshëm, pasi siguria e fëmijës është e ndërthurur me proceset kognitive.

Nga ana tjetër, mësuesit luajnë një rol kyç në identifikimin e shenjave si të viktimizimit,

ashtu edhe të sulmit. Për këtë arsye ata janë vlerësuar si faktor vendimtar jo vetëm për të zbuluar fenomenin e bullizmit por edhe për të krijuar kushtet e përshtatshme që nxënësit të mos heshtin kur përballen me bullismin (Smith & Shu, 2000). Studiuesit Pepler, Smith, dhe Rigby (2004), pas një meta-analizë bazuar në 13 studime arritën në përfundimin se faktori kryesor që ndikon për të pasur sukses në reduktimin e dhunës në shkolla, është niveli i lartë i angazhimi të mësuesit për t'i dhënë fund dhunës. Për më tepër, shkollat kanë detyrim për të trajtuar bullizmin dhe duhet të mbajnë përgjegjësi kur nuk trajtohen si duhet situatat të sjelljeve bulliste dhe pasojat e tyre (Kevorkian & D'Antona 2008).

Studimi në fjalë ka natyrë eksploruese. Përmes metodave cilësore synon: 1) Të zbulojë njohjen që kanë mësuesit dhe drejtuesit e shkollave 9-vjeçare mbi fenomenin e bullizmit; 2) Të zbulojë perceptimet dhe qëndrimet e mësuesve dhe drejtuesve mbi të; 3) Të shqyrtojë programet e kurseve me natyrë pedagogjike dhe psikologjike të fakulteteve të mësuesisë në të dy nivelet, për të parë nëse në të përfshihen ose jo njohuri teorike apo praktike mbi fenomenin.

### 3-Metodologjia

Pjesëmarrësit në këtë studim qenë mësuesit e shkollave 9-vjeçare të Qarkut të Durrësit, Fierit dhe Beratit (N=44), prej të cilëve 32 femra dhe 12 meshkuj. Gjithashtu, në studim morën pjesë edhe drejtuesit e shkollave 9-vjeçare të Qarkut të Durrësit, Fierit dhe Beratit (N=9), prej të cilëve 4 femra dhe 5 meshkuj. Për përzgjedhjen e kampionit u përdor teknika e përzgjedhjes rastësore. Të dhënat u grumbulluan gjatë muajve dhjetor 2013- janar 2014.

Për grumbullimin e të dhënave u përdor një udhëzues tematik me 6 pyetje, për intervistim gjysmë të strukturuar si për mësuesit ashtu edhe për drejtuesit. Intervistat u realizuan nga 17 intervistues të cilët u trajnuan për këtë qëllim. Pyetja e parë e intervistës gjysmë të strukturuar lidhej me njohjen që kishin të intervistuarit me fenomenin e bullizmit dhe nëse përgjigja ishte po, atëherë kërkohet nga respondentët një përkufizim. Në rastet kur përgjigja ishte jo, apo edhe në rastet kur nga përkufizimi kuptohej se i intervistuari nuk kishte njohje të saktë mbi fenomenin, intervistuesi i ofronte respondentit një përshkrim të shkurtër teorik mbi dimensionet e fenomenit dhe përkufizimet përkatëse për secilin dimension. Pas kësaj u kërkua përgjigje për pesë pyetjet e tjera të udhëzuesit tematik. Përveç këtyre të dhënave, për të realizuar qëllimet e këtij kërkimi, u studiuuan programet universitare të fakulteteve që përgatisin mësues të universiteteve publike të Durrësit, Shkodrës, Elbasanit Vlorës dhe Korçës, dhe përkatësisht kurset me natyrë psiko-pedagogjike. Për të analizuar të dhënat e grumbulluara nga intervistat, u përdor analiza tematike duke u mbështetur në teknikën e etiketimit dhe të kodimit, por para se të ndërmerreshin hapat e tjerë, fillimisht përgjigjet e intervistuesve shkruan deri në detaje dhe më pas u koduan dhe u ndanë sipas tematikave dhe për të bërë të mundur interpretimin e të dhënave.

## 4- Gjetje dhe diskutime

### 4.1- Njohja me Fenomenin e Bullizmit

Për të realizuar qëllimin e parë të studimit mësuesve dhe drejtuesve iu drejtua pyetja: “A ke dëgjuar për bullizmin? Nëse po, jep një përkufizim për të?” Nga 44 mësues të intervistuar 6 prej tyre pretendojnë se e njohin fenomenin dhe termin . Për të kuptuar më mirë nivelin e njohjes se tyre po renditim përgjigjet e tyre si më poshtë vijojnë: a) “Ngrënia e ushqimit me tepri, pa mendje”; b) “Lloj muzike moderne”; c) “Bullizmi është lloj feje, e indianëve më duket ...”; d) “Njerëz që hanë shume dhe nxjerrin atë që hanë”; e) “Konsiderohet të jetë një formë më e butë e agresivitetit. Dallon në faktin se personi, në rastin tonë nxënësi i cili e përdor synon talljen me bashkëmoshatarët e tij, dhe jo dhunën me ta.” ; dhe g) “Bullizëmi ndodh me njerëzit me sjellje të larta agresive, ofenduese, sharje etj.” Bazuar në përkufizimet që japin vetëm 2 prej tyre janë të drejt-orientuar.

Ndërsa drejtuesit janë më të informuar se mësuesit. Më shumë e gjysma e të intervistuarve dha një përkufizim në lidhje me bullizmin. Nga përkufizimet e tyre kuptohet se ata kanë njohje mbi fenomenin edhe pse gjatë intervistave treguan se u nevojiten trajnime në këtë drejtim. Drejtuesit shprehen gatishmëri për trajnime të mëtejshme në këtë fushë pasi deklaruan se kohët e fundit dhuna është shumë e shprehur nëpër shkollat dhe mësuesit por edhe ata si drejtues kanë nevojë për të njohur më thellë fenomenin por edhe strategji të efektshme për të për të zgjidhur sa me drejt rastet e paraqitura. Më poshtë po paraqesim përkufizime të dhëna nga drejtuesit:

- a- Bullizmi është një fenomen i shpeshtë në shkollat shqiptare dhe pothuaj se çdo klasë ka një tip që do të dale mbi të tjerët dhe mundohet t'i ulë ata. Rreth bullizmit ka dëgjuar madje edhe raste që kalojnë në veprime ekstreme si vrasje, vjedhje, dhe sigurisht që ka një influencë negative në tipat e ndrojtur.
- b- Grup nxënësish të dhunshëm që ndahen nëpër grupe dhe luftojnë njëri-tjetrin.
- c- Mëdyshje me vetvete, pamundësi e disa nxënësve për të qene pjesë e klasës, dominohen nga më të fortët.
- d- Janë të pranueshëm për vetën e tyre por jo për të tjerët. Mundohen të jenë në qendër të vëmendjes edhe pse nuk dinë më shumë se të tjerët. Bullizmi është një fenomen i shpeshtë në shkollat shqiptare dhe pothuaj se çdo klasë ka një tip që do të dale mbi të tjerët dhe mundohet t'i ulë ata. Rreth bullizmit ka dëgjuar madje edhe raste që kalojnë në veprime ekstreme si vrasje, vjedhje, dhe sigurisht që ka një influencë negative në tipat e ndrojtur.
- e- Janë ata fëmijë që krijojnë sjellje ngacmuese jashtë normave dhe jo thjesht një gërvishtje të momentit, por që e kalon masën e një ngacmimi. Fenomen që haset në mosha të ndryshme sidomos tek meshkujt.



## **4.2- Identifikimi i Bullëve dhe Viktimave, Raporti midis Tyre**

Pyetjes se dytë të udhëzuesit tematik “A ke ne klase nxënës bullë që ngacmojnë te tjerë ( pra bullë dhe viktimë të tyre)? Sa është numri i tyre (bull dhe viktimë)?

Pasi janë sqaruar prej intervistuesve nga ana teorike mbi fenomenin, mësuesit reaguan dhe japin të dhëna. Ja se si shprehet njëra prej tyre:

Epo ne paskemi gjithë jetën që qenkemi marrë bullët dhe nuk e paskemi ditur. Me thënë të drejtën në punën tonë të përditshme ne i kemi kushtuar vëmendje vetëm rasteve kur nxënësit përfshihen në konflikt fizik, dhe rrallë sharjeve dhe talljeve, ndërsa me rastet e tjera, tani kuptoj që nuk jemi marrë. (K.N., mësuese fizike, 51 vjeç)

Nga përgjigjet e mësuesve zbulohet se nuk është thjesht termi i pa qartë për mësuesit por ajo që është e rëndësishme është mungesa e njohjes teorike që kanë mësuesit mbi fenomenin. Të intervistuarit dëshmojnë se në çdo klase ka të paktën një bull, por përgjithësisht klasat me 28- 30 nxënës kanë të paktën 2-3 bullë dhe 5-10 viktimë. Drejtuesit gjithashtu deklarojnë se nuk ka klasë që nuk ka “prototipat” e vet.

Mësuesit por edhe drejtuesit bullët zakonisht i quajnë fëmijë problematikë, fëmijë të vështirë ose prototipa.

## **4.3- Perceptimi i Mësuesve dhe Drejtuesve mbi Kohën, Vendin ku Ndodh Bullizmi dhe Arsyet**

Të pyetur se “Kur, ku dhe pse ndodh ky sulm ( bullizmi) sipas jush?(koha, vendi arsyeja)” mësuesit dhe drejtuesit raportuan se dhuna ndodh kur fëmijët janë të pambikëqyrrur nga mësuesit por edhe pas situatave që krijojnë tension si p.sh provimet. Bullët sulmojnë kurdo që u jepet mundësia. Porsa i përket vendndodhjes raportohet se dhuna ndodh kryesisht në klasa gjatë pushimit 5 minutësh dhe pushimit të madh. Tualetet, oborret dhe veçanërisht në oborret e pasme të shkollave e korridoret perceptohen të jenë vendet ku ka më shumë incidencë të akteve bulliste.

Sipas perceptimit të mësuesve dhe drejtuesve renditen disa arsye pse bullët sulmojnë. Së pari ata arsyetojnë se bullëve u pëlqen vetja, dhe zakonisht sulmojnë fëmijë që paraqesin inferioritet moshe, dhe force (fizike apo psikologjike). Një arsye tjetër raportohet të jetë statusi i ulët social-ekonomik por edhe prejardhja familjare që sipas mësuesve dhe drejtuesve, është arsye që fëmijët jo vetëm të sulmohen por dhe të distancohen nga pikëpamja sociale.

Kur nxënësit vijnë nga zonat Veri-lindore shokët e tyre ne rastin me të parë të kundërshtive i quajnë “malokë” (E.N., mësues historie Patos, 47 vjeç). Fëmijët e familjeve me prindër punëtor apo të varfra, shokët i quajnë “pabuksa” dhe i përjashtojnë nga grupi.” (D.L., mësuese e anglishtes në Urën Vajgurore , 33 vjeç). Drejtuesit përveç arsyeve të mësipërme raportojnë se në kushtet e gjithpërfshirjes aftësia e kufizuar është një ndër arsytet më të spikatura. Sipas drejtuesve fëmijët me

AK janë në qendër të sulmit të bullëve. Kur ka nxënës të ndrojtur apo me probleme sidomos kur janë fëmijë me AK. Ata janë të parapëlqyerit nga bullët.” (L.K., femër , 43 vjeç).

#### **4.4- Perceptimet e Mësuesve dhe Drejtuesve mbi Reagimet e Fëmijëve ndaj Bullizmit**

Për të kuptuar perceptimet e mësuesve dhe drejtuesve mbi reagimet e nxënësve ndaj bullizmit, pjesëmarrësve të studimit u drejtua pyetja: “Ç’bëjnë nxënësit e tjerë, si reagojnë ndaj kësaj situate?” Sipas perceptimeve të mësuesve kur ndodhin akte bulliste të gjithë fëmijët përfshihen dhe reagojnë në forma nga më të ndryshmet.

Klasa ndahet në dy pjesë, kemi nxënës që mbështetin bullin apo nxënës që mbështetin viktimën. Zor se gjen një që nuk përfshihet. (D.S., femër , 53 vjeç). Shumica ankohen te mësuesit e tyre, dhe u duhet argëtuese. Të tjerët frikësohen, por ka edhe raste kur ata qeshin me viktimën. (M.R., femër , 37 vjeç). Në të shumtën e rasteve , bëjnë sehir se u pëlqen shfaqja mes këtyre tipave, por ka edhe element të cilët reagojnë në moment dhe mbajnë qëndrime ndaj këtyre sjelljeve. (S.K., mashkull , 47 vjeç). Mundohen të vetëmbrohen. Të tjerët përpiqen t’i shmangen këtij ngacmimi por ka edhe nga ata që i kundërpërgjigjen duke imituar të njëjtën sjellje dhe kjo është e tmerrshme. (L.S., femër , 30 vjeç). Disa mësues e perceptojnë reagimin e fëmijëve të lidhur me edukimin familjar.

Varet nga natyra e fëmijëve, nga familja që ata vijnë dhe nga lloji i prindërve.” (N. LL., femër , 41 vjeç)

Si i ati dhe i biri . (S. K., mashkull , 47 vjeç)

Drejtuesit e shohin kryesisht sjelljen bulliste si rrjedhojë jo vetëm të edukatës familjare por edhe të dinamika ë ndodhin brenda familjeve.

#### **4.5- Qëndrimet E Mësuesve Dhe Drejtuesve Mbi Rëndësinë Dhe Ndikimin Që Ka Te Fëmija Bullizmi**

Megjithëse paraqiten tri qëndrime (nënvlerësues, i ekuilibruar dhe tepër sensibil) mbi pasojat e bullizmit, shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e mësuesve nuk e paraqesin si serioze situatën dhe pasojat që sjell bullizmi.

##### **Qëndrim nënvlerësues**

E po fëmijë janë e do të zihen. E ç’pasoja do të ketë? Per 5 minuta pajtohen dhe ne na mbetet fjala e keqe edhe para prindërve .” (L.M., mësuese gjeografie, Maminas, 41 vjeç)

Fëmijët gjithë jetën janë zënë. Do te rriten dhe nuk do te zihen më. (I.M., mësuese anglishte Berat, 46 vjeç). Mos e vrit mendjen, i zgjidhin vetë punët e tyre ata! (L.D., mësues Cikli i Ulët Kuçovë, 32 vjeç)

##### **Qëndrim i ekuilibruar**

Duhet përmendur fakti se janë shumë pak mësuesit që paraqesim qëndrime të

ekuilibruara.

Nëse nuk merremi me këto raste, fëmijët lëndohen, u mërztet shkolla dhe vetja dhe të tjerët, bien nga mësimet deri sa e lenë fare shkollë. Ka raste edhe pse te rralla që fëmijët arrijnë deri në depresion dhe akte dhune (I.K., mësuese fizike, Ura Vajgurore, 42 vjeç).

### **Qëndrim tepër sensibil**

Edhe për sa i përket qëndrimeve me ndjeshmëri të lartë, ato shfaqen nga shumë pak mësues.

Është një problem shumë i madh. Nuk e sheh njëri varet dhe tjetri hidhet nga kati i peste, të tjerët vrasin njeri-tjetrin. Këta po i le, kontingjent burgu bëhen! (D.K., mësues matematike, Fier 59 vjeç).

### **4.6- Qëndrimet e Mësuesve dhe Drejtuesve mbi Masat që Duhën Ndërmarrë për Ndërprerjen e Dhunës**

Mungesa e njohjes së thelluar ndaj fenomenit , i bën mësuesit dhe drejtuesit të mbajnë qëndrime rastësore dhe kryesisht ekstreme (indiferentizëm, ose masa ekstreme për ndërprerjen e fenomenit.

Të merremi me matematikën dhe gjuhën, dhe kush është si ne. Fëmijët janë zënë jetë e mot. Ata i zgjidhin vetë këto punë. (T. O., mësuese Cikli i Ulët Fier, 36 vjeç). Kush është i zoti është, dhe kush nuk është le të rri. Në fund të fundit edhe ne jetë kështu është. Peshku i madh gjithmonë e ka ngrënë të voglin. E mund t'i bësh kësaj? (M. R., drejtuese Fier, 33 vjeç).

Është shqetësues fakti se mbizotëron te mësuesit mendimi se kjo sjellje mund të ndërpritet me dhunë. Do ta izoloja bullin duke e lënë vetëm në bangë. Do të influencoja tek nxënësit e tjerë, që të mos i afrohej askush. (A T., mësuese kimie Durrës, 39 vjeç). Ai qe niset me kulaç, do kulaç, ai që niset me kërbaç do kërbaç. (Z. S., drejtues Fier, 56 vjeç). Vetëm druri i sjell ne terezi këta dreqër. (L.M., mësuese biologjie Berat, 46 vjeç)

Disa mësues tregojnë shenja të lodhjes, por ajo që është edhe më e rëndësishmja është fakti se një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve e shohim profesionin e mësuesit të lidhur vetëm me mësimdhënies dhe orën e mësimit dhe nuk mendojnë se duhet të merren me zgjidhjen e këtyre problemeve edhe pse në standardet e përgjithshme bazë të mësuesit puna e mësuesit nuk shihet vetën e lidhur me mësimdhënies por edhe me edukimin dhe mirëqenien e nxënësve. Më konkretisht në standardin 1 të mësuesit Marrëdhëniet me fëmijët dhe të rinjtë përkufizohet: "Mësuesi tërheq në mënyrë të vazhdueshme fëmijët/ të rinjtë në përvoja të përshtatshme, që mbështesin zhvillimin e tyre intelektual, social dhe personal". Në këtë grupim mësuesish kryesisht bëjnë pjesë kryesisht mësuesit që nuk kanë bere akoma pesë vjet pune por edhe ata qe kanë janë mbi moshën 57-vjeçare.

Unë jam mësuese, paguhem për të bërë mësim dhe jo për t'u marrë me prototipa. Drejtuesit marrin me shume rrogë se ne. Kjo është pjesë e tyre. (E L., mësuese

Edukim Qytetar, Vorë, 27 vjeç). Na u shkri jeta duke u marrë me lloj-lloj prototipash. Ata ndreqen aq sa ndreqet bishti i qenit ( K. Z., mësues Historie, Fier 59 vjeç).

Po pse edhe me këta do te merrem unë? Na e morën shpirtin! Çdo dite një kërkesë e re. Ndërro kurrikula e ndërro rregulla, shto ketë edhe shto atë. Na i plasin gjoja ndryshimet dhe reformat si top në derë, dhe vrit veten ti po deshe. Teste këtu, e kontrole atje. Tani na dolën edhe bullët, lum si ne! A ka më ( L. M., mësuese matematike Durrës, 58 vjeç)?

Pjesa më e madhe e mësuesve mendojnë se këto situata mund të zgjidhen nga ata, në disa raste edhe në bashkëpunim me prindërit. Vlen për t'u përmendur fakti se janë shumë të rrallë mësuesit që mendojnë se për probleme të sjelljeve bulliste të nxënësve është e rëndësishme që mësuesi të bashkëpunojë më psikologun shkollor apo me persona të tjerë që ofrojnë mbështetje dhe shërbim psiko-social në shkollë. Ndërsa drejtuesit kryesisht mendojnë se si bullët edhe viktimat kanë nevojë për t'u trajtuar nga psikologët e shkollave.

#### **4.7- Shqyrtimi i Programeve Universitare**

Për të kuptuar më mirë arsyet e këtij niveli të njohjes që kanë mësuesit dhe drejtuesit për fenomenin e bullizimit u shqyrtuan disa nga programet e kurseve universitare të fakulteteve që përgatitin mësues (BA dhe MND) në të dy nivelet. U morën në shqyrtim programet e kurseve të “Metodologjive të mësimdhënies”, “Hyrje në shkencat e edukimit”, “Menaxhimi i klasës”, “Psikologji e edukimit”, dhe “Sociologji e edukimit”.

Nga shqyrtimi i këtyre programeve ( te detyruara dhe me zgjedhje) rezultoi ka trajtim vetëm me një ose edhe dy tema për sjelljet e papërshtatshme apo sjelljet destruktive ne kurse si “Menaxhimi i klasës” apo edhe në “Psikologjinë e edukimit”, por në asnjë prej kurseve nuk është planifikuar të trajtohet ky fenomen me gjithë gjerësinë e vet edhe pse është një çështje që lidhet drejtpërdrejt me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve në shkolla, menaxhimin e klasës dhe kompetencat profesionale të mësuesit.

#### **5- Konkluzione dhe Rekomandime**

Rezultatet e këtij studimi treguan se edhe pse fenomeni i bullizimit është i pranishëm në shkollat shqiptare mungesa e njohjes se thelluar mbi këtë fenomen i bën mësuesit dhe drejtuesit mbajnë qëndrime rastësore dhe kryesisht ekstreme (indiferentizëm, ose masa ekstreme për ndërprerjen e fenomenit Për të ndryshuar dinamikën e bullizimit brenda shkollave studiuesit mendojnë se puna duhet filluar nga ndërgjegjësimit të rriturve pasi ata gjykojnë se kur të rriturit janë të ndërgjegjshëm për rreziqe dhe dëmet që shkakton fenomeni kanë më shumë prirje për të ndërhyrë në ndërprerje të tij ( Olëeus , 1993 , Pepler , Sugai & Horner , 2002).

Studimi gjithashtu zbuloi se bullizimi gjen kushtet për t'u shfaqur më shumë në mjedise të pa mbikëqyrura nga të rriturit, dhe konkretisht në shkollë fenomeni shfaqet zakonisht në pushimet midis orëve kur mësuesit nuk janë në klasë, në korridore dhe oborre gjatë hyrjeve dhe daljeve nga shkolla, por edhe në pushimin e gjatë. Sipas mësuesve kur ndodhin akte bulliste, të gjithë nxënësit përfshihen

edhe pse, në mënyra të ndryshme. Arsytet që rendisin mësuesit dhe drejtuesit kryesisht janë të lidhura me natyrën që kanë vetë nxënësit bullë, të cilëve u pëlqen vetja dhe mundohen që përmes akteve bulliste të tërheqin vëmendjen e të tjerëve, prejardhjes familjare dhe statusit ekonomik-social të fëmijëve të cilët viktimizohen por sipas drejtuesve një arsye për t'u sulmuar nga bullët është dhe të qenit me AK. Është e domosdoshme si mësuesit edhe drejtuesit të bashkohen për të luftuar efektet e dhunës psikologjike brenda shkollat tona. Sipas studiuesve Dedouis - Wallace dhe Shute (2009) si roli i mësuesve ashtu edhe ai i drejtuesve është ngushtësisht i lidhur me perceptimet e tyre për rëndësinë dhe pasojat serioze të cilat vijnë si pasojë e kësaj dhune. Një prej gjetjeve të këtij studimi ishte edhe fakti se mësuesit kanë një prirje për ta ndërprerë fenomenin përmes dhunës nga ana e tyre. Ky është një tregues i qartë i mungesës së njohjes së strategjive efektive për të zgjidhur situatat reale të bullizmit në shkollë, i cili ka lidhje edhe me mungesën e pajisjes teorike profesionale të tyre në auditorët e universiteteve që përgatitin mësues. Është po kjo mungesë njohjeje që i drejton mësuesit të mendojnë se këto situata janë në gjendje t' i zgjidhin vetë në bashkëpunim me prindërit pa menduar të kërkojnë edhe mbështetjen e shërbimit psiko-social që ofron shkolla. Ndërsa drejtuesit e shkollave në këtë pikë kanë qëndrime të tjera pasi ata kanë pasur më shumë mundësi për të marrë pjesë në trajnime të ndryshme.

Bazuar në këto gjetje do të ishte e arsyeshme organizimi i një fushatë sensibilizuese për nxënës, prindër dhe komunitetin. Sugjerohet rishikimi i rregulloreve të brendshme të shkollave ku të përkufizohet qartë sjellja bulliste dhe masave për parandalimin e saj. Po kështu, IZHA, në bashkëpunim me Fakultet e Edukimit, mund të përgatitin manuale për mësues dhe drejtues për të identifikuar dhe menaxhuar sjelljen bulliste. Nga ana tjetër, specialistet e IZHA, duhet studiojnë mundësinë që të bëjnë pjesë të kurrikulave të nxënësve, aspekte të ndryshme të sjelljeve bulliste për qëllime edukimi. Studimi zbuloi se një arsye serioze që mësuesit nuk i orienton drejt fenomenit ishte pikërisht termi i përdorur në anglisht "bullizëm". Fakultet e Edukimit, mund të organizojnë debate akademike me specialiste dhe gjuhëtarë për shqipërimin e këtij termi. Po kaq me vend do të që edhe rishikimi i kurrikulave në fakultetet e edukimit në të gjithë vendin, me qëllim që në to të përshihen njohuri të teorike dhe praktike mbi fenomenin e bullizmit, në mënyrë që të mësuesit dhe drejtuesit e së ardhmes të kenë përgatitjen e nevojshme për t'u përballur me sukses me këtë fenomen.

Në nivel lokal rekomandohet që në bashkëpunim me DAR/ZA të realizohen trajnime me drejtues dhe mësues për njohjen në baza shkencore të fenomenit, pasojat e tij afatgjata si dhe të mënyrave me efikasë për trajtimin e nxënësve. Ndërsa në nivel shkollë për drejtuesit sugjerohet puna me ekip për monitorimi dhe mbikëqyrje sistematike jo vetëm të mjediseve ku është me e mundur të ndodhin aktet bulliste si oborre, korridore, tualete, por edhe të sjelljeve bulliste jo të dukshme në shkollë. Rekomandohen gjithashtu trajnime të brendshme të realizuar nga ekipe profesionistësh (në mënyrë të veçantë të psikologut shkollor) për mësues e prindër dhe nxënës. Nga ana tjetër, do të ishte mirë të shtoheshin orët edukative që kanë të fokus trajtimin e sjelljeve bulliste dhe pasojat e tyre, si edhe dhënies prioritet dhe vëmendje të veçantë gjithpërfshirjes në arsim më mënyrë që ajo të mos jetë e kërcënuar nga bullizmi.

**Referenca:**

Bauman, S., & Del Rio, A. (2006). Pre-service teachers' responses to bullying scenarios. Comparing physical, verbal, and relational bullying. *Journal of Educational Psychology*, 98, 219-231.

Benbenishty, R., & Astor, R. (2005). *School violence in context: Culture, neighborhood, family, school, and gender*. New York: Oxford University Press.

Byers, D. L., Caltabiano, N. J., & Caltabiano, M. L. (2011). Teachers' Attitudes Towards Overt and Covert Bullying, and Perceived Efficacy to Intervene. *Australian Journal of Teacher Education*, 36(11).

Craig, W., and D. Pepler. 1997. "Observations of bullying and victimization on the playground." *Canadian Journal of School Psychology*, 2: 41-60.

Craig, W., Pepler, D., & Atlas, R. (2000). Observations of bullying in the playground and in the classroom. *School Psychology International*, 21, 22-36. doi:10.1177/0143034300211002.

Dedousis-Wallace, A., & Shute, R.H. (2009). Indirect bullying: Predictors of teacher intervention, and outcome of a pilot educational presentation about impact on adolescent mental health. *Australian Journal of Educational & Developmental Psychology*, 9, 2-17.

Holt, . & Keys , M. A. (2004). Teachers' attitudes toward bullyillin. In D. Espelage & S.M. Swearer, *Bullying in American Schools: A Social-ecological Perspective on Prevention and Intervention* (pp 121-140). Mahwah, NJ: Erlbaum.

Kallestad, J., & Olweus, D. (2003). Predicting teachers' and schools' implementation of the Olweus bullying prevention program: A multilevel study. *Prevention & Treatment*, 6(1), 3-21.

Keorkian, M., & D'Antona, R. (2008). *101 facts about bullying: What everyone should know*. Lanham, MD: Rowan & Littlefield.

Kinan, E. L. (2010). *Teacher attitudes towards three types of bullying* (Doctoral dissertation). Available through ProQuest Dissertations and Theses database. 3423483.

Marachi, R., Astor, A., & Benbenishty, R. (2007). Effects of teacher avoidance of school policies on student victimization. *School Psychology International*, 28(4), 501-518. doi: 10.1007/s10964-006-9136-4.

Olweus, D. (1993). *Bullying at school: What we know and what we can do*. Cambridge, MA: Blackwell.

Olweus, D. (2001). *Peer harassment in schools: A critical analysis and some*

important issues. In J. Juvonene & S. Graham (Eds.). *Peer harassment in schools: The plight of the vulnerable and victimized* (pp 3-20). New York: The Guilford Press.

Pepler, D., Craig, W., & O'Connell, P. (1999). Understanding bullying from a dynamic system perspective. In A. Slater & D. Muir (Eds.), *The Blackwell reader in developmental psychology* (pp. 440–451). Oxford, England: Blackwell.

Pepler, D.J., Smith, P.K., & Rigby, K. (2004). Looking back and looking forward: Implications for making interventions work effectively. In P.K. Smith, D. Pepler, & K. Rigby (Eds.), *Bullying in schools: How successful can interventions be?* (pp. 307-324). Cambridge, England: Cambridge University Press.

Pervin, K., & Turner, A. (1994). An investigation into staff and pupils knowledge, attitudes and beliefs about bullying in an inner city school. *Pastoral Care in Education*, 12, 16-22.

Rigby, K., & Bagshaw, D. (2003). Prospects of adolescent students collaborating with teachers in addressing issues of bullying and conflict in schools. *Educational Psychology*, 23, 535–546. doi:10.1080/0144341032000123787.

Rigby, K., & Barnes, A. (2002). The victimized student's dilemma: To tell or not to tell. *Youth Studies Australia*, 21, 33–36.

Siann, G., Callaghan, M., & Lockhart, R. (1993). Bullying: Teachers' views and schools effects, *Educational Studies*, 19, 307-21.

Siris, K. & Osterman, K. (2004). *Phi Delta Kappan*, 288-291.

Smith, P. K., & Brain, P. (2000). Bullying in schools: Lesson from decades of research. *Aggressive Behavior*, 26, 1-9.

Smith, P.K. & Shu, S. (2000). What good schools can do about bullying: Findings from a survey in English schools after a decade of research and action. *Childhood*, 7, 193-212.

Stockdale, M. S., Hangaduambo, S., Duys, D., Larson, K., & Sarvela, P. D. (2002). Rural elementary students', parents', and teachers' perception of bullying. *American Journal of Health Behavior*, 26, 266-277.

Unnever, J., & Cornell, D. (2003). The culture of bullying in middle school. *Journal of School Violence*, 2(2), 5–27. doi:10.1300/J202/v02n02\_02.





**Xhevdet ZEKAJ**  
Universiteti A.Xhuvani  
Elbasan/Albania

**Marsela TOPUZI**  
Università degli Studi di Genova  
Genova/Italy

**Aurela AGALLIU**  
Universiteti i Tiranës  
Tirana/Albania

## **Barazia Gjinore dhe Edukimi Gjinor ne Arsim, Tregues i Rendesishem i Zhvillimit Social dhe Ekonomik te nje Shoqerie**

### **Abstrakt**

*Integrimi gjinor ne arsim eshte tregues kryesor i zhvillimit social dhe ekonomik te nje vendi. Gjithashtu, niveli arsimor, eshte nje tregues qe flet per statusin e grave dhe vajzave. Arsimimi i tyre redukton trasmetimin e varferise nga brezi ne brez dhe rrit kapacitetin dhe potencialet e tyre per te kontribuar ne aspektet sociale, ekonomike dhe politike te zhvillimit kombetar. Arsimi gjithashtu eshte e drejte themelore e cdo individi dhe nje mjet thelbesor per arritjen e barazise gjinore, zhvillimit dhe paqes. Barazia ne hyrje dhe ne arritjen e kualifikimeve arsimore eshte e thelbesore, aq me teper nese grate do arrijne te realizohen e te behen agjente te ndryshimit. Arsimimi dhe lufta kunder analfabetizmit te grave dhe vajzave eshte nje element i rendesishem per permiresimin e shendetit, te ushqyerit dhe edukimit ne familje si dhe ne fuqizimin e grave per te marre pjese ne procesin e vendimarrjes ne shoqeri. Investimi ne arsimin formal dhe jo-formal si dhe ne kualifikimin e grave dhe vajzave, me nje perfitim te larte ekonomik dhe social, ka vertetuar te jete nje nga mjetet me te mira per arritjen e zhvillimit dhe rritjes ekonomike konstante dhe te qendrueshme. Raliteti tregon se ne sektorin e arsimit, dhe jo vetem, ekzistojne pabarazi te konsiderueshme gjinore. Por eshte pikerisht nepermjet pjesmarrjes sa me te gjere te grave dhe te vajzave ne arsimim qe mund te arrihet minimizimi i pabarazise midis burrave dhe grave edhe shoqeri. Kerkimi yne shkencor mbi barazine gjinore dhe arsimin ka evidentuar se ne Shqiperi ashtu si dhe ne shume vende te tjera, arsimi me aspektet e tij te shumta si kornizat kurrikurale, arritjet akademike ne shkolle, frekuentimi i shkolles, trajnimi i mesuesve, mjedisi instituzional, etj., luajne nje rol te rendesishem ne promovimin apo trasmetimin e barazive gjinore. Qellimi i ketij artikulli eshte analiza e thelle e parimit te barazise gjinore ne kuadrin arsimor si dhe ndikimi qe ka ne shoqeri, duke konstatuar ne probleme te shumta qe meritojne vemendje dhe reflektim nga te gjithet aktoret e sistemit arsimor.*

**Konceptet kryesore:** Barazia gjinore; Edukimi gjinor; Niveli arsimor; Integrimi gjinor; Politika gjinore; Stereotipe gjinore; Te drejtat e grave; Te drejtat e njeriut

## 1-Hyrje

Ky studim eshte nje kontribut qe i shtohet diskutimit rreth problemeve gjinore ne kuadrin arsimor. Idea fillestare ishte ekzaminimi se sa dhe me cfare menyrash pabarazia gjinore ne arsim eshte nje argument diskutimi ne Shqiperi. Ndonese situata ka ndryshuar ne menyre radikale persa i perket perqindjeve te pjesemarrjes ne arsim, dallimet gjinore akoma ndikojne si ne rezultatet shkollore ashtu dhe ne karrieren e perzgjedhur akademike. Kerkimi yne shkencor synon te analizoje nese keto dallime sjellin ne ndryshime dhe ne evolucion te ligjeve apo politikave lidhur me arsimimin, ne sondazhet kombetare apo cfaredolloje masash zyrtare te perqendruara mbi gjinine. Gjithashtu studimi yne kerkon te ofroje nje harte te politikave dhe strategjive qe aplikohen ne vendin tone per te luftuar pabarazine gjinore ne sistemin arsimor aktual. Ne kete artikulli analizojme gjithashtu legjislatizoni kombetar dhe nderkombetar qe garanton te drejtat e grave dhe vajzave per barazine gjinore ne arsim. Pergjate punes se zhvilluar, gjithashtu, lindi natyrshem nevoja per nje analize te publikimeve, teksteve dhe programeve akademike qe jane baze per formimin e studenteve. Jemi munduar te studiojme nese tekstat respektojne barazine gjinore dhe nese arrijne te realizohen larg stereotipave shoqerore. Analiza e teksteve dhe programeve eshte realizuar duke u mbeshtetur ne metoda cilesore dhe sasiore. Kur ka qene e mundur dhe e arsyeshme, jane perdorur metoda te studimit te pervojës njerezore, sic jane metodat komplekse te analizës se rrefimit, analizës se permbajtjes, analizës semiotike etj. Te gjitha analizat, parashtrimetrajtimet, pyetjet, shembujt, qe si autore kemi konsideruar per kete artikull shkencor, kane pasur pikenisje analizen e situates se barazise gjinore ne sistemin arsimor ne Shqiperi si dhe rolin e edukimit gjinor ne keto institucione. Nga kjo analize jane konstatuar dukshem probleme, te cilat meritojne vemendje dhe reflektim nga te gjithë aktoret e sistemit arsimor ne Shqiperi.

Persa i perket burimeve, jane perdorur dokumentat zyrtare te autoriteteve qendrore, konventat nderkombetare dhe legjislatizoni ne fuqi. Gjithashtu jane perdorur per kete studimin raporte te shoqatave joqeveritare qe operojne ne kete fushe, sondazhe dhe statistika kombetare si dhe literature specifike e huaj dhe e vendit.

## 2-Analiza kerkimore

Te edukuarit per te konsideruar problematike identitetin gjinor sidomos ne periudhen e adoleshences, eshte nje faktor kyc per te projektuar te ardhmen ekzistenciale, afektive dhe karrieren, jashte cdo pritshmerie dominuese mbi mashkulloren dhe femeroren. Ne kete proces, bota e edukimit dhe e trajnimitit luajne nje rol vendimtar dhe jane te thirrur te perfshijne nje perspektive gjinore ne praktikaten e tyre edukuese: te bejne nje edukim i cili te jete i afte te prishe modelet dominuese gjinore duke i ofruar studenteve strumentet teorike dhe relacionale te dobishem per tu bere burrat dhe grate qe ata deshirojne (Gamberi, Maio, & Selmi, 2010).

Edukimi gjinor duhet te luaje nje rol te rendesishem ne sistemin edukativ shqiptar. Togfjaleshi “edukimi me dhe per perkatesine gjinore” i cili percjell filozofine dhe moton e edukimit gjinor, duhet konsideruar si nje parim baze per cdo ekspert qe

perfshihet ne ceshtje qe lidhen me kete edukim. Eshte e rendesishme qe togfjaleshi i mesiperem te ndahet ne pjesen e pare "edukim me", i cili duhet te kuptohet si nje detyrim i cdo individi qe trajton ceshtje te lidhura me edukimin gjinor. Individi duhet te njohe, te besojte dhe te pranoje te jete ithtar i edukimit gjinor ne cdo rrethane, me cdo auditor, te jete percjelles i frymes se edukimit gjinor me mekanizma te natyrshem, pa u sforcuar dhe pa per dorur moralizime apo indoktrinime.

Pjesa tjeter e togfjaleshit "edukimi per perkatesine gjinore" duhet kuptuar si detyrim, qe cdo individ ka, per te percjelle idete e tij apo te saj dhe frymen e edukimit gjinor tek te tjeret, vetem pasi ka krijuar brenda vetes dije te thella rreth ceshtjeve, qe lidhen me edukimin gjinor dhe ka kthyer ato ne vlera te edukimit gjinor (Gjinore, 2008). Jane pikerisht keto vlera qe i japin te drejten ne jete percjelles dhe lobues i edukimit gjinor. Te fitosh te drejten per te perdorur togfjaleshin e lartepemendur dhe per te percjelle ate ne literature apo ne auditore profesionistesh, e mjedise publike duhet te jesh i mbarsur mjaftueshem me idete dhe ceshtjete e edukimit gjinor, me pervoja te ndrydhme nga kjo fushe, dhe te zoterosh teresine e mekanizmave, per ti percjelle ato tek te tjeret, cilado qofshin sepcifikat e tyre. Edukimi gjinor, ndryshe nga shume apekte te tjera te edukimit, nuk ka nje standard te paracaktuar dhe nuk matet ne menyre te drejtperdrejte, sic mund te maten datat, listat, kategorite apo vendet. Pikerisht, prej ketij fakti, edukimi gjinor behet nje angazhim i vecante. Ai nuk eshte edukim feminist e moralizues, por nje ftese qe cdo student te kete shans te mesojte te sillet ne perputhje me identitetin e tij gjinor. Paragjykimet ne konceptimet dhe parashtrimet e materialeve gjinore gjenden dendur ne tekste dhe leksione, duke ua pakesuar vlerat e tyre si instrumente te ndricimit te mendjes dhe emancipimit te shpirtit te studenteve.

Akademiket e pedagoget duhet te identifikojne strategji dhe mundesi per ti bere tekstet dhe leksionet e tyre mjete te dobishem dhe efikase ne edukimin gjinor. Nje nga rruget me te natyrshme nga ku mund te filloje prezantimin e drejte te djemve dhe vajzave, cdo tekst apo leksion, pavaresisht lendes dhe moshes se studenteve, eshte pasqyrimi i jetes ne institucionet formuese, nje mjedis formal edukimi por gjeresisht i njohur nga studentet. Strategjia e sjelljes se djemve dhe vajzave jo vetem ne familje dhe ne rruge, por edhe ne shkolle, ku marrin apo u caktohen role pavaresisht gjinise, eshte nje fillim i natyrshem i edukimit te drejte gjinor. Portretizimi i djemve dhe vajzave duke u rritur dhe emancipuar sebashku eshte pozitiviteti qe duhet te sjellin tekstet. Keshtu realizohet dhe konkretizohet misioni i kurrikules, tu mesojte vajzave te zakonshme se dhe per to cdo gje eshte e mundur. Autoret e teksteve, artikujve apo leksioneve mund te krijojne situata nga me problemoret me rolet e djemve dhe vajzave, burrave dhe grave ne institucionet edukative. Pasi dimensionet shumeplanesh te meshkujve dhe femrave ne shkolle mund te jene burim nxenieje, zhvillimi dhe qendrimi androgjinik. Tekste te fuqishme jane ato qe ne perputhje me misionin e programit, arrijne te sjellin per gjykim, analize, sfide, paragjykimet e vete studenteve dhe pedagogete ne mesimin e lendeve te ndjeshme ndaj dallimeve gjinore si per shembull edukata shoqerore, ajo shendetesore, edukata seksuale, biologjia, anatomia, etj. Ne tekste eshte normale dhe e deshirueshme te tregohet pervoja e angazhimit te djemve dhe vajzave ne to. Te tilla paraqitje rrisin fuqine e diskutimeve dhe perfshirjen e vertete

te djemve dhe vajzave ne objektivat e shkolles. Fakti qe autoret jane personalitete dhe individualitete te vecanta, me kapacitete unikale intelektuale, dhe skemat e tyre te te menduarit dhe te sjelljes reflektohen dhe ne shkrimet dhe botimet e tyre. Ato sjellin pervoja dhe perspektiva te ndryshme gjinore, duke i dhene shkrimeve dimensionet qe ata kane. Per shkak te skemave te tyre te te menduarit dhe te sjellurit, te cilat i kane marre permes modeleve ne familje, apo skema te fituara gjate viteve te shkollimit, ata kane krijuar dhe projektuar modelet e tyre te femres dhe te mashkullit. Keto skema natyrshem mund te percillen dhe reflektohen ne shkrimet e tyre. Ndaj duhen bere perpjekje per te evituar dhe eliminuar parapelqimet dhe perspektivat personale qe mund te cojne ne cekuilber gjinor ne tekste, duke ndikuar ne krijimine probleme per studentet ne te ardhmen. Ndaj eshte e nevojshme qe te gjitha autoret, sidomos ata te teksteve shkollore te marrin paraprakisht nje formim dhe edukim gjinor. Jane te shumta deformimet gjinore dhe grackat qe duhet tu shmangen autoret e teksteve, pedagoget dhe aktoret qe marrin pjese ne sistemin arsimor. Paragjykimet dhe stereotipat me te rendomte te deformimeve gjinore jane ato ku gruaja identifikohet teresisht ose kryesisht me funksionet riprodhuese. Te qenit nene automatikisht i transferon asaj role perkujdesese pergjate gjitha jetes. Injorimi i gruas ne shume fusha por edhe ne tekste mund te duket si gabim njerezor, sjellja e stereotipave te jetes tradizionaliste ne shkrime e publikime duket se eshte veper e "fajtove pa faj". Keshtu do te ishte nese do te harronim se tekstet dhe publikimet jane instrumente te zhvillimit social, konjitiv, emocional, moral, politik e ideologjik te brezit te ri dhe autoret arkitekthe te qytetarise se neserme. Nese te rinjte do te vazhdojne te mos e ndiejne se vemendja ndaj edukimit gjinor, qytetar dhe demokratik nuk eshte nje ceshtje preferenciale por detyrim, atehere vajzat dhe grate do te vijojne te paraqiten te teperta dhe te dores se dyte.

Trajtimi i grave dhe vajzave si njerez te tepert dhe jo te barabarte ushqen totalitarizmin dhe perben ne vetvete nje perpjekje totalitare. Gjithashtu edukimi gjinor mbart edhe ceshtje te rendesishme sic eshte ai i raportit mes burrit dhe gruas. Rendom, keto raporte, jane ne favor te burrave. Kjo ushqen stereotipa, qe prekin jo vetem burrat dhe grate, por edhe shume aspekte te tjera te shoqerise, perfshire arsimin, praktikat e edukimit formal dhe jo formal te brezit te ri. Autoret e teksteve, akademiket e pedagoget duhet te kene parasysh dhe duhet te kujdesen qe ne temat qe trajtojne figurat femerore dhe mashkullore duhet te tejcojne nje ideologji te drejte mbi rolet dhe te drejtat sociale. Askujt nuk duhet t'i atribuohen apriori detyra dhe pritshmeri pikerisht pse eshte mashkull apo femer, burre apo grua, djale apo vajze. Duhet te trasmetohen tek studentet ideologji qe formojne me mire qytetarin dhe shtetarin e se ardhmes. Shoqeria, sidomos ajo shqiptare, e percepton gruan ne role te paracaktuara brenda familjes, madje edhe kur ajo eshte ne karriere, dikotomia e roleve eshte nje ceshtje gjithmone e zgjidhur ne favor te familjes. Edhe kur publikimet paraqesin gra te realizuara, ato sillen te mistifikuara, pa jeten e perditshem familjare, duke humbur keshtu mundesine per te qene proaktive ne zhvillimin dhe emancipimin e vajzave dhe grave. Sjellja e teresise se veprimtarive te grave te suksesshme edhe ne familje, edhe ne jete apo karriere do te jete njej shans per modele imponuese sociale si per djemte ashtu dhe per vajzat. Edukimi i grave dhe vajzave eshte baza e shendetit, paqes, zhvillimit te vendit dhe demokracise (Gjinore et al., 2008).

Sipas Androulla Vassiliou, Komisarë europiane për arsimin, “Korrelacioni ndërmjet gjinise dhe rezultatit edukativ ka ndryshuar dukshëm në pesëdhjetëvjeçarët e fundit dhe tani diferencat marrin formë më komplekse. Personeli arsimor përbehet përgjithësisht nga gratë, por sistemet edukuese menaxhohen nga burrat. Edhe pjesë më e madhe e të diplomuarve janë femra, ato akoma sot paguhen më pak e bëjnë më pak karriera se meshkujt” (EACEA P9 EURYDICE, 2009).

Duke konsideruar arsimimin dhe formimin, dallimet gjinore vazhdojnë të ndikojnë si në zgjedhjen ashtu dhe në rezultatet e kurseve të studimit.

Natyrë e pabarazisë gjinore në fushën arsimore ka ndryshuar rëndësisht vitet e fundit, dhe është bërë më vështirë për të përket performancës në shkollë. Në studimet tona është evidentuar se ende ekzistojnë dallime midis meshkujve dhe femrave si në zgjedhjen e studimeve, ashtu dhe në rezultatet në arsimin në Shqipëri. Vendi disponon politika në lidhje me barazinë gjinore në fushën e arsimit, me objektive kalimtare të rolëve tradicionale dhe të stereotipeve, duke u përqendruar në rritjen e numrit të grave në organet vendimtare, në kapërcimin e modeleve të obsoletë edukuese si dhe luftën ndaj ngacmimeve seksuale në shkollë, por ka një mungesë të thellë në aplikimin e këtyre politikave sidomos në zonat rurale, si dhe mungojnë iniciativat për të informuar prindërit rreth politikave për barazinë gjinore. Gjithashtu mungojnë politikat orientuese, dhe në mungesë të tyre, si meshkujt ashtu dhe femrat zgjedhin kryesisht kurse studimi që identifikohen me rolet e stereotipit tradicional: vajzat janë mëshioranca e të diplomuarve dhe të regjistruarve në shkencat sociale dhe humanitare, sidomos në sektorin e mesuesisë dhe mjekësisë, ndërsa masin në vështirësi në fushën e shkencave të saktë dhe teknologjike, me përqindje të ulët sidomos në fushën e inxhinierisë, matematikës dhe fizikës (“INSTAT,” 2011-2011).

Gjithashtu nga studimi i kryer del qartë se vajzat në përqindje më të madhe arrijnë në nivele më të larta arsimimi dhe kanë rezultate më të mira në provimet e diplomave në krahasim me meshkujt, që kanë më shumë probabilitet që të përsërisin vitin apo të braktisin shkollën. Sipas statistikave të kryera nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë kemi një rritje progresive të numrit të studenteve të regjistruar në Universitetet publike dhe private, nga 28331 që ishin në vitin akademik 1994/1995 në 158963 që ishin të regjistruar në vitin akademik 2011/2012 dhe pjesë më e madhe e tyre përbehet nga vajza 88512 të regjistruara në Universitetin shqiptarë ndërsa numri i djemve të regjistruar rezulton në 700451 (“INSTAT,” 1994-2011).

Përveç se në padrejtësinë lidhur me çdo stereotipizim gjinor, dallimet në arsimin mund të influencojnë negativisht edhe në rritjen ekonomike si dhe në përfshirjen sociale. Përsërisht, akoma gratë janë në minorancë në fushën matematikore, shkencore dhe teknologjike por nga ana tjetër kanë më shumë probabilitet në rezultate më të larta në fusha të tjera si letërsia. Këto shembuj tregojnë se në zhvillimin e politikave dhe strategjive me synim përmirësimit të rezultateve edukuese duhen marrë parasysh dallimet gjinore në fushën edukuese.

Është e nevojshme që në shkollë të krijohen praktika për të edukuar studentët rreth “gjinisë”. Me këtë term nënkuptohen të gjitha leksionet dhe kurset që informojnë

dhe mundesojne ne prishjen e stereotipeve qe kane te bejne me rolin social, perfaqesimin dhe kuptimin e te qenit grua dhe burra. Keto stereotipe sipas te cileve ,per shembull, grate jane te orientuara per te zhvilluar disa pune te caktuara si kujdesi ndaj femijeve, pleqve e shtepise, dhe burrat perkundrazi te orientuar per te bere pune qe prodhojne te ardhura dhe per karriere jane prezente edhe ne tekstet shkollore.

Te behesh grua apo burra nuk eshte nje proces linear. Ceshtja ndermjet sekseseve, meqenese eshte ceshtje kulturash dhe jetese, eshte edukuese. Per kete motiv, nje praktike pedagogjike gjinore, qe ofron degjim dhe ve ne qender fjalet e vazzave dhe djemve te rinj, eshte e vejtmja qe mund te ofroje mundesine e te kuptuarit te asaj cfare ndodh e cfare ndryshon. Ndaj i propozohet shkollës te hap nje refleksion te ri mbi kete endje te vetvetes grua apo burra, e cila eshte nje pune e perditshme. Imazhi i vetvetes ne te ardhmen, konfrontimi me ekseperienat e perjetuara dhe me marredheniet e te tashmes, eshte puna per rritje qe duhet te realizohet mbi te gjitha ne instituzionin edukues. Por shpesh shkolla ben te kunderten, per shembull ne momentin kur nuk kritikon role dhe injoron stereotipet gjinore, madje dhe i praktikon ato. Shkolla duhet ti ofroje gjithsecilit mjetet dhe mundesine per tu kuptuar, keshtu qe cdo femer dhe cdo mashkull te mesoje te pranoje dhe te ndaje intimisht brishtesine qe mbart. Shkolla eshte nje vend me maxhiorance gruan, por vete mesueset kane veshtiresi te perballojne tema dhe detyra te nje pedagogjie gjinore; paralelisht meshkujt kane ne shkolla pak modele te gjinise se tyre dhe jetojne shpesh me mungesa te tilla edhe ne familje. Eshte pikerisht ne istituzionet edukative aty ku thyhen gjenealogjite mashkullore sepse krijimi i dijeve te formalizuara i ben obsolete dijet tradicionale mashkullore. Nuk eshte e rastesishme qe ne shkollë meshkujt kane rezultate me te ulta; rruga e ndertimit te personalitetit, nga ana e nje mashkulli, eshte e shenuar nga rinisje te vazhdueshme, verifikime, dhe kerconime qe i vene ne dyshim viriletin. Ne arenen e nje refleksioni kritik mbi rolet gjinore dhe mbi pabarazine ndermjet femrave dhe meshkujve qe akoma sot duket nje fushe studimi kryesisht femerore, burrat, ne nje fare menyre jane te lene jashte. Kjo krize e mashkullores, e nenkuptuar si nje krize e vlerave tradicionale, mund te shihet si nje okazion per krijuar hapësira lirie dhe mundesi per te rinovuar e percaktuar me mire vendin qe i perket ne shoqeri. Te flasesh per ndertim te identitetit gjinor ne shkollë na lejon gjithashtu te perballemi me problematiken se si te krijohet nje dialog ndermjet gjeneratave te ndryshme, dhe se si te ndertohen hapësira dhe debate per te ndihmuar brezat e rinj qe keto tema ti ndjejne te tyret (“KILA,” n.d.).

Ndonjehere padashur dhe pavetedije edhe mesuesit apo pedagoget edukojne me stereotipe gjinore.

Pedagoget dhe akademiket duhet te bejne te tyren filozofine dhe metodologjine e nje edukimi gjinor te ekuilibruar, te gjithhepranuar, dhe jashte indoktrinimit gjinor, qe vjen nga njera apo tjetra gjini. Gjithashtu duhet te njohin nga afer dhe ne detaje tendencat globale, kornizat ligjore globale dhe lokale, politikat arsimore dhe dimensionet humane te kurrikulave shkollore.

Ndaj eshte shume e rendesishme perhapja dhe informimi per ceshtjen e ceshtjes gjinore te ekuilibruar, pra te nje edukimi gjinor jo te perqendruar dhe preferencial per njerin gjini, krahasuar me tjeteren, por qe synon nje pefaqesim te ekilibruar te te dyja gjinive. Gjithashtu eshte shume e qarte nevoja qe per publikime, tekste e programe mesimore me ekuiliber gjinor te mjaftueshem, larg stereotipeve e te ndjeshem nga prespektiva gjinore.

Nepermjet kerkimit tone shkencor jemi munduar te analizojme menytrat dhe politikat nepermjet te cilave vendet perballet me pabarazine gjinore ne fushen e arsimit. Jemi perpjekur te zhvillojme gjithashtu dhe nje analize te eksperiencave nderkombetare dhe europiane ne kete fushe, duke ngritur pyetjen nese arsimit ka rendesi ne percaktimin e politikave gjinore, dhe nese ekziston nje nivel gender mainstreaming ne politikat arsimore.

Sjellim ketu shembullin e Australise dhe Kanadase, vende te cilat i kane dedikuar nje vemendje sistematike ceshtjes ne fjale, dhe kane arritur ne rezultate interesante ne integrimin e politikave feministe me ato arsimore. Mjafton te permendim faktin se, qe ne 1975, raporti i Komisionit te Shkolles se Commonwealth australiane ka identifikuar gjinine si nje problem per tu trajtuar edhe ne shkolle. Ne 1987 u aprovua nje Plan kombetar per arsimimin e vajzave australiane, qe perfshin tema si dhuna seksuale, barazia ekonomike midis burrave dhe grave, dhe eksperimentimet e para te bilanceve gjinore. Qe ne fillim, Australia ka privilegjuar gender mainingstreaming, duke vene si objektiv trasformimin e strukturave dhe politikave arsimore, ne vend qe te marre nga jashte projekte te perpunuara nga struktura te ndryshme qe punojne rreth barazise gjinore. U angazhuan ne krijimin e nje modeli orientues per pjesemarrje aktive, fale lidhjes ndermjet funksionareve te qeverise dhe komunitetit, ku themelore qe roli i sindakatave te arsimit dhe presionet nga ana e levizjeve feministe. Gjithashtu pati nje fokusim ne krijimin e nje politike rekrutimi, formimi dhe certifikimi te personelit, por nuk u arrit te behet i detyrueshem formimi rreth gjinise per shkak te rezistences se Universiteteve. Por duke u nisur nga vitet 90, u evidentua dobesi ne politikat qe kane gjithmone nevoje ne gjetjen e mbeshtjes dhe konsensit politik, burokratik, te shoqerise civile dhe te levizjeve te ndryshme. Te njejten eksperienze ka perjetuar edhe Kanadaja. Ne kete vend, ne vitet '70, levizja e grave arriti te terheqe vemendjen e qeverise per te krijuar nje Komision kombetar mbi kushtet e grave, fale dhe kontributit te universiteteve per kerkimin shkencor dhe sindakateve. Nga nje kendveshtrim fillestar te bazuar mbi shanset e barabarta, shume shpejt u kalua ne konceptin e dallimeve, duke rivleresuar specifikimet femerore, e duke u fokusuar ne zgjedhje qe trasformojne sistemin arsimor apo ate te kurrikules. Por me kalimin e kohes, edhe ne kete rast vemendja devijoi ne problemet e te rinjve ne shkolla, dhe ceshtjet gjinore u bashkangjiten me problematika te tjera perjashtuese.

Per te kuptuar problematiken e edukimit gjinor ne arsim, ne kerkimin tone shkencor jemi perqendruar gjithashtu ne analizen e politikave dhe legjislationit nderkombetar dhe kombetar rreth te drejtave te grave per barazi ne arsim. Ne nivelin e Kombeve te Bashkuara, nje nga tete objektivat e mijejekarit te vendosura ne Samitin e Mijejekarit, mbajtur ne New York ne vitin 2000, eshte eliminimi mundesisht deri ne

vitin 2005, i diferencave gjinore ne arsimin fillor e te mesem dhe deri ne vitin 2015 ne te gjitha nivelet e arsimit ([www.un.org/en/development/deagenda/millennium.shtml](http://www.un.org/en/development/deagenda/millennium.shtml)). Gjithashtu Konventa per Eliminim e te Gjithave Formave te Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) ([www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/](http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/)), ratifikuar nga Shqiperia ne vitin 1993 i kushton rendesi te vecante barazise gjinore dhe mosdiskriminimit te grave dhe vajzave. Duke qene se eshte ratifikuar nga qeveria shpitare, te gjitha nenet e Konventes i bashkangjiten legjislacionit egzistues kombetar. Ne menyre specifike, shteti shqiptar duke ratifikuar kete dokument, duhet te marre te gjitha masta e nevojshme per te menjanuar diskriminimin e gruas, me qellim qe asaj ti garantohen te drejta te barabarta me burrin ne fushen e arsimit mbi bazen e parimit te barazise midis gruas dhe burrit.

Nje tjetër dokument i rendesishem persa i perket kerkimit tone eshte "Platforma per Veprim", fryt i "Konferenca e Katert Boterore e Grave" zhvilluar ne Pekin ne shtator te vitit 1995 e mbeshtetur nga 180 vende, me fokus kryesor parimet universale te drejtesise gjinore ([www.un.org/womenwatch/daw/beijing/platform](http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/platform)). Platforma per Veprim e Pekinit perfshin nje seksion te vecante per Arsimin dhe trajnimin e grave dhe vajzave ([www.un.org/womenwatch/daw/beijing/platform/educa.htm](http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/platform/educa.htm)). Objektivat strategjike te identifikuar ne kete seksion si dhe aksionet qe duhen nderrmarre jane: sigurimi i mundesive te barabarta per tu arsimuar; zhdukje te analfabetizmit ne rradhet e grave; permiresim i mundesive te grave per te marre trajnime per te shfrytezuar shkencen e teknologjine dhe arsimimin e vazhdueshem; zhvillimi i nje arsimit dhe trajnimit jodiskriminues; shperndarje e burimeve te mjaftueshme mbi dhe per monitorimin e zbatimit te reformave ne arsim; promovimi i nje arsimit afatgjate si dhe kualifikimi i grave dhe vajzave. Duke pranuar se arsimi jodiskriminues kontribuon ne marredhenie me te barabarta midis grave dhe burrave, Platforma per Veprim identifikon dhe fushat ne te cilat ekziston nje arsim i tille diskriminues duke perfshire: qendrimet tradicionale; martesat dhe shtatezanite e hershme; mungesa e ndergjegjesimit gjinor ne sektorin e arsimit; pergjegjesite shtepiake te vajzave dhe grave dhe koha e paket qe ato kane ne dispozicion per tu arsimuar, ngacmimi seksual. Persa i perket diskriminimit ne arsim, ai eshte i pranishem ne: mesimdhenien dhe materialet e papershtatshme bazuar ne paragjykimin gjinor; mungesen e lehtesirave per tu arsimuar, ne vecanti ne pershtatje me nevojat e vajzave, imazhet e e stereotipizuara te grave dhe burrave ne materialet dhe mesimdhenien ne arsim; programet me paragjykim gjinor dhe materialet mesimore, qe perforcojnerolet tradicionale seksuale; programet dhe tekstet shkencore qe bartin paragjykim gjinor; burimet e pamjaftueshme te arsimit, sidomos per grate dhe vajzat. Platforma per Veprim rekomandon strategji specifike per secilin prej faktoreve te mesiperme dhe perkrah perdorimin e rrugeve per ndryshim, te tilla si shfrytezimi i plote i potencialit edukues te masmedias, duke synuar perfshirjen e grave ne zhvillimet teknologjike ne fushen e arsimit.

Ne nivel europian edukimi shihet ne funksion te konkurrences ekonomike dhe politikat gjinore ne fushen arsimore propozohen kryesisht per te promovuar pjesemarrjen e vajzave ne profesionet shkencore dhe teknologjike. Vullneti per te zbatuar politika dinamike te formimit shkencor dhe per t'ju dhene qytetareve aftesi dhe kompetenca per tu adaptuar ne tregun e punes ne ndryshim gjen zbatim ne



Keshillin e Lisbonës të 2000 ([http://www.europarl.europa.eu/summits/lis1\\_it.htm](http://www.europarl.europa.eu/summits/lis1_it.htm)), nga ku u aprovua dhe Traktati me të njejtin emër në vitin 2007 si dhe programi i punës “Arsim dhe Trajnim 2010”, me synim përcaktimin e kompetencave për mesimin përgjate jetës (lifelong learning), uljen e analfabetizmit si dhe uljen e përqindjes së braktisjes së studimeve. Objektivat strategjike që synohen janë rritja e cilësive dhe efikasitetit të sistemeve arsimore dhe formuese; thjeshtësimi i aksesit në sistemet arsimore dhe trajnuese; hapja e sistemeve arsimore dhe formuese ndaj botes së jashtme ([www.itisavezzano.it/download/lastrategiadiLisbona.pdf](http://www.itisavezzano.it/download/lastrategiadiLisbona.pdf)). Sot me shumë së kurre, politikën europiane për arsimin janë mbi të gjitha politika barazie, të orientuara në përfshirjen e grave në strukturat sociale-ekonomike dhe në pushtetet egzistuese, sesa në transformimin e mënyrës me të thëlle të vete strukturave. Nga puna si temë dominuese u kalua gradualisht në përfshirjen e temave të tjera, por arsimi akoma nuk duket një sektor i prekur nga gender mainstreaming. Gjithashtu konsiderimi i politikave të shanseve të barabarta si gjithëpërfshirëse në 360° duke përfshirë jo vetëm gratë por edhe subjekte të tjera, kontribuon në zhvishjen e konceptit duke e bërë neutral në krahasim me gjininë. Në politikën europiane për arsimin hasim objektivin e uljes së izolimit gjinor të karrierave në fushat teknologjike dhe shkencore. Nder objektivat strategjike të dhjetëvjeçarit të ardhshëm janë dhe ato të rekrutimit dhe të trajnimit të mesuesve, të cilëve u kërkohet kujdes ndaj dallimeve kulturore dhe gjinore. Nenshtrimi i politikave gjinore nën objektivin e nxitjes së punësive së grave, përtej stereotipeve gjinore, shihet edhe në dokumentat e policy dedikuar shanceve të barabarta të Drejtorisë Gjenerale Punesim dhe Pune Sociale, të Keshillit të Europës, si përsëmbull Road Map.

Përsa i përket instrumentave legjislativë europiane të të drejtave të njeriut dhe garantuesve të parimit për barazinë gjinore bazat themelore janë Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ([www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_ENG.PDF](http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.PDF)), e firmosur në Romë vitin 1950 dhe 14 Protokollët e saj shtesë, si dhe Karta Sociale Evropiane (<http://conventions.coe.int/Treaty/ita//Treaties/Html/163.htm>), aprovuar në vitin 1961, e riparë në vitet 1991 dhe 1996 dhe Protokollët shtesë të 1988-s dhe 1995-s.

Artikulli 14 dhe Protokollin numer 12 i Konventës Europiane për mbrojtjen dhe të Drejtave Themelore të Njeriut kanë kontribuar në përmirësimin e mbrojtjes legjale dhe të statutit të grave në dekadat e fundit duke vënë si parim mos-diskriminim gjinor për gezimin e të drejtave themelore. Protollin me numer 13 i aprovuar në vitin 1952 me artikullin e tij numer 2 garanton të drejtën për arsim. Sipas këtij artikulli e drejta për arsim nuk mund të mohohet asnjëherë. Shteti, në ushtrimin e detyrave që ka në fushën e arsimit dhe edukimit, duhet të respektojë të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe këtë arsimim sipas bindjeve të tyre fetare dhe filozofike (<http://conventions.coe.int/Treaty/ita/Treaties/html/009.htm>).

Përsa i përket kontekstit kombëtar në lidhje me edukimin gjinor dhe barazinë gjinore, egzistojnë politika të ndryshme si dhe një legjisllacion i rishikuar dhe i përmirësuar. Arsimi në Shqipëri është një përparësi kombëtare (Ligji Nr.7952 “Për Arsimin Parauniversitar”, datë 21.06.1995), dhe sipas Kushtetutës së Shqipërisë cdo njeri ka të drejtën për t’u arsimuar (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë). Arsimi

tevejecar dhe arsimit mesëm, sipas nenit 57 të Kushtetutës, është falas. Ka një sërë arsyesh që na shtyjne ta nisim analizën e të drejtave të grave pikerisht nga Kushtetuta, pasi është ligji suprem në të cilin deklarohen politikat dhe vlerat më të thella të shtetit shqiptar. Sipas nenit 3 të Kushtetutës dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë. Gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese.

Kjo do të thotë se parimet e të drejtave dhe liritë themelore të njeriut janë pjesë integrale e të gjithë legjisllacionit në përgjithësi dhe e çdo ligji e akti nënligjor në vecanti. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk trajton në mënyrë të vecuar të drejtat e grave por duke qenë një dokument sa politik aq edhe normativ, në mënyrë telegrafike ajo i ka gjetur vendin e duhur kujdesit ndaj gruas si nënë. Kushtetuta ka shprehur detyrimin për një mbrojtje të vecantë nga shteti për nënat e reja dhe frate shtatzena në nenin 54 të saj. Në Kushtetutën shqiptare përdoren parimet e tillë si “të gjithë”, “kushdo”, “askujt”, “secilit”, etj, për të treguar se bashkësia njerezore të cilin i drejtohet dispozita nuk bën asnjë përjashtim, asnjë diskriminim, sepse të drejtat dhe liritë themelore u garantohen të gjithëve, gra e burra, të mitur e madhore, shtetas shqiptarë e të huaj, pakicave kombëtare etj. Pjesa e dytë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i kushtohet “Të drejtave dhe liritë themelore të njeriut” dhe është e ndarë në katër krerë. Në kreun e katërt trajtohen liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, ku bën pjesë e drejta për arsim (GADC, Aleanca Gjimore për Zhvillim, Të Drejtat e Grave në kontekstin e të Drejtave të Njeriut, Mediaprit, Tiranë 2008). Në nenin 18 të Kushtetutës së Shqipërisë, përcaktohet se të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkak të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale. Në bazë të këtij neni, i njohur ndryshe edhe si neni anti-diskriminim, çdo shtetas ka të drejtë për një arsim të barabartë pa diskriminim gjinie, race, feje, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendje ekonomike e sociale. Ky parim është transformuar në ligj në korrik të vitit 2004 me miratimin e Ligjit “Për një Shoqëri Gjimore të Barabartë” (Ligji Nr. 9198 “Për një Shoqëri Gjimore të Barabartë”, datë 1.07.2004). Ligji në fjalë synon të plotësojë kuadrin ligjor lidhur me të drejtat e barabarta për burrin dhe gruan, dhe konsiston në vendosjen e të dyjave seksëve në pozita të barabarta në fushën e arsimit, punësimit dhe vendimarrjes.

Një përmirësim të dukshëm të legjisllacionit shqiptar në lidhje me barazinë gjimore dhe edukimin gjimor e sjell miratimi i ligjit me numër 9970, në datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjimore në Shoqëri”. Ky ligj parashikon ngritjen e institucioneve dhe mekanizmave qeveritare dhe lokale për hartimin e politikave qeveritare për barazinë gjimore, aprovimin e një strategjie kombëtare, vlerësimin dhe monitorimin e situatave konkrete. Nder të tjera neni 4 dhe pikat e këtij ligji përcaktojnë termat kryesore dhe të studimit të pikat 1,2,3,4, Neni 4, Ligji Nr. 9970 “Për Barazinë Gjimore në Shoqëri”, datë 24.07.2008):

1. “Barazi gjimore” është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjitha fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri,

duke perfituar njelloj nga arritjet e zhvillimit te saj.

2. "Perkatesi gjinore" jane mundesite dhe atributet shoqerore, te lidhura me te qenit femer apo mashkull, si dhe marredheniet ndermjet tyre

3. "Diskriminim per shkak te gjinise" eshte cdo dallim, perjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, qe ka per qellim ose per pasoje demtimin, mosnjohjen, mosgezimin dhe mosushtrimin, ne menyre te barabarte, nga secila gjini, te te drejtave te njeriut dhe lirive te parashikuara ne Kushtetute dhe ne ligje, ne fushat politike, ekonomike, shoqerore, kulturore e civile

4. "Integrim gjinor" eshte procesi qe zhvillohet ndermjet femrave dhe meshkujve, si nje proces qe nuk i perket vetem njerës gjinisi grup i vecuar, shoqerise ne teresi. Si i tille, integrimi gjinor eshte rruga per arritjen e barazise gjinore ne shoqeri, nepermjet perfishirjes se prespektives se seciles nga gjinite ne te gjitha proceset ligjvenses, politikeberese, planifikuese, zbatuese e monitoruese.

Gjithashtu ligji me Nr.9970 i dedikon barazise gjinore ne arsim pjesen e tij te peste me titull "Trajnimi i barabarte dhe mbrojtja nga diskriminimi per shkak te gjinise ne arsim dhe kualifikim". Ne nenin 24 (Pikat 1,2, Neni 24, ibidem) parashikohet ndalimi i pabarazise per shkak te pekatesise gjinore ndaj personave nga/ne institucionet arsimore te te gjitha niveleve, publike ose private. Ne piken e dyte te ketij neni perbejne diskriminim rastet kur parashikohen norma kufizuese, bazuar ne dallime gjinore dhe pengohet krijimi i lehtesive te nevojshme per tu arsimuar prane institucioneve shteterore ose private, qe ofrojne arsimin apo sherbime te tjera kualifikimi e trajnimi. Gjithashtu perbejne diskriminim rastet kur krijohen mundesi te ndryshme e te pajustificuara objektivisht ndaj burrit dhe gruas, per zgjedhjen e nje fushe te vecante studimi, trajnimi, diplomimi, si dhe per kohezgjatjen e mesimit. Por me rendesi te vecante per studimin tone eshte neni 25 i ligjit ne fjale. Ky nen permban bazen legjislative per edukimin e barazise gjinore (Neni 25, Edukimi i barazise gjinore, Ligji Nr. 9198 "Per Barazine Gjinore ne Shoqeri", date 1.07.2004). Pika e tij e pare percakton se subjektet, qe ofrojne arsimim, kualifikim e trajnim, si dhe ata qe formulojne tekste, programet dhe materialet e tjera mesimore, ne te gjitha nivelet, sigurojne mesimdhenien e njohurive te nevojshme dhe perdorin metoda mesimdhenieje, trajnimi e kualifikimi, ne menyre te tille qe te ndihmojne ne promovimin, nxitjen dhe formimin e edukates se barazise dhe ne ndalimin e diskriminimit per shkak te gjinise, te stereotipave negative, paragjykimeve dhe praktikave zakonore ose te cdo lloji tjetër, qe cenojne parimet e barazise gjinore. Pika e dyte e nenit 25 vendos se institucionet e arsimit te larte, ne menyre te vecante, sipas fushave perkatese, nderrmarrin nisma per kryerjen e studimeve ne fushen e barazise gjinore, ose e perfishjne ate ne studimet e kryera, per te siguruar materiale me informacionin perkatese, si dhe per ti paraprire zhvillimit praktik e shkencor te kesaj fushe.

Sic shihet baza ligjore ne Shqiperi eshte shume e zhvilluar persa i peket edukimit gjinor ne vendin tone dhe barazise gjinore. Nje nga ceshtjet kryesore mbetet hendeku ndermjet barazise je jure (ajo cka ligji deklaroi) dhe de facto (realiteti konkret), dhe ajo cfare shqeteson dhe mungon me shume eshte aplikimi dhe konkretizimi

i keture masave dhe politikave. Ne kete menyre ka nje ndryshim te dukshem ndermjet konceptit te barazise midis burrave dhe grave sipas parashikimeve ligjore me ate qe ndodh dhe zbatohet realisht. Gjithsesi ka nje tendence qe ky boshlek te plotesohet me praktika pozitive. Nje kontribut me vlere ne kete drejtim kane dhene dhe vazhdojne te japin Organizatat joqeveritare shume aktive dhe te dedikuara ne fushen e ndergjegjesimit dhe mbrojtjes se te drejtave te grave dhe vajzave.

### **3-Konkluzione**

Kerkimi yne shkencor mundohet te nxjerre perfundime dhe propozime te reja nga eksperienca nderkombetare por dhe ajo kombetare. Shkolla duhet te ndjeke objektivat e edukimit per nje integrim gjinor ne shoqeri dhe promovim dhe perhapje te nje kulture jodiskriminuese. Tema e dallimeve gjinore eshte vendimtare per nje shkolle cilesore dhe per orientimin ne moshe te re, sidomos per vajzat, per te cilat jane te rendesishme masa dhe programe specifike per ti ndihmuar ne hyrjen ne tregun e punes. Por fatkeqesisht, behet fjale per tema qe nuk kane vemendjen e duhur dhe qe meritojne dhe rrezikojne te kalojne ne plan te dyte per shkak te sjelljeve mbrojtese te fuqive dhe interesave te perfituara.

Objektivi eshte dhe promovimi i zhvillimit te nje shoqerie aktive, e bazuar ne respektimin dhe vleresim te diversiteteve kulturor dhe gjinor, si celes interpretimi te realitetit per te luftuar stereotipet dhe diskriminimet. Gjithashtu sugjerohet krijimi dhe ekperimentimi i formave te edukimit dhe mesimit me metodologji aktive dhe jo frontale, te afta ne perfshirjen e drejtperdrejte te perfituesve pergjate formimit, qe ofrojne strumente te nje njohurie e leximi kritik sesa nozione, duke stimuluar keshtu eksperimentimin e praktikave te drejta si dhe kreativitetin.

Studimi yne na shtyn te propozojme reforma dhe strategji ne disa pika kyce me qellim permiresimin e rezultateve me baze gjinore ne sistemin arsimor ne Shqiperi: -Edukim gjinor ne te gjitha nivelet arsimore.

Eshte shume e rendesishme perhapja e nje edukate respektuese dhe jodiskriminuese nder brezat e rinj. Duhet investuar ne nje permiresim te programeve mesimore ne te gjitha nivelet e sistemit arsimor duke integruar ne to konceptet e barazise gjinore dhe e nxisin ate. -Trajnim te mesuesve dhe pedagogjeve.

Eshte gjithashtu e nevojshme kualifikimi konstant i aktoreve kryesore ne formimin e drejteperdrejte te studenteve. Duhet sensibilizuar dhe informuar mesuesit dhe akademiket rreth parimit te barazise gjinore nepermjet kurseve dhe trajnimeve formuese. Permes pjesemarrjes se grave dhe vajzave ne mesimdhenien, por edhe shtimit te numrit te tyre ne postet menaxheriale gjithashtu mund te arrihet nje integrim gjinor me i madh ne arsimin shqiptar.

-Krijimi i aktiviteteve dhe laboratoreve trajnimi ne shkolla, ne qendrat e formimit profesional si dhe prane strukturave publike.

Si rrjedhoje, eshte shume e rendesishme forcimi i kapaciteteve te institucioneve arsimore per te integruar ceshtjeten dhe konceptet e barazise gjinore ne strukturat edukuese. Nepermjet laboratoreve dhe punes ne grupe mund te arrihet shperndarja

sa me e gjere e informacionit dhe politikave te ndryshme te nderrmarra nga institucionet perkatese.

-Eliminim te koncepteve diskriminuese ne tekstet dhe publikimet akademike.

Arsimi ne te te gjithë perberesit e tij, pra edhe ne tekte dhe publikime, duhet te permbushë detyra te emancipit shpirtëror dhe zhvillimit social te individit. Eliminimi i stereotipeve ne tekstet shkollëore dhe akademike ndihmon ne zhvillimin e nje shoqërie te barabarte, ku te rinjte nuk identifikojnë njeri tjetrin ne baze te diferencave gjinore, kulturore apo ekonomike. Respektimi i te drejtave te barabarta dhe promovimi i tyre ne tekste ndihmon ne nje emancipimin te shoqërisë dhe klimes paqesore ne te.-Informim dhe edukim aktoreve kyc shoqëror si familja.

Edukimi duhet te kalojë nepermjet vajzave dhe djemve per te arritur drejtperdrejt ke familja. Ajo është baza e cdo shoqërie dhe luan rolin e edukimit te brezave pekrahe shkolles, ndaj edukimi i familjes me konceptet e barazisë gjinore ndihmon ne forcimin dhe zhvillimin e saj.

-Aplikim dhe njohje reale te ligjeve qe trajtojnë ceshtjet e perkatesise gjinore.

Ligjet e aprovuarua ne sistemin tone legjislativ krijojnë hapesira per inicitativa rreth ceshtjeve te perkatesise gjinore. Ato garantojnë barazine dhe te drejtat e grave e vajzave si dhe kujdes te vecante per arsimimin e tyre. Por veshtiresia qendron ne nje njohje shume te pakte te tyre sidomos ne zonat rurale te vendit. Kjo con ne mosndalim te paragjykimeve tradizionale qe imponojne vajzat dhe grate ti nenshtrohen dhunes, keqtrajttimeve dhe braktisjes se shkolles. Ndaj është shume e rendesishme perhapja e informacionit rreth te drejtave qe grate dhe vajzat gezojnë dhe se ligjet duhen mbrojtur dhe aplikuar nga te gjitha strukturat qeverisese vendore.

Ka ende hapesire per te thelluar edhe me tej kete studim si dhe per te trajtuar argumenta te tjere qe lidhen me principin e barazisë gjinore ne shoqëri. Por u perpoqem te perqendrohemi ne analizen e kuadrit arsimor, duke evidentuar problemet reale si dhe hapat e rendesishem te kryer ne nivele institucionale me polikita dhe legjislazone bashkekohore. Objektivi i studimit tone është sensibilizimi dhe perhapja ndaj nje teme kaq te rendesishme dhe delikate sic është barazia gjinore, dhe sidomos roli i saj kyc ne arsim. Eshtë i nevojshem edukimi i brezave te ardhem per tu ndergjegjesuar se te gjithë janë te barabarte jo vetem para ligjit por edhe ne shoqëri, ne arsim, ne tregun e punes, ne kulture, ne familje dhe ne jeten e perditshme.

Organizata boterore e shendetesise konstaton se shkak u kryesor i vdekjeve femerore është rrjedhoje, me shume se nga semundje te renda si tumori, e dhunes se ushtuar ndaj tyre nga burrat (<http://www.who.int/research/en/>). Mjafton kjo e dhene per te na kujtuar se i vetmi dhe i fundit revoluzion i "Shekulli i ekstremeve", qe historiani Eric Hobsbawm e identifikonte ne revoluzionin femeror, nuk është permbushur akoma (Hobsbawm E. J., Age of Extremes - The Short Twentieth Century 1914-1991, Pantheon Books, New York, 1994). Ndaj është me shume

se kurre e rendesishme kunderveprimi ndaj stereotipeve qe prodhojne sjellje discriminuese, shtypese dhe te dhunshme ndaj grave dhe vajzave por te promovohen marredheniet empatike duke perfshire ne edukimin gjinor jo vetem studentet por edhe mesuesit, pedagoget dhe familjet.

Vleresimi dhe respektimi i figures se gruas dhe vajzes, si nje aktore kryesore ne shoqerine dhe ekonomine shqiptare eshte hapi i rendesishem qe duhet te ndermarre gjithsecili. Roli qe duhet te luaje bota akademike dhe shoqeria civile eshte vendimtare per perhapjen e edukimit gjinor, per te kontribuar ne zhvillimin e shoqerise sone, qe te jete e afte te perballoje sfidat e se ardhmes sic eshte integrimi ne Bashkimin European. Familja europiane nder kriteret kryesore per t'iu bashkuar imponon respektimin e te drejtave te njeriut, dhe sidomos garantimin dhe mos-diskriminim e vajzave dhe grave. Duke u nisur nga djepi i dijes per te promovuar dhe mbrojtur dinjitetin dhe te drejtat e grave dhe vajzave eshte rruga e duhur qe duhet ndermarre per nje shoqeri te zhvilluar, demokratike dhe europiane.

**Referencat:**

A cura di: Gamberi C., Maio M. A., Selmi G., Educare al genere. Riflessioni e strumenti per articolare la complessità, Carocci, Roma 2010.

EACEA P9 EURYDICE, Gender Differences in Educational Outcomes: Study on the Measures Taken and the Current Situation in Europe, Eurydice, Bruxelles, December, 2009.

GADC, Aleanca Gjimore per Zhvillim, Prespektiva Gjimore ne Tekstet Shkollore. Udhezues per shtepite botuese te teksteve shkollore, Pegi, Tirane, 2008.

INSTAT, Studente per cdo Universitet dhe Fakultet sipas Programeve te studimit, viti akademik 2011-2011 ne Arsimin Publik, [www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx](http://www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx)

INSTAT, Studente te regjistruar per cdo Universitet dhe sipas gjinise vitet 1994-2011, [www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx](http://www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx)

KILA, Il punto di vista delle donne, Educare alle differenze di genere:nodo cruciale per un orientamento di qualità, [www.kila.it](http://www.kila.it)





**Elona MUSTAFARAJ**  
 Universiteti "Aleksandër Xhuvani"  
 Elbasan/Shqipëri

## **Rehabilitimi me Bazë Komunitarë, Sfidë e Shërbimeve Psiko-Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuar**

### **Abstrakt**

*Ky punim është një përpyetje për të paraqitur një nga sfidat më të rëndësishme të shërbimeve psiko-sociale sot, rehabilitimin me bazë komunitarë për personat me aftësi të kufizuar. Qëllimi i programeve rehabilituese është "Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar, familjarëve të tyre dhe komunitetit nëpërmjet promovimit të gjithëpërfshirjes, eliminimit të stigmës, dhe lehtësimit të aksesit në shëndetësi, edukim dhe mundësi të barabarta". Puna me personat të cilët janë prekur që nga lindja ose jo, nga aftësia e kufizuar fizike, shqisore apo mendore sot është një kërkesë e drejtuar ndaj profesionistëve të shërbimeve sociale, organizatave, institucioneve dhe të tjerë aktorëve të cilët operojnë në këtë fushë. Rehabilitimi me bazë komunitare është një mundësi për të ndërhyrë duke ndërthurur, shërbimet psikologjike, sociale, arsimore, shëndetësore, kulturore dhe ekonomike. Zbatimi i programeve me bazë komunitarë është sfidë sepse kërkon specialistë të trajnuar për njohjen e parimeve dhe llojit të ndërhyrjeve, kërkon mbështetje financiare, ndërgjegjësim të opinionit publik dhe mbi të gjitha bashkëpunimi të ngushtë me personat me aftësi të kufizuar dhe komunitetit. Në fund të fundit kjo është edhe ajo që kërkohet të arrihet nga implementimi i programeve të tilla.*

*Realizimi i këtij punimi është mbështetur në Guidën e Rehabilitimit me Bazë Komunitarë si një udhëzues i promovuar nga Organizata Botërore e Shëndetit, Organizata Botërore e Kulturës dhe Arsimit dhe së fundi (2004) nga Organizata Botërore e Punës.*

*Rekomandimet e punimit theksojnë se në përpyekjet për t'i ardhur në ndihmë personave me aftësi të kufizuar hartimi i programeve me bazë komunitare duhet të jenë fokus i qeverisjes qendrore e lokale, i vetë orgazniztave të personave me aftësi të kufizuar dhe çdo organizmi tjetër të interesuar. Përfitues të programeve të tilla do të ishin personat me aftësi të kufizuar, familjarët, specialistët e shërbimeve psiko-sociale, organizmat e ndryshëm, komuniteti, e të tjerë.*

**Fjalët kyçe:** Rehabilitimi me Bazë Komunitarë; Aftësi e Kufizuar; Shërbime Psiko-Sociale

## 1-Hyrje

Sot gjithnjë e më shumë, shërbimet psiko-sociale, ndaj personave me aftësi të kufizuar, po shkojnë drejt shërbimeve me bazë komunitare, si një mundësi më shumë për të afruar këta persona me komunitetin në të cilin jetojnë. Eksperienca e shërbimeve me bazë komunitare ka treguar se këto programe janë të efektshme pasi ato orjentojnë jo vetëm drejt personit me aftësi të kufizuar por edhe ndaj familjarëve dhe komunitetit. Mbi të gjitha, ato janë programe aktive ku personi me aftësi të kufizuar është pjesë aktive e ndërhyrjes.

Rehabilitimi me bazë komunitar është një përpjekje për të përqasur riaftësimin e personave me aftësi të kufizuar fizike, shqisore apo mendore, në komunitet duke i larguar nga institucionet e kujdesit të veçantë dhe duke shmangur në këtë mënyrë izolimin social dhe psikologjik të tyre.

Nga disa vlerësime të bëra nga Organizata Botërore e Shëndetit (2011), është parë se 10% e popullsisë në botë është me aftësi të kufizuar dhe pjesa më e madhe e tyre (pra e 10%) rreth 80% jetojnë në vendet në zhvillim. Nisur nga kushtet specifike social-ekonomike në të cilat janë vendet në zhvillim, personat me aftësi të kufizuar janë një nga grupet më vulnerabël dhe pak të fuqizuar përse i përket këtyre kushteve. Ata shpesh i shoqëron stigma, diskriminimi në aksesin në kujdesin shëndetësor, arsim dhe mundësitë në jetë.

Rehabilitimi me Bazë Komunitar është parë si një strategji për të siguruar akses në shërbimet rehabilituese për personat me aftësi të kufizuar në vendet në zhvillim. Rehabilitimi me Bazë Komunitare (RBK) është përpjekja e parë e Organizatës Botërore të Shëndetit (WHO) në vitin 1978 dhe rezultat i Deklaratës së Alma-Ata (Deklarata e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar) për të ndryshuar kushtet e trajtimit të personave me aftësi të kufizuar në shoqëri (WHO, 2011).

## 2-Komponentët e Programeve me Bazë Komunitare

Programet e Rehabilitimit me Bazë Komunitare (Velema et al., 2008) kërkojnë që ndërhyrja të realizohet në të gjithë komponentet që përbëjnë jetën e gjithësecilit prej nesh në komunitet. Komponentët në të cilët ndalet dhe mund të ndërhyjnë programet e Rehabilitimit me Bazë Komunitar janë si mëposhtë:

Aksesi në informacion – rëndësia e këtij elementi është thujse jetik në jetën e personave me aftësi të kufizuar. Krijimi i hapsirave për të marrë informacionin nëpërmjet pajisjeve të posaçme, lehtësuese dhe mbështetëse, është një mekanizëm që lehtëson jetën e tyre. Kjo është detyrë e çdo shoqërie nisur nga fakti se askush nuk është i mbrojtur nga aftësia e kufizuar qoftë, e cilado lloj forme qoftë ajo.

Programet e Rehabilitimit me bazë Komunitar krijojnë mundësinë jo vetëm të përdorimit të materialeve ekzistuese por edhe të realizimit të pajisjeve dhe programeve të reja teknike që do të përmirësojnë jetën e personave me aftësi të kufizuar, familjarëve të tyre dhe të gjithë shoqërisë.

1) Komponenti social - duke patur parasysh çdo marrëdhënie dhe mundësinë për t'i ndërtuar ato. Personat me aftësi të kufizuar sikurse, edhe të tjerët pa aftësi të kufizuar, kanë mundësinë të përfitojnë nga marrëdhëniet me të tjerët duke shkëmbyer informacion, emocione, ide, nevoja, mundësi, aftësi, etj.

2) Komponenti jetik - Është tërësia e aktiviteteve dhe veprimtarive që realizohen në jetën e përditshme. Ky komponent përfshin aftësinë për tu kujdesur për vehten, për familjen dhe për komunitetin. Aftësia për të realizuar edhe qoftë punët rutinë ekziston dhe ky është një element i rëndësishëm në konceptin e vetëvlerësimit dhe vetërespektit.

3) Arsimi – Komponenti i arsimit është parë si një mundësi për të ndryshuar kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre. Arsimi është një mundësi e mirë për të rritur shkallën e pavarësisë, sepse ai nuk përfshin vetëm dije por edhe edukim. Misioni i këtij të fundit shkon shumë më larg sesa dija. Në rastin e personave me aftësi të kufizuar kemi një nocion tjetër të lidhur me të mësuarin gjatë gjithë jetës, dhe realizimi i tij është më i efektshëm në komunitet.

4) Shëndetësia - apo aksesit në strukturat të cilat ofrojnë shërbime mjeksore për personat me aftësi të kufizuar. E drejta për një shëndet të mirë është një e drejtë themelore e cila sanksionohet edhe në Konventën e të Drejtave të Njeriut. Aksesit në shëndetësi është një mundësi për jetuar një jetë cilësore.

Nga sa më sipër evidentohet qartë se qëllimi final i RBK është fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar në aspektin personal (ngritja e kapaciteteve të tyre) dhe ndërpersonal (ngritja e kapaciteteve të të tjerëve). Duke njohur aftësitë dhe mundësitë reale të tyre kupton që ajo që duhet t'i shoqërojë është fuqizimi i kapaciteteve (Helander, 2001) të tyre dhe të personave të cilët punojnë për aftësinë e kufizuar, punonjësit e institucioneve dhe organizmave lokale duke përmirësuar kështu edhe cilësinë e shërbimeve që ata ofrojnë.

### 3-Përfituesit e programeve të Rehabilitimit me Bazë Komunitar

Përfituesit e RBK janë:

- Stafit që qendrave që punojnë me personat me aftësi të kufizuar
- Punonjësit e shëndetësisë, mësuesit, punonjësit social dhe të tjerë punonjës të komunitetit.
- Personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre.
- Organizatat e personave me aftësi të kufizuar dhe grupet e vetëndihmës;
- Zyrtarët qeveritarë përgjegjës për programet e aftësisë së kufizuar, veçanërisht zyrtarët e pushtetit vendor dhe liderat lokal;
- Stafit i orgnizatave joqeveritare dhe jofitimprurëse;
- Kërkuesit dhe akademikët;

Edhe pse kanë kaluar 33 vjet dhe qëllimi i RBK është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme, fokusi i tij vazhdon të mbetet: rritja e mundësive dhe vlerësimi i potencialit real të personave me aftësi të kufizuar (Evans & Brewis, 2008). Kategorizimi i të gjithë llojeve të aftësisë së kufizuar në një, nuk është e drejtë, është paragjykes dhe jo i mbështetur në profesionalizëm.

Në Shqipëri platforma e Rehabilitimit me Bazë Komunitar është përpjekje serioze për tu ardhur në ndihmë personave me aftësi të kufizuara, shqisore, fizike, apo mendore dhe familjarëve të tyre. Përpjekjet më të hershme i shkojnë shërbimeve të shëndetit mendor, të ngritura nën kujdesin e Organizatës botërore të Shëndetit dhe të përfaqësuar me qendrat komunitare të shëndetit mendor, me shtrirje ditore apo rezidenciale. Po kështu kemi rastin e shërbimeve për personat e verbër dhe me probleme shikimi, Sindromën Down dhe prapambetjet mendore.

Këto shërbime së bashku me programet e ofruara do të ndihmonin personat me aftësi të kufizuara për të dalë nga izolimi social dhe për tu përballur me pasojat e paaftësisë së tyre, të cilat në një masë të gjerë janë të një karakteri të shumfishtë (ekonomik, social, kulturor, shëndetësor, etj). E gjithë kjo ndërhyrje në kushtet e RBK kërkon që të gjitha aktivitetet dhe programet të ngriheshin dhe të zbatoheshin në komunitet (WHO, 1994-2004) aty ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye në çdo hap të programuar në këtë rast komuniteti është pjesë aktive e aktiviteteve duke bërë që herë të shkoj ai në qendrat dhe herë të shkojnë personat me aftësi të kufizuara te komuniteti.

Realizimi i suksesshëm i këtyre programeve kërkon bashkëpunim dhe mbështetjen e të gjithë aktorëve/institucioneve/organizatave jofitimprurëse të cilat ofrojnë shërbimet e tyre në vendet ku ngrihen qendrat e rehabilitimit dhe ku zbatohen programet RBK. Funksionimi i këtyre programeve i ngjan një zinxhiri, hallkat e të cilit i përgjigjen një funksioni të veçantë që luan secili prej aktorëve prezente.

Edhe pse dëshirat dhe pritshmëritë për arritje dhe sukses janë të mëdha sot jemi në një pikë të tillë ku shumë shërbime nuk ofrohen më. Pra ndërhyrjet me bazë komunitare kanë ngelur përgjysëm duke qënë se fati i tyre ka qënë i lidhur ngushtë me donacionet e donatorëve që i mbështesnin ato. Megjithatë kjo nuk qënë e vetmja sfidë për shërbimet komunitare. Sfidat tjera kanë qënë të lidhura me mungesën e informacionit, mungesën e njohurive dhe shprehive të shërbimit me bazë komunitare dhe patjetër, stigma, ndaj aftësive të trajnueshme dhe edukueshme të personat me aftësi të kufizuara.

Në ndërhyrjet e realizuara deri më tani drejtuesit e programeve raportojnë se (Veleva et al., 2008):

- Personat me aftësi të kufizuara jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe kanë nevojë për mjete të tjera financiare përpos pensionit të invaliditetit dhe ndihmës ekonomike.
- Personat me aftësi të kufizuara përfitojnë më shumë nga shërbime argëtuese, sesa nga mos pjesëmarrja në to.
- Aksesit në informacion dhe shërbime janë ndër problematikat më shpesh të evidentuara.
- Personat me aftësi të kufizuara sidomos shqisore kanë në përdorim shumë pak mjete tift teknike në jetën e përditshme, mësim, informim, komunikim, lëvizje dhe orjentim.
- Personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë të theksuara në transport.
- Personat me aftësi të kufizuara raportojnë forma pasive të argëtimit si dëgjimi

i radios, biseda, etj.

- Personat me aftësi të kufizuar janë të rrezikuar për t'u tërhequr nga shoqëria dhe të izolohen si pasojë e shumë vështirësive që kanë.
- Personat me aftësi të kufizuara kanë në një masë të madhe nevojë për prezencën, mbështetjen dhe ndihmën e njerëzve të tjerë në kryerjen e operacioneve të caktuara të jetës së tyre dhe nga ana tjetër kanë edhe një sens varësie psikologjike që shprehet në pritshmëri të caktuara.
- Personat të cilët e kanë fituar më vonë aftësinë e fituar për arsye që lidhen me humbjen ose dëmtimin e tyre, me vështirësitë e jetës me këtë aftësi të kufizuar, me qëndrimet shoqërore ndaj paaftësisë, etj., raportojnë prezencën e marrëdhënies së dëmtuar me veten, të gjendjeve emocionale depresive.
- Familjet e këtyre personave raportojnë vështirësi, në jetën e përditshme, probleme të natyrës sociale dhe ekonomike e deri çrregullime të humorit.
- Vështirësitë për të realizuar në kohë takime ndërinstucionale,
- Mendësitë skeptike rreth Parimeve të Rehabilitimit me Bazë Komunitare nga komuniteti.
- Pargjykimet rreth të pasurit të personave me nevoja të veçanta në një mjedis ku mungojnë mundësitë dhe pajisjet për t'i asistuar ata.

#### 4-Rekomandimet për të ardhmen

Eksperiencia botërore na ka treguar se implementimi i programeve me bazë komunitare duhet të na bëjnë shumë optimistë për realizimin e ndërhyrjeve të mëtejshme në kuadër të RBK.

Rekomandimet, duke ju referuar pikërisht kësaj eksperience do të ishin:

- Shtrirja e Rehabilitimit me Bazë Komunitare me të gjithë komponentët e vet duke e parë atë si një praktik të mirë riaftësimi për personat me probleme aftësi të kufizuar.
- Nxitja e promovimit të Edukimit me Bazë Komunitare për të kapur në kohë mundësinë për të ndërhyrë me RBK që në moshë më të hershme.
- Trajnimi dhe mbështetja e mësuesve me programet RBK, për të ndihmuar në realizimin e objektivave të arsimit gjithëpërfshirës.
- Vazhdimi i mbështetjes psikosociale të personave me aftësi të kufizuar për të ndihmuar në kapërcimin e problemeve emocionale.
- Mbështetje psikosociale e familjarëve të personave me aftësi të kufizuar për të lehtësuar problematikat me të cilat ata mund të hasen.
- Përmirësim i aksesit në informacion nëpërmjet pajisjeve të asistencës teknike.
- Informimi dhe trajnimi i personelit të institucioneve dhe organizmave në RBK.
- Të gjitha aktivitetet dhe ndërhyrjet e tjera të kihen parasysh të realizohen në komunitet, atje ku jetojnë personat me probleme shikimi dhe familjarët e tyre.
- Akses më të madh në shëndetësi, arsim, politik dhe sferën sociale.
- Vlerësim i vazhdueshëm i nevojave psiko-sociale të personave me aftësi të kufizuar për të ngritur politika të mira në nivel kombëtar dhe rajonal.

**Referencat:**

Evans, L. & Brewis, C. (2008). The efficacy of community-based rehabilitation programmes for adults with TBI. *International Journal of Therapy and Rehabilitation*, 446-458.

Convention on the Rights of Persons with Disabilities. (2006). New York, United Nations, 25-30.

Helander, E. (2001). *A Service Delivery System for Community-Based Rehabilitation. Guidelines for the design and training programs for the personnel.* UNDP.

Velema, J. P., Ebenso, B., Fuzikawa, P.L. (2008). Evidence for the effectiveness of rehabilitation-in-the-community programs. *Leprosy Review*, Boston, United Nations, 65-82.

World Health Organization. (1994-2004). *CBR: A strategy for rehabilitation, equalization of opportunities, poverty reduction and social inclusion of people with disabilities.* Geneva, Switzerland, 13-63.

World Health Organization. (2011). *International consultation to review community-based rehabilitation (CBR).* Geneva, Switzerland, 75-90.

World Health Organization. (2010). *Community Rehabilietation Base (CRB) Guidelines Introductory Booklet.* Geneva, Switzerland, 23-54.

World Health Organization. (2010). *Community Based Rehabilitation, Social Componet.* Geneva, Switzerland, 81.

**Arbjola HALIMI**  
Universiteti “Aleksandër Xhuvani”  
Elbasan/Shqipëri

## **Shërbimi Psikologjik në Shqipëri dhe Nevojat Psikologjike tek Shqiptarët Ndër Vite (pas vitit 1990)**

### **Abstrakt**

*Shqipëria si një nga vendet me tranzicion të zgjatur ka patur dhe zhvilluar problematikat e saj në planin psikologjik të cilat janë trajtuar specifikisht nga autorë të shumtë ndër vite. Artikulli në vijim bën përpjekje për ti paraqitur ato së bashku dhe në vijimësi për të ruajtur paksa një vështrim sistemik dhe tërësor mbi këtë, në ruajtje të perspektivës se problemet psikologjike nuk lindin në vakum por formësohen si pasojë e kushteve të tjera me natyrë sociale, ekonomike, familjare, etj. Ai është gjithashtu edhe një tentativë krahasuese me atë se çka mund të ketë qenë problematikë me karakter psikologjik para vitit 1990 si dhe një tentativë identifikuese e nevojave psikologjike tek shqipëtarët më të spikatura gjatë tranzicionit duke përshkruar paralelisht edhe natyrën dhe specifikat e shërbimit psikologjik në Shqipëri gjatë kësaj periudhe. Metodat e përdorura në paraqitjen e të dhënave janë disa dhe artikulli përshkruan vetëm një pjesë të këtyre të dhënave pjesë e një studimi më të gjerë Ndër këto metoda janë pyetësorë dhe intervista të hapura me subjekte mbi 45 vjeç, intervista me profesionistë të fushës si dhe vëzhgime dhe statistika të kushteve social ekonomike në Shqipëri në këto vite. Është arritur të ndërtohet një piramidë e nevojave më të spikatura psikologjike të identifikuara më shumë tek shqiptarët në këto vite.*

**Fjale Kyc:** *Sherbim Psikologjik; Nevoja Psikologjike; Shoqeria Shqiptare*

### 1-Hyrje: Vështrim teorik

Sindroma post komuniste (Martina Klicperova-Baker 1999 : 9) e cila përcaktohet si një veçori simptomash individuale në lidhje me konjcionet, qëndrimet dhe sjelljen të zhvilluara gjatë sistemit komunist të cilat zgjasin gjatë periudhës së kalimit nga tranzicioni në demokraci, përfshin funksione të shumëfishta psikologjike. Këto simptoma mund të jenë të tilla si defektet konjitive, afektivitet dhe emocione negative, pasivitet ose kërkim intensiv të vetpërbushjes deri në qëndrime amorale, handikape marrëdhënore, etj. Ato mund të shfaqen në nivelin individual, ndërpersonal, komunitar, institucional, shtresë sociale, në nivelin politik e shtetëror, nivelin ndërkombëtar të politikës dhe në nivelin e këndvështrimit botëror. Emocionet në nivelin personal mund të përfshijnë frikën, pasigurinë, nostalgjinë, ankthin, në nivelin familjar mosbesimin jashtë familjes apo zili si pasojë e barazisë vulgare, në nivelin komunitar mosinterisim dhe apati, atë institucional mosbesim dhe kënaqësi në mosbazitimin e rregullave të institucionit apo mashtrimeve ndaj tij, në nivelin politik dhe shtetëror frustacion, pasiguri, urrejtje, zemërim, ndërsa në nivelin e vështrimit botëror boshllëk pas humbjes së autoritetit, vetmi dhe pashpresshmëri.

E kaluara jonë postkomuniste duket se identifikon disa veçori pikërisht të kësaj sindrome e cila njëherazi zhvillon problematika të reja dhe nevoja të reja ngandonjëherë urgjente dhe specifike me karakter psikologjik. Ashtu sikurse thekson në librin e tij Prof. Dr. Hamit Beqja (Hamit Beqja, 2000 : 5-144) "Tranzicioni Demokratik dhe Psikologjia e Shqiptarve të sotëm" disa prej këtyre dukurive duket se ndodhën edhe në Shqipëri pas vitit 1990 si një vend postkomunist. Ai thekson në veprën e tij se ndryshime ndodhën si në nivelin personal, familjar, social ashtu edhe atë institucional e shtetëror.

Hyrja e vendit në një tranzicion të gjithanshëm demokratik thotë ai që nënkupton kalimin nga një sistem teorikisht i bazuar në një monizëm të gjithanshëm, një partiak, i vetquajtur komunist, ekonomikisht i centralizuar në një sistem të ri demokratik me natyrë pluraliste solli zhvillime të reja dhe të vrullshme të gjithanshme në të gjitha sferat e jetës, përfshirë edhe atë psikologjike edhe pse, sikurse thekson ai, këto ndryshime kanë karakter më të ngadaltë në përgjithësi në raport me sferat e tjera të jetës. Mendësitë e njerëzve, ndjesitë e gjëndjet e tyre emocionale, traditat zakonore, shijet e tyre, etj ndryshojnë më ngadalë, thotë ai, dhe pasqyrohen në mënyrat e të menduarit, jetesës, mendësitë dhe praktikat jetësore të njerëzve. Kultivimi i një mendësie demokratike, rrënjosja e një mentaliteti të tillë në vetëdijen e njerëzve lidhet pikërisht me psikologjinë e njerëzve, në një fushë ku zhvillimet janë të ndërlikuara dhe të ngadalta.

Kalimi nga regjimi monist totalitar në një regjim që synon të bëhet demokratik dhe pluralist përbën një premisë të fuqishme për zhvillime dhe shndërrime të vrullshme në psikikën njerëzore, çlirim nga çensura, të njderit mendërisht i lirë, afirmimi në vetvete i lirisë së mendimit dhe fjalës, çlirimi nga indoktrinimi i njëanshëm monist, afirmimi i personalitetit vetjak njerëzor, identiteti i tij, mundësia për shpërthimin e iniciativës së lirë apo asaj që ai e quan çalltisje, jeta shoqërore, marrëdhëniet midis së vjetrës dhe të resës, etj. Në këtë periudhë spikasin, thekson ai, prirje e përpjekje për afirmimin e personalitetit njerëzor pasi shtypja dhe shfrytëzimi i njeriut e çon atë



drejt depersonalizimit, tjetërsimit, por ende dhe sot, thekson ai, hasen vështirësi dhe pengesa të shumta objektive dhe subjektive. Afirmimi i personalitetit njerëzor është një çështje e të drejtave themelore të njeriut, lirisë së personit dhe si e tillë (si një çështje e lirisë së personit në kuptimin më të gjërë) ajo nuk mund të realizohet pa emancipimin shpirtëror, çlirimin nga çdo shtypje shoqërore, nga çdo prirje e psikologjisë shkatërruese.

Gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri thekson Prof. Dr. Hamit Beqja u zhvilluan ato që ai i quan çoroditje, intelektuale, emocionale e tërë personalitetit: shfrime psikologjike intelektuale e emocionale, abuzime e spekulime të medias duke përdorur slogane si “pavarësi gjykimi”, “frymë debate”. Gjatë 10 vjeçarit të parë të periudhës postkomuniste duket se mbizotërojnë ende në Shqipëri gjurmë të indoktrinimit monist çka pengon kultivimin e një mendësie demokratike. Edhe gjatë këtij 10 vjeçari sugjeron ai janë shfaqur elementë të çensurës e cila ndikon në psikologjinë e njeriut me një tërësi shformimesh. Së pari mbjell, ngjall dhe ushqen frikën, frikën nga mendimi i lirë vetjak, frikën nga mendimi i lirë i të tjerëve, frikën për ti komunikuar të tjerëve mendimet që njeriu ka, ku shforimi më i rëndë i saj është dukuria në të cilën njeriu fillon të ruhet nga vetvetja. Mungea e karakteristik kritik tek individë të caktuar bën që të kalohet nga tendenca për afirmimin e personalitetit, vetjakësisë së tij drejt kokëfortësisë, kryeneçësisë, sigurisë së tepruar, mungesë të modestisë, të dëgjuarit me durim, etj.

Momentet e hutimit si pasojë e burimit të madh të informacionit bëjnë pjesë gjithashtu në këtë proces çka çon drejt çorientimit. Koha ka stimuluar mjaft edhe të stërditurit dhe stërkompententët, shpirti i kundërshtimit, mungesa e kualifikimit përkatës, shpirti i kundërshtimit, llafazanëria, mendjemadhësia, etj (Hamit Beqja, 2000 : 5-144).

## **2-Të dhënat e përfuara nga studimi**

### **2.1-Pjesëmarrësit, Metodat**

Gjithsej në këtë studim u përfshin 120 subjekte me moshë mbi 45 vjeç. Ata u pyetën rreth nevojave psikologjike që kanë hasur ndër këto vite më shumë (përcaktimi emëror i nevojave u bë nga studiuesi) duke i kërkuar për ti vendosur ato në një shkallë renditëse hierarkike. Pyetjet në vazhdim të pyetësorëve dhe intervistës ishin krejtësisht të hapura të tilla që synonin të zbulonin kontekstin emocional dhe konjitiv që lidhej me nevojën dhe periudhat kohore përkatëse. Në studim janë përfshirë edhe informacione të marra nga specialistë të fushës.


### **2.2-Rezultatet**

Disa nga këto nevoja të identifikuar në Shqipëri gjatë periudhës postkomuniste apo sikurse jemi mësuar ta quajmë tranzicion kanë rezultuar të jenë:

Plotësimi i nevojave bazë , orientimi profesional dhe personal, mbrojtja dhe siguria, afrimiteti dhe ngrohtësia familjare, ngarkesa dhe përgjegjësitë, kujdesi ndaj vetes, cilësia e raporteve sociale dhe nevoja për miq, nevoja për dashuri, vlerësim dhe respekt, nevoja për qetësi, nevoja për komunikim dhe qartësim

(marrje informacioni), nevoja për lidhje, nevoja për shprehje dhe mendim, nevoja për kreativitet, rritje dhe realizim të vetes, nevoja për dëgjim dhe kuptim, nevoja për arsimim dhe formim, nevoja për përmbushje personale rritje, vlerësim+vetvlerësim, pranim dhe aprovim, mosrefuzim, integrim, orientim, nevoja për arritje (të qëllimeve, objektivave,etj), moskërcënim, mungesë të streseve jetësore (situatë të vështira për tu përballuar,) nevoja për përkujdesje, intimitet, nevoja për liri, nevoja për eksplorim dhe kuriozitet (zbulim, njohje), mosabuzim.

Në një shkallë hiarkike këto nevoja renditen si më poshtë:



Më pas vijojnë: 1. Nevoja për vlerësim, 2. Nevoja për kujdes ndaj vetes, 3. Nevoja për më pak strese jetësore dhe mbingarkesa, 4. Nevoja për pranim dhe aprovim, 5. Nevoja për dëgjim dhe kuptim, 6. Përmbushje e nevojave bazë, 7. Nevoja për stabilitet dhe qëndrueshmëri, 8. Nevoja për integrim dhe morefuzim, 9. Nevoja për stabilitet emocional, jetësor e shëndetësor

Duhet theksuar se pavarësisht këtij rezultati të përgjithshëm ka diferenca esenciale në predominimin e këtyre nevojave nëse i referohemi periudhave të caktuara brenda këtyre 23 viteve si dhe shtresave të caktuara sociale. Diferenca gjinore dhe moshore vërehen gjithashtu. Në periudhën e pas ndryshimeve dhe ngjarjeve të vitit 1990 predominon nevoja për liri, shprehje dhe mendim, nevoja për arritje dhe përmbushje personale. Vlen për tu theksuar se nevoja për arritje dhe përmbushje personale pavarësisht disa përjashtimeve mbetet nevoja më e paplotësuar përgjatë gjithë viteve ashtu sikurse dhe para ndryshimeve të vitit 1990. Kjo karakteristikë duket se lidhet më paqëndrueshmëritë e zgjatura në planin e punës, ekonomisë, orientimit profesional, problemeve në familje dhe ato në lidhje me emigrimin, kushtet e punës, shëndetit, etj. Problemet me punësimin gjatë vitit 1993(shkurtime në kohë) si dhe konfuzioni institucional i kohës sollën problematika në lidhje me nevojën për vlerësim, afirmim dhe stabilitet në plotësimin e nevojave bazë. Mungesat

e gjata familjare gjatë kësaj periudhe e në vazhdim 1996, 2000, etj, nxjerrin në pah nevojën për lidhje dhe afrimetet familjar gjatë pothuajse gjithë dhjetëvjeçarit të parë. Stabiliteti dhe siguria mund të verifikohet në çdo periudhë apo vit por dukshëm kjo nevojë është kërcënuar në vitin 1997( nis në fundvitin e 1996), 1999, 2001, 2002, 2003 dhe 2013, 2014. Ngjarjet me peshë të rëndë në kontekstin familjar e social (aksidente, vrasje, vdekje, sëmundje aksidentale dhe sëmundje të tjera, divorcet jo të qeta dhe më pasoja, problemet me drejtësinë, problemet me drogën tek të rinjtë, shtimi i dhunës te gratë dhe korrupsioni i madh në vend) ( Drejtoria e përgjithshme e policise, Ministria e shëndetësisë, Instat, censusi i popullsisë dhe i banesave 2001) kanë kërcënuar në çdo kohë stabilitetin emocional të të gjitha grupmohave. Nevoja për dëgjim dhe kuptim kryeson tek të rinjtë, të moshuarit dhe gratë. Nevoja për orientim dhe informacion është e pranishme në çdo periudhë.

Në lidhje më shërbimin psikologjik në këto vite mund të thuhet se numri i të diplomuarve në psikologji ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit pas vitit 1996 (hapja përherë të parë e degës psikologji në UT e cila u shtri më pas edhe në UE dhe USH, viti 2005) (MASH, statistika). Pavarësisht daljes vit më vit të specialistëve në degën e psikologjisë ata nuk u asimiluan mirë në tregun e punës për shkak kryesisht të politikave jo të mira shtetërore (vetëm në 2005 kemi projektin e parë pilot për implementimin e psikologut në shkollë) dhe aplikim jo efikas të tyre (shumicën e vendeve të punës në pozicionin e psikologut e zunë individë fare të pakualifikuar në fushë duke sjellë pasoja të rënda në perceptimin publik të funksionit dhe dobishmërisë së psikologut dhe shërbimit psikologjik në tërësi. Ende dhe sot në Shqipëri profesioni i psikologut nuk ka një status ligjor çka lejon hapësira për abuzime dhe lëndime të vazhdueshme tek njerëzit. Pengesat në shërbimin psikologjik në Shqipëri lidhen ngushtësisht edhe me mentalitetin e ngurtë në lidhje me problemet emocionale tek njerëzit dhe atë që në praktikë vërehet si “turpi ndaj terapisë” si dhe mos institucionalizimi i plotë i tij. Punën më të çmuar në këtë drejtim e kanë bërë organizatat jofitimprurëse të cilat sollën përvojën e vendeve të tjera në këtë shërbim edhe pse mentaliteti vazhdon të jetë tejet i ngurtë dhe i padepërtueshëm edhe sot.

### 3-Konkluzione

Nevojat psikologjike në Shqipëri janë kërcënuar si para ashtu edhe pas vitit 1990 e në vazhdim. Mosplotësimi i këtyre nevojave duket se lidhet me vështirësitë për ndryshim dhe mosstabilitetin e vazhdueshëm social, politik, shoqëror, ekonomik, etj, të Shqipërisë ndër vite. Këto nevoja përfaqësojnë mungesa të rëndësishme në jetën e shqipëtarëve pasi ato sikurse citohet nga disa autorë (Piramida e Maslow ) përbëjnë, renditen ndër nevoja esenciale të jetës dhe funksionimit të plotë të njeriut në planin emocional, konjitiv e më gjërë. Brishtësia e shërbimeve me natyrë psikosociale në Shqipëri përgjatë viteve e ndërthurur me këtë mosstabilitet dhe pak njohuri e kanë bërë problemin të mbetet present sot e ne vazhdim.

**Referenca:**

Beqja, Hamit Tranzicioni Demokratik dhe Psikologjia e Shqiptarve të sotëm”, fq 5-144, mësonjëtorja e pare, Tiranë 2000.

Drejtoria e përgjithshme e policisë, statistika për kriminalitetin në vitet 1991-2012

Klicperova-Baker Martina “ Post-communist Syndrome” , fq 9, Open Society Institute, Budapest, Hungary 1999.

Instat, “Kushtet e jetës dhe pabarazia në Shqipëri”, fq 3-47, Tiranë 2004

MASH, statistika

Ministria e shëndetësisë, statistika

**Nuredin ÇEÇI**  
 Universiteti "Aleksandër Xhuvani"  
 Elbasan/Shqipëri

## **Studimet Sociologjike Duhet të Jenë sa më Pranë Qytetarëve dhe në Shërbim të Çështjeve Publike**

### **Abstrakt**

*Në këndvështrimin e sociologut, në këtë artikull synoj të argumentoj se cili është roli i sociologëve të vërtetë në zhvillimin e një shoqërie, sidomos të një shoqërie si kjo e jona, në të cilën kurimi i "sëmundjeve" të shumta, është një nevojë urgjente. Për rrjedhojë nevoja për një analizë sociale bëhet edhe më e domosdoshme. Për ta njerrë më mirë në dukje rolin e sociologëve në funksionimin dhe zhvillimin e një shoqërie sa më të harmonishme e demokratike është e nevojshme të kujtojmë se çfarë studion sociologjia? Me pak fjalë, sociologjia është studimi shkencor i shoqërisë njerëzore, i grupeve të ndryshme sociale. Duke qenë se sociologjia si objekt kryesor të saj ka studimin e shoqërisë njerëzore dhe gjendjen e saj, atehere shoqëria shqiptare ka nevojë për sociologë, për një analizë të thellë të problemeve sociale. Situatat nëpër të cilat po kalon vendi ynë tregojnë qartazi se, krijimi i një "diagnoze" për kurimin e shoqërisë sonë, kthimi i saj në një gjendje të shëndetshme është imediate. Këtë më mirë se sociologët e sociologjia nuk mund ta bëjë asnjë shkencë tjetër.*

*Kjo, pasi objekti kryesor që sociologjia studion, është vetë shoqëria njerëzore dhe gjendja e saj. Zhvillimet dramatike ekonomike dhe reformat e thella sociale që janë ndërmarrë në vend gjatë tranzicionit kanë hapur shumë plagë sociale, e kanë bërë të pashmangshme nevojën e kurimit të tyre. Në këtë kontekst social përzgjedhja midis një disipline që formon kurues dhe një disipline që formon projektues e parandalues sociale, duhet të anojë nga e dyta. Në këto rrethana sociologjia dhe sociologët duhet të jenë më fatlumë. Për këtë nevojitet një perceptim më i drejtë i politikave sociale. Shërbimet riintegruese duhet të mbizotërojnë në raport me shërbimet rehabilituese. Mendimi ekonomik, perceptimi i politikave sociale duhet të mbështeten edhe në mendimin shoqëror, studimet sociologjike, mendimin e sociologut. Vetëm kështu mund të hartohen politika të qarta për zhvillimin social të vendit, të projektohet një Shqipëri humane e sociale. Kërkesa shoqërore për mendimin sociologjik duhet të jetë përtej të sotmes, sepse vetëm kështu mund të inkurajohet oferta sociologjike në Shqipëri. Prestigji akademik dhe shoqëror i sociologjisë si disiplinë shkencore në vendin tonë duhet të jetë po aq i respektuar sa në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera perëndimore. Jo vetëm kaq, por edhe statusi profesional i*

sociologut dhe nevojat për ekspertizën e tij duhet të kuptohen dhe vlerësohen edhe më mirë në një shoqëri si kjo e jona, e cila edhe sociologjikisht ka pësuar e po pëson një transformim të jashtëzakonshëm. Shoqëria shqiptare, ashtu si shoqëria amerikane dhe çdo shoqëri moderne, duhet ta ndjejë nevojën e sociologut, të dijës dhe të shërbimeve të vyera që mund të ofrojë ai. Përpunimi i ideve që lidhen me ripozicionimin e sociologut në tregun e punës, si dhe me rikonceptimin e studimeve sociologjike për të qenë ato sa më pranë qytetarëve dhe sa më shumë në shërbim të çështjeve publike, përbën sot një prioritet për studiuesit e shoqërisë shqiptare. Sot, pas gati 23 vitesh aktivitete degët e reja, të hapura rishtazi (ku bën pjesë dhe sociologjia), jo vetëm do duhej të njiheshin mirë, por duhej të jepnin edhe kontribut për zhvillimet e vendit, duke iu dhënë tashmë statusin e profesioneve të afirmuara.

**Fjalë kyçe:** Shoqëri Njerëzore; Mendim Sociologjik; Zhvillim Social; Plagë Sociale; Disiplinë Kuruese dhe Parandaluese; Status Profesional; Shërbime.

## 1-Hyrje:Pse sociologët dhe sociologjia?

Përvoja jetësore e deritanishme ka provuar në mënyrë të pakundërshtueshme idenë se në periudha tronditjesh e kapërcimesh të mëdha, historia e një shoqërie përsëritet në mënyrë të përsheptuar e të përqendruar nëpër etapat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Kjo provohet më së miri nga tabloja shqiptare e tranzicionit e cila ka ofruar dukuri që bota e zhvilluar perëndimore i ka kapërcyer dhe zgjidhur në kohë. Një fakt i tillë pohohet edhe nga sociologu Zyhdi Dervishi, i cili thekson: “Shoqëria shqiptare në tranzicion përballet me vështirësi e sfida të shumëllojshme” (Dervishi;2003). Gjithsesi e rëndësishme është të theksohet se tranzicioni shqiptar po e ndan të kaluarën nga e tashmja shqiptare dhe po e inkuadron të tashmen tonë në atë botërore. Por e tashmja jonë tregon se nuk jemi bashkëkohorë me Perëndimin, megjithëse jetojmë të njëjtën periudhë kohore kalendarike. Megjithëse jemi në Evropë dhe evropianë, prapë kemi mbetur jashtë Evropës. Por tranzicioni, si rruga për tek shoqëria demokratike, apo për tek e tashmja e përparuar perëndimore, ofron njëherazi edhe dukuritë e reja që po përjeton bota sot.

Tranzicioni shoqëror në vendin tonë karakterizohet nga ndryshime të thella dhe intensive shoqërore të cilat kanë depërtuar në të gjitha sferat e jetës njerëzore, duke marrë parasysh këtu edhe sistemin e vlerave. Në shoqërinë tonë në tranzicion po bëhet përherë më e dukshme shpërfillja e normave dhe e vlerave të kulturës sunduese. Kalimi nga një sistem në një tjetër, zëvendësimi i sistemit monist me atë pluralist bëri të mundur që njerëzit, e veçanërisht të rinjtë, të kërkojnë një pavarësi më të madhe, duke rendur pas një identiteti tjetër krejt të ndryshëm nga ai në sistemin e kaluar. Këto ndryshime globale që ndodhën në shoqërinë paskomuniste shqiptare diktuan nevojën e një riorganizimi të sistemit ploitik, juridik dhe ekonomik. Krahas hapjes së shoqërisë sonë drejt botës perëndimore u ndeshën dhe shumë pasoja negative, si për shembull, privatizimi i ekonomisë, diferencimi shoqëror i popullsisë. Tashmë në vendin tonë paraqiten dy shtresa shoqërore dominuese: shtresa shumë e pasur dhe ajo shumë e varfër. Një tablo e tillë është rezultat i grabitjes së kapitalit shoqëror dhe e thellimit të papunësisë.

Një nga analistët më të kualifikuar dhe më objektivë të problematikës komplekse të tranzicionit paskomunist në Shqipëri, studiuesi gjerman Mihael Schmid-Neke, ndër të tjera, ka shkruar: “Transformimi i ekonomisë u zhvillua edhe më kaotik se ai i sistemit politik...” (Neke, 1999). Ndryshime të tilla mundësuan dobësimin e sigurisë së njerëzve në sferën shoqërore, shëndetsore, arsimore etj. Duke përdorur gjuhën e sociologut të shquar francez Emil Dyrkheimi, shoqëria shqiptare sot paraqet një gjendje anomike, ku më tepër sundon joligjshmëria, mosrespektimi dhe dhunimi masiv i normave kulturore e juridike. Kjo lloj anomie deri diku ndikon në krijimin e një situatë të favorshme për sjellje deviate e kriminale. Më tepër se kudo kjo situatë reflektohet tek të rinjtë të cilët në mënyrë më intensive se të tjerët merren me veprimtari deviate si narkomania, alkoolizmi, vjedhja, vrasjet e ndryshme, prostitucioni etj.

Ndryshimet e thella që solli tranzicioni politik, hapja e vendit drejt globalizimit, kontakti me kulturat e tjera, janë shoqëruar me ndryshime të rëndësishme sociale. Shoqëria

shqiptare ka problem të mëdha kulturore, ekonomike e politike. Ajo nuk gjendet vetëm në udhëkryq, por më keq, ndodhet në një situatë kaotike, të pashpresë. Si pasojë janë shtuar krimet e dhunshme, krimet kundër personit, abuzimet e të gjitha llojeve, vetëvrasjet etj. Statistikat që informojnë për numrin e vrasjeve janë të larta. Dashuria dhe krimi nuk kanë atdhe, si kudo. Por prapë, dashurohen ose jo, vriten ose jo, dhunohen ose jo, njerëzit në Shqipëri janë të ashpër njëllor, pavarësisht ku jetojnë. Ndryshimet që janë bërë në vendin tonë, duket se nuk kanë ndikuar aspak në sjelljen civile të njerëzve, dhe në kulturën e tyre.

Që ne jemi një popull i ashpër, kjo nuk do shumë vëmendje për t'u kuptuar. Nëse me ashpërsi quajmë një raport barbar të njeriut me veten, raport që nxjerr në pah vlerën e mohuar të jetës, privimin primitiv nga gjërat dhe ngjarjet e bukura, epiteti i përdorur qëndron. Kur je i ashpër je dhe i fortë, je një krijesë që ka energjinë e mjaftueshme për të shpërfillur normalitetin, ligjet e jetës. I ashpri sfidon, shkatërron, vret e mohon. Këto janë veprime dhe vendime gjallesash, të cilat kanë zhvendosur normalitetin për të krijuar një normalitet të ri ku sundon paradoksi dhe mosarsyeja. Ne përfaqësohemi prej tyre, vetëbombardohemi me lajme të zeza të një realiteti mizor të cilin vetë ne e krijojmë. Kronika të kobshme dominojnë lajmet e ditës në vend. Burri vret gruan në sytë e fëmijve, për xhelozsi ose edhe për para. Jo rrallë vëllai vret vëllain për një pëllëmbë tokë ose për hiçmosgjë. I ati vret të birin, vëllai motrën, të gjitha krime brenda familjes. Është humbja e arsytimit dhe vetëgjykimi që bëjnë njerëzit për shkak të mosfunksionimit të shtetit ligjor që i çon drejt vrasjes së vëllait apo fqinjit për një copë, apo për një fjalë fyese nga një mik në gjendje të dehur.

Në Shqipëri, këto janë aq të shpeshta dhe aq të zakonata, sa mungesa e normalitetit përfaqëson në tërësi realitetin tonë. Dhe kur ndodh rëndom brenda familjes, krimi i zakonshëm në rrugë kthehet në një rutinë. Për sharje e fyerje, për vështime të shtrembëra, për kërsillëqe në rrugë, për parakalime makinash, të rinjtë me pistoletë në brez vrasin njëri-tjetrin. Rrugëve ndesh cuba të armatosur që me pak vëmendje i dallon kur të duash, sepse ato fryjnë gjoksin dhe të shohin vengër. Të frymëzuar nga filmat, por edhe nga realiteti shqiptar, që jo rrallë konkurren Hollivudin për nga fantazia e krimit, këta janë si çarqe të ngrehur, gati për sherr, gati për luftë. Çdo natë në qendër e në periferitë e qyteteve shqiptare, në rrugë, në lokale, në salla bilardosh, grinden, shahen, rrihen, madje edhe vriten, me një shkujdesje të frikshme. Madje kjo ndodh edhe në shkolla. Ende vazhdon drithërima kombëtare për vrasjen e një të riu, brenda një shkolle publike në Durrës. Iu referova në radhë të parë vrasjeve, pasi ata marrin jetë njerëzish dhe për ne sociologët ajo është gjëja më e rëndësishme dhe parësore.

Një tjetër plagë e shoqërisë shqiptare, e cila ushqehet po me jetë njerëzish dhe sa vjen e rritet, është ajo e vetëvrasjeve, ku njerëz të dëshpëruar, të cilët gjenden të braktisur nga strukturat sociale dhe ato shtetërore e inegzistenca e tyre, vetëfljohen. Vështirësitë ekonomike, papunësia, dhuna në familje, diversiteti i mentalitetit shqiptar në të gjitha shtresat e shoqërisë janë problematika që shqetësojnë gati të gjitha familjet shqiptare. Baret dhe lojrat e fatit janë të mbushura plot nga meshkuj alkoolistë dhe të papunë, të detyruar nga kushte ekonomike dhe mospërballimi



i këtyre ndryshimeve sociale-kulturore, nisin të transformohen në monstra për familjet e tyre, në dhunuesit e bashkëshortes, të fëmijës e të prindërve.

Ndërkohë gruaja shqiptare e braktisur dhe e përbuzur, tenton të çojë përpara familjen në këtë shoqëri pa formë e pa rregulla loje, ku ligjin e bën “i forti” apo drejtuesit politikë, kurse të tjerët janë kthyer në “skllevër modern”. Në shoqërinë e sotme shqiptare më shumë se gjysma e nxënësve janë analfabetë funksionalë dhe nuk duhet të harrojmë se janë ata që do të ndërtojnë të ardhmen. Praktika botërore ka treguar se padituria të çon drejt errësirës dhe prapambetjes. Gjatë këtyre 23 viteve të tranzicionit paskomunist janë prodhuar mediokër të cilëve u është dhënë “shansi” të jenë drejtues apo politikanë “kukulla” në shërbim të një grupi të caktuar social, që me anë të këtyre “instrumentave” shfrytëzon pjesën tjetër të shoqërisë. Në të gjitha shoqëritë demokratike e civile shoqatat e sindikatat e ndryshme janë funksionale, kurse në shoqërinë tonë ato kanë ngelur informale.

Fenomen tjetër i ri i tranzicionit është edhe krijimi i të ashtuquajturave “zona të ndaluara” ku rendi dhe ligji nuk veprojnë. Zonat ku vepron ligji i gjakmarrjes e ku dhjetra njerëz janë të detyruar të ngujohen, larjet e hesapeve mes bandave rivale, zonat e trafikimit të drogës mes të rinjve, kalimet e lëndëve narkotike dhe mallrat kontrabandë në dogana e provojnë më së miri një situatë të tillë. Si shkak i vorbullës që ka sjellë tranzicioni vërehet një fakt i hidhur, ai i tërheqjes nga jeta, që vihet re jo vetëm tek të droguarit por edhe më gjerë. Ai shprehet si një armiqësi e theksuar ndaj realitetit mediokër, banal, të palëvizshëm, të përditshëm.

Ky skicim i shkurtër i gjendjes në të cilën ndodhet vendi ynë tregon qartazi se, krijimi i një “diagnoze” për kurimin e shoqërisë sonë, kthimi i saj në një gjendje të shëndetshme është imediate. Këtë më mirë se sociologët e sociologjia nuk mund të bëjnë asnjë shkencë tjetër. Kjo, pasi objekti kryesor që sociologjia studion, është vetë shoqëria njerëzore dhe gjendja e saj. Gjithashtu duhet ekspertiza e sociologëve që të dalin në pah plagët e shoqërisë sonë dhe të gjenden kurat e shërimit të tyre. Janë sociologët ata të cilët evidentojnë se ku ka më shumë nevojë për ndërhyrje dhe ndihmë në trupin e shoqërisë sonë, ku gati çdo qelizë e saj nuk është e shëndetshme. Kjo, pasi gati të gjithë shqiptarët sot nuk janë të kënaqur me jetën që bëjnë dhe pjesa më e madhe e tyre duan të largohen nga Shqipëria. Më mirë se kushdo tjetër, më mirë se një qytetarë i zakonshëm, këto fakte mund t’i perceptojë vetëm një sociolog. Janë pikërisht sociologët që pasi e studiojnë shoqërinë në tërësi, sjelljet e grupeve të veçanta nga të cilat përbëhet ajo e deri tek individi, të cilët mund të analizojnë e të bëjnë ekspertizën e faktorëve që kanë ndikuar në përqasjen e kësaj forme, në këtë rast të shoqërisë shqiptare, që ngjason me një organizëm të sëmurë në çdo ind të tij. Janë sociologët që pasi bëjnë analiza të thella shkencore, sugjerojnë se cilat mund të jenë zgjidhjet për shërimin e këtyre plagëve, duke marrë parasysh dhe precedentë të tjerë të ngjashëm dhe studime të bëra nga shoqëritë me demokraci të zhvilluar. Janë sociologët ata të cilët mund dhe duhet të bëjnë rolin e mjekut-ligjor të shoqërisë shqiptare.

## 2-Sociologjia Është një Dije që i Nevojitet Kujdo

Pavarësisht nga natyra e një shkence, objekti i saj i studimit, ajo nuk mund të anashkalojë dot rëndësinë e njohjes së dimensionit social. Ky është një fakt i njohur nga të gjithë. Megjithëse jeta sociale është e gjerë e mjaft e ndërlikuar, shkencë e sociologjisë nuk lë jashtë mureve të përfshirjes së saj asgjë që lidhet me shoqërinë njerëzore, duke e bërë të ligjshëm dhe të argumentueshëm pretendimin e sociologëve se ajo është mëma e të gjitha shkencave. Në fokusin e saj sociologjia ka kuptimin e veprimit social, dhe si e tillë ajo shihet si një dije universale, që u shërben çdo anëtarit të shoqërisë në formimin jo vetëm akademik, por edhe në kuptimin e strukturave, funksioneve dhe ndërveprimit shoqëror. Ndaj sociologjinë e hasim kudo, në formimin fillor si edukim shoqëror, në atë nëntëvjeçar e të mesëm, por edhe në arsimin e lartë, jo vetëm në kurrikulat e disiplinave që lidhen me shkencat sociale dhe humane, por edhe më gjerë. Sepse sociologjia është nga ajo dije që i nevojitet kujtdo, kontributi i saj në dijet e tjera është i ndjeshëm dhe mjaft i rëndësishëm.

Si disiplinë akademike dhe si shkencë e aplikuar, sociologjia studiohet pothuajse në çdo formim akademik, në çdo degë, pasi ndihmon në thellimin mbi njohjen njerëzore, transferimin e kësaj njohje në veprimtari praktike shoqërore si dhe mënyrat e ndikimit mbi rezultatet e saj duke i parashikuar ato. Njohja e kësaj discipline mundëson zgjerimin e aftësive të studentit për të reflektuar mbi shumë veprime, dukuri dhe ngjarje të jetës së përditshme, të cilat në tërësinë e tyre përbëjnë atë univers shoqëror, pjesë e të cilit janë jeta, angazhimet, veprimet dhe krijimtaria e çdo njeri prej nesh.

Kjo shkencë u shërben edhe atyre që nuk kanë në plan të bëjnë karrierë sociologjike. Krahasuar me çdo disiplinë tjetër shoqërore sociologjia ka potencialisht një avantazh më të madh, për të ndihmuar në njohjen e rrënjëve të problemeve sociale. Kjo sepse është një shkencë që studion në makronivel kushtet e jetës së shoqërisë, strukturën e institucionet e saj dhe në mikronivel marrëdhëniet midis individëve dhe grupeve shoqërore. Studentët e disiplinave të tjera sociologjia i ndihmon të kuptojnë jo pse “gjërat” nuk shkojnë mirë nga pikëpamja e autoriteteve zyrtare të shoqërisë dhe menaxhimit të shkencës sociale, por në radhë të parë të kuptojnë funksionimin e sistemit social si një organizëm i tërë. Me anë të sociologjisë studentët arrijnë të kuptojnë jo thjesht përmasat e pasojës, por shkaqet e saj. Më konkretisht, fillojnë të kuptojnë se problemi sociologjik themelor është jo krimi por ligji, jo divorci por martesë, jo diskriminimi racia por shtresëzimi racia i shoqërisë, jo revolucioni, por qeveria etj (Berger;1963). Pa njohjen e kontekstit social, nuk garantohej suksesi i instrumentit ndërhyrës. Pikërisht në këtë aspekt kontribuon sociologjia, sepse është një instrument i rëndësishëm që ofron rrugëzgjdhje shoqërore më racionale dhe më praktike, më vizionare dhe më të qëndrueshme për të gjitha problemet e sfidat, me të cilat përballet dhe do të përballet shoqëria shqiptare aktualisht dhe në të ardhmen.

Çdo teori sociologjike synon, në instancë të fundit të identifikojë shkaqet e ngjarjeve, të dukurive dhe të problemeve shoqërore, çka në vetvete ka një rëndësi praktike

shumë të madhe nëse si shoqëri jemi të interesuar të krijojmë, të stimulojmë - apo, në të kundërt, të reduktojmë apo të eliminojmë - një situatë objektive në jetën e shoqërisë, apo një problem të caktuar shoqëror. Të marrim, për shembull, dukuri dhe probleme të tillë shoqërore si varfëria, rritja e kriminalitetit në radhët e moshave të reja, cilësia e ulët e shkollimit në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, shkalla e lartë e korrupsionit në sistemin e administratës publike, shpopullimi i fshatit dhe i qyteteve të vegjël në vendin tonë, apo dukuri të tjera sociale.

Nëse duam që, si shoqëri, të bëjmë diçka për të përmirësuar kushtet objektive dhe ata faktorë subjektivë që mundësojnë ekzistencën e dukurive dhe të problemeve të tillë sociale është e rëndësishme, në radhë të parë, që të kuptojmë shkaqet e tyre. Për rrjedhojë studiuesi e sociologu Fatos Tarifa thekson: "Për të ndryshuar një rrethanë shoqërore, apo një marrëdhënie të caktuar në jetën e shoqërisë, është e domosdoshme, pra, që më parë të identifikohen shkaqet e tyre dhe jo thjesht të merremi me format në të cilat manifestohen këto dukuri dhe pasojat e tyre" (Tarifa 2008).

Ashtu si disa lëndë bazike, sociologjia studiohet edhe në ciklin fillor, 9-vjeçar e të mesëm, duke i pajisur të rinjtë me dije të karakterit specifik. Në këto cikle shkollore sociologjia i ndihmon nxënësit të zgjerojnë aftësitë e vlerësimit për dimensionin social të individit dhe të grupit, si dhe i sensibilizon ata me funksionet që luajnë një sërë institucionesh sociale si: familja, shkolla, media etj., në drejtim të edukimit të tyre.

Në shkollat shqiptare sociologjia nuk përdoret sa dhe si duhet për t'i pajisur studentët me ato dije të tërthorta që do i shërbejnë në profesionet e së ardhmes. Nga ana tjetër nuk është fare e arsyeshme ta mohojmë faktin që niveli i përgatitjes teorike dhe vlerësimit të rolit të sociologëve si profesionistë të shoqërisë nuk është në stadin që kërkon shoqëria jonë në këtë fazë intensive të modernitetit të saj. Tradita e cunuar e studimeve sociologjike, niveli i përciptë i pedagogëve si dhe marrëdhëniet e kufizuara me komunitetin e gjerë ndërkombëtar të studiuesve të shkencave sociale kufizon ndjeshëm cilësinë e transmetimit të njohurive dhe të përfitimit të këtyre njohurive nga ana e studentëve në këtë disiplinë. Nuk është e qartë deri në fund se cila është arsyeja e këtij nënvleftësimi kaq të dukshëm për shkencën e sociologjisë dhe profesionin e sociologut si figurë profesionale me rrezatim të gjerë social, që ka të bëjë me domosdonë e studimeve konkrete të problemeve sociale të shoqërisë shqiptare.

Sociologjia është një shkencë dhe, si e tillë, nuk mund të mundet nga profesione të tjera, siç është profesioni i gazetarit, ai i politikanit, i financierit apo i ekspertit të komunikimit, pothuajse njëlloj siç nuk mund të thuhet se shkenca që studion planifikimin dhe zhvillimin urban, ose shkenca ambientaliste janë mundur nga ndërtuesit e xhunglës urbane dhe nga shkaktarët e kaosit urban. Si profesion, në Shqipërinë e sotme, sociologu mund të mos jetë dhe, në fakt, nuk është as më i kërkuari, as më i vlerësuar. Por sa profesione të tjera të dobishme kanë mbetur të pavlerësuara në vendin tonë në këtë periudhë të vështirë tranzicioni vetëm e vetëm ose kryesisht për shkak të rendjes pas fitimit material, të moskuptimit ose të

nënleftësimit të rëndësisë dhe të dobisë shoqërore të tyre?

Por kjo nuk është e vërtetë në Shtetet e Bashkuara. Madje, sociologë të tillë si, Paul Lazarsfeld, Lesli Kish, James Coleman dhe shumë të tjerë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përpunimin e metodave dhe të teknikave të kërkimit shkencor në jetën e shoqërisë. Shumë prej metodave dhe teknikave të hulumtimit empirik (si analizat statistikore, metodat panel, analiza e strukturave latent, teknikat e sondazhit të opinionit, modelet matematikore dhe përdorimi i analizave faktoriale etj), të përpunuara nga këta sociologë dhe nga sociologë të tjerë të njohur, i kanë qëndruar kohës dhe edhe sot shumë të dobishme dhe të pazëvendësueshme në studimin e dukurive dhe të marrëdhënieve politike, në studimin e rolit të medias në shoqëri, në studimet mbi mirëqenien e popullsisë, mbi rolin e emigracionit etj. Pa to, në fakt, sociologjia empirike në Shtetet e Bashkuara, në Britaninë e Madhe dhe në vende të tjera, nuk do të ishte zhvilluar dot në stadin që është sot.

Shoqëria e sotme, edhe pse më e globalizuar, nuk është dhe nuk po bëhet një shoqëri thjesht mediatike, politike apo financiare. Shoqëria e sotme është të gjitha këto së bashku, dhe është e tillë për shkak se ajo ekziston vetëm si një tërësi marrëdhëniesh dhe institucionesh të ndërvarura, të cilat, ndër të tjera dhe para së gjithash i studiojnë sociologjia dhe nëndisiplinat derivate të saj. Për shkak të zhvillimit të shpejtë të mjeteve të reja të informimit e të komunikimit dhe të rolit gjithnjë e më të madh që ato kanë në jetën e shoqërisë bashkëkohore, si edhe për shkak të formave të reja të drejtimit dhe të manipulimit politik të masave, do të ishte gabim të mendohej se shoqëria e sotme po desociologjizohet.

Përkundrazi, këto zhvillime të reja kanë dhe do të kenë gjithnjë e më shumë nevojë për sociologjinë dhe studimet sociologjike, pasi asnjë shkencë tjetër sociale nuk ka atributet e sociologjisë për të shërbyer si një shkencë interpretuese në shpjegimin e jetës shoqërore dhe të sjelljes njerëzore. Kjo më mbush me besim se mendimi sociologjik dhe studimet sociologjike në vendin tonë do të zhvillohen më tej në zhvillimin dhe modernizimin e shoqërisë shqiptare. Ato nuk do të munden nga gazetaria dhe nga gazetarët, as nga politike dhe politikanët, pasi këto do të kenë gjithnjë nevojë për mendimin sociologjik.

Për të hedhur pak dritë mbi rëndësinë e profesionit të sociologut do të dëshiroja të sillja në vëmendje autorin Peter Berger sipas të cilit: "Interesi për sociologjinë lind nga fakti që perspektiva sociologjike na jep mundësinë të shohim, nën një dritë të re, botën në të cilën kemi jetuar gjithmonë" (Berger;1963). Shumë studiues të fushës së sociologjisë sot, janë duke përpunuar ide që lidhen me ripozicionimin e sociologut në tregun e punës, si dhe me rikonceptimin e studimeve të sociologjisë për të qenë ato më pranë qytetarëve dhe sa më shumë në shërbim të çështjeve publike. Për këtë arsye studiues të tillë Michael Burawoy flasin "për një sociologji frymëzuese", si, për shembull, në studimin me titull "Për një sociologji të publikut" (2005) ose në kushtet kur Ulrich Beck flet për "nevojën e zërit publik të sociologjisë", duke pohuar domosdoshmërinë e rikonceptimit të sociologjisë nën një dritë të re, në mënyrë që kjo shkencë të mos mbetet "si një relike në muze".

Sociologu i njohur amerikan Peter Berger ka vënë në dukje me të drejtë se mendimi sociologjik është "një mënyrë tipike moderne dhe perëndimore e të menduarit"

(Berger;1963). Kësisoj, sa më moderne dhe sa më perëndimore të bëhet shoqëria shqiptare, aq më shumë do të ndihet nevoja për sociologjinë dhe studimet sociologjike në vendin tonë.

Kudo në botë ka një vlerësim tjetër për profesionin e sociologut, për vlerën e studimeve sociologjike, që udhëheq procesin e analizës dhe orientimit pozitiv të problemeve sociale të shoqërisë. Në tërë vendet e qytetëruara autoriteti i sociologjisë dhe i studimeve sociale si dhe roli i veçantë e misioni i sociologut është rritur dhe vlerësuar si kurrë më parë. Ata janë vënë në qendër të shoqërisë, jo për ekspozitë apo zbukurim intelektual të realitetit social, por sepse është fakt universal tashmë se sa më shumë modern bëhet shoqëria, aq më shumë qeverisja dhe administrimi i saj ndien nevojën për analiza, këshilla dhe rekomandime sociale. Në kohën moderne sociologët janë bërë inxhinierë dhe doktorë për sëmundjet e shoqërisë, sepse janë të aftë të studiojnë dukuritë sociale, të bëjnë diagnoza të fenomeneve sociale, të përcaktojnë terapitë dhe të rekomandojnë ndërhyrjet e duhura.

Akoma më shumë, ata janë të dobishëm, ndaj shteti dhe shoqëria jonë duhet të vlerësojë aftësinë e tyre për të parashikuar rrjedhën hapsinore dhe kohore të dukurive sociale, që janë të pranishme sot apo duken në horizont. Sepse duke i observuar me “teleskopin” e tyre, sociologët kanë mundësi të parashikojnë kurbën e zhvillimit të dukurive sociale normale dhe patologjike, që ndeshen në shoqërinë tonë. Nuk ka figurë tjetër alternativë që të jetë ekuivalente, e aftë që të luajë rolin dhe të kryejë rolin e sociologut. Ca më tepër ta zëvendësojë atë.

Zhvillimet dramatike ekonomike dhe reformat e thella sociale që janë ndërmarrë në vend gjatë tranzicionit kanë hapur shumë plagë sociale, e kanë bërë të pashmangshme nevojën e kurimit të tyre. Në këtë kontekst social përzgjedhja midis një disipline që formon kurues dhe një disipline që formon projektues e parandalues sociale, duhet të anojë nga e dyta. Në këto rrethana sociologjia dhe sociologët duhet të jenë më fatlumë. Për këtë nevojitet një perceptim më i drejtë i ploitikave sociale. Shërbimet riintegruese duhet të mbizotërojnë në raport me shërbimet rehabilituese.

Mendimi ekonomik, perceptimi i politikave sociale duhet të mbështeten edhe në mendimin shoqëror, studimet sociologjike, mendimin e sociologut. Vetëm kështu mund të hartohen politika të qarta për zhvillimin social të vendit, të projektohet një Shqipëri humane e sociale. Kërkesa shoqërore për mendimin sociologjik duhet të jetë përtej të sotmes, sepse vetëm kështu mund të inkurajohet oferta sociologjike në Shqipëri.

## Referenca:

Antoni Gidens, (2002) Sociologjia, Shtëpia Botuese “Çabej”, Tiranë.

Fatos Tarifa, (2008) Ftesë në sociologji. Imagjinata sociologjike dhe jeta e përditshme, Shtëpia e Librit Ombra GVG-Tiranë

Lindore, (1999) (botues Verner Vajdenfeld), Shtëpia Botuese Argeta LMG, Tiranë.

Mihael Schmid-Neke, “Sqipëria”, shih librin, Demokracia dhe ekonomia e tregut në Evropën

Peter Berger, (196) 3 Invitation to Sociology: A Humanistic Perspective. New York: Anchor Books.

Zyhdi Dervishi, (2003) “Flirte me plagët”, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë.

**Tidita ABDURRAHMANI**  
 Universiteti “Hëna e Plotë” Bedër  
 Tirana/Albania

## **Shërbimi Psiko-Social në Institucionet e Arsimit Parauniversitar në Shqipëri dhe Perceptimet e Mjedisit Shkollor mbi Këtë Shërbim**

### **Abstrakt**

*Punimi në vijim, pjesë e prezantimeve në workshopin ndërkombëtar IWES 2014, bazohet në një rishikim të literaturës dhe kuadrit rregullator ligjor të huaj dhe vendas mbi shërbimin psiko-social dhe efektshmërinë e këtij shërbimi në mjedisin arsimor shqiptar. Duke gjurmuar përkufizimet e psikologjisë shkollore që në fillimet e studimeve në këtë fushë në vitet '60 dhe duke vijuar me përkufizimet bashkëkohore të këtij lëmi dhe fushe studimi, atyre të Shoqërisë Amerikane të Psikologjisë (APA), punimi përcjell idenë që paragjykimet e mjedisit arsimor shqiptar për rolin e psikologut shkollor e kanë zanafillën e tyre në retorikën e përdorur për të përcaktuar gamën e roleve, detyrave dhe përgjegjësi të këtij profesionisti, si dhe në mentalitetin frenues të shoqërisë shqiptare e cila e vesh këtë profesionist me funksionet e një psikologu klinik që duhet të ndërhyjë në shkollë sa herë që situatat kthehen në problematike. Ky punim më tej dëshmon që gjuha ligjore e përdorur më pas në Ligjin e Arsimit Parauniversitar 69/2012 dhe në dispozitat normative të hartuara në zbatim të këtij ligji, nxit bashkëpunimin mes mësuesve, drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare dhe psikologëve shkollorë, duke mundësuar në këtë mënyrë që edhe vetë nxënësit të familjarizohen me rolin edukues, konsultues dhe informues të psikologëve shkollorë, duke rritur në këtë mënyrë edhe efektshmërinë e shërbimit të tyre. Duke marrë shkas nga një studim Dr. Elida Rapti mbi perceptimet e adoleshentëve mbi efektshmërinë e shërbimit psikologjik në shkollë, punimi më pas fton për një gjallërim të mëtejshëm të rolit të punonjësve social si profesionistë të domosdoshëm komplementarë ndaj shërbimit psikologjik në shkollat shqiptare.*

**Fjalë Kyç:** shërbimi psiko-social, perceptime, adoleshentët, statusi i psikologut shkollor

## 1-Hyrje

Përkufizimet e hershme mbi psikologjinë shkollore janë të larmishme por thelbi i tyre është i njëjtë “psikologjia shkollore është një disiplinë që rrjedh nga trangu i psikologjisë së përgjithshme dhe implementon në edukim të gjithë gjetjet dhe njohuritë teorike” (Varoshi;26). Në librin “Psikologu shkollor” (35), White dhe Harris deklarojnë. “Ne mendojmë se psikologjia shkollore është ajo degë e psikologjisë e cila merret me personalitetin dhe interesin e nxënësit gjatë ndërveprimit me procesit mësimor”. Kjo fushë nuk përfshin vetëm procesin mësimor si pjesë të edukimit, por përfshin edhe personalitetin e nxënësit, si pjesëtar i komunitetit të shkollës. Më tej, Suzan Grey (46), në librin e saj “Psikologu në shkollë”, deklaroi se “psikologët shkollorë kanë dy role kryesore: -si zgjedhës të problemeve të orientuar mbi të dhënat në shkollë dhe si transmetues të njohurive dhe aftësive psikologjike”. Në krahasim me përkufizimet e viteve 1960-1970, të cilat tentonin të trajtonin fushën, duke u fokusuar në atë çfarë bënte apo çfarë duhet të bënte psikologjia shkollore, përkufizimet aktuale të psikologjisë shkollore përpiqen të jenë më të drejtpërdrejta dhe vënë theksin në përcaktimin e karakteristikave thelbësore të psikologjisë shkollore.

Bardon dhe Bennett (60), e përcaktojnë psikologjinë shkollore, si “një degë të psikologjisë së përgjithshme, e cila sjell njohje, aftësi dhe teknika psikologjike, të lindura nga problemet e shfaqura në shkollë”. Psikologjia shkollore, është një ndër degët kryesore të psikologjisë së bashku me psikologjinë klinike dhe atë të edukimit. Fagan dhe Wise në 1994(73) shprehën se: Një psikolog shkollor është një specialist i psikologjisë së përgjithshme, qëllimi i të cilit është të sjellë një perspektivë psikologjike që lidhet me shërbimet edukuese ndaj klientit. Kjo perspektivë rezulton në afrimin e shërbimeve psikologjike gjithëpërfshirëse të natyrës direkte dhe indirekte.

Përkufizimi i Shoqërisë Kombëtare të Psikologjisë Shkollore (NASP) është: Psikologu shkollor ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të kenë sukses në shkollë, në shoqëri, në zgjidhjen e problemeve emocionale dhe atyre me sjelljen. Ata bashkëpunojnë me mësuesit, prindërit dhe profesionistë të tjerë për të krijuar mjedise të sigurt, në mbështetje të procesit të të mësuarit, duke ndikuar gjithashtu dhe në forcimin e lidhjes: shtëpi-shkollë-komunitet për të gjithë nxënësit. ( cit. ne Varoshi, 2013; 28)

Një përkufizim tjetër i psikologjisë shkollore është dhënë nga Divizioni i 16-të i Shoqërisë Amerikane të Psikologjisë, APA (SHAP). Në adresën zyrtare të APA-s, mbi qëllimet dhe objektivat shkruhet: Psikologjia shkollore është shkenca që ofron një praktikë të përgjithshme dhe shërbim shëndetësor në atë disiplinë të psikologjisë së përgjithshme që merret me fëmijët, të rinjtë, familjet, nxënësit e të gjitha moshave, dhe procesin e mësimdhënies. Arsimi bazë dhe trajnimi i psikologëve të shkollave i përgatit ata për të siguruar një gamë të gjerë të vlerësimit psikologjik, ndërhyrjeve, parandalimit, promovimit të shëndetit, si dhe të zhvillimit dhe vlerësimit të programit të shërbimeve me një fokus të veçantë në proceset e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve brenda kontekstit të shkollës. ( cit. ne Varoshi, 2013;30).



Një vështrim krahasues diakronik i përkufizimeve të psikologjisë shkollore në përvojat Europiane dëshmon për evoluime të trajtimeve të këtij koncepti nga fushë e psikologjisë së përgjithshme, në trajtime të psikologjisë shkollore si praktika ndërhyrjesh, pune parandaluese dhe promovuese me në focus zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve brenda kontekstit të shkollës. Nëse në fillimet e psikologjisë shkollore , profesioni dhe statusi i psikologut shkollor përqendrohej kryesisht në një qasje prej klinicieni , ku ky profesionist thërrijet në ndihmë sa herë që sjelljet e nxënësve në shkollë ktheheshin në problematike; teoritë bashkëkohore mbi statusin e psikologut shkollor përqendrohen kryesisht në kontributin që këta profesionistë mund të japin në zhvillimin e programeve parandaluese si dhe në organizimin e seancave psikologjike informuese në shkollë , të cilat në perspektivë do të shmangin shfaqjen e sjelljeve problematike dhe devijante nga ana e të rinjve.

## **2-Baza Ligjore për Shërbimin Psikologjik/Shërbimin Psiko-Social në Shqipëri**

Baza ligjore ku është ngritur dhe mbështetur shërbimi psikologjik shkollor, është e huazuar në parimet kryesore në të cilat është mbështetur dhe shërbimi psikologjik i vendeve të zhvilluara. Më 11.10.2004, MASH-i nxori vendimin nr. 321, “Eksperimentimi i shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar në vitet shkollore 2004-2005-2006” (MASH, 2004). Vendimi vijon me cilësitë e punonjësit të shërbimit psikologjik, arsimin e tij specifik, qëllimin kryesor të psikologut shkollor si specialist i shërbimit psikologjik që bashkëpunon me tre aktorët kryesorë: nxënës, mësues, prindër, duke realizuar vlerësimin e rezultateve të nxënësit, orientimin shkollor e profesional, zhvillimin psiko-social, emocional të personalitetit, etj. Ky vendim pas vitit 2006 e shndërroi periudhën eksperimentale në një vendim të formës së prerë e të pakthyeshem për shtrirjen e shërbimit psikologjik në të gjitha vitet që do të vijjnë. Në vitin 2008, “MASH rifreskon dhe përforcon vendimin për shtrirjen e këtij shërbimi në të tërë sistemin arsimor parauniversitar.”(Varoshi, 2013:34). Vendimi më i fundit, i cili vë theksin mbi zhvillimin cilësor të këtij shërbimi, është vendimi i nëntorit të 2011. Me forcë theksohet shtrirja e këtij shërbimi si në zonat urbane por dhe në zonat rurale, në të gjithë fëmijët e moshës nga 0 deri 18 vjeç. Ligji i Arsimit Parauniversitar 69/2012 parashikon ngritjen e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore. Ky ligj sjell risi përsa i përket shtimit të dimensionit social, shërbimit psikologjik në shkolla . Retorika e formulimit të këtyre dokumenteve dhe rregullimeve ligjore sërish përqendrohet në konsiderimin e shërbimit psiko-social si “trajtim të problematikave të rasteve të ndryshme “, por zgjeorn gamën e veprimatrive të parashikuara të mbuloheh nga psikologët shkollorë, duke shtuar këtu aktivitetet vlerësuese, parandaluese dhe edukuese.

1. Njësitë arsimore vendore u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore.
  2. Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor. (Ligji I Arsimit Parauniversitar 69/2012; Neni 46).
- Urdhëri nr.344 Nr. 19.08.2013 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës parashikon ngritjen

e njësisë së shërbimit psiko-social pranë Drejtorive Arsimore dhe Zyrave Arsimore. Numri i psikologëve shkollorë llogaritet mbi bazën e numrit të nxënësve dhe nivelin e shkollimit të tyre. Rregullimet ligjore të këtij urdhëri përfshihen edhe në Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar ku: “Shërbimi psiko-social vlerëson gjendjen psiko-sociale të nxënësve me probleme të nxënësve ose sjelljes dhe, në bashkëpunim me mësuesit, drejtuesit e institucioneve arsimore dhe prindërit, planifikon e realizon shërbime të përshtatshme që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësit.”

Përmes Ligjit të Arsimit Parauniversitar 69/2012 dhe Dispozitave Normative të Arsimit parauniversitar detyrat dhe përgjegjësitë e psikologut shkollor përvijohen si më poshtë:

Psikologu/punonjësi social ka këto detyra kryesore në institucionin arsimor:

- a) Në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit, **identifikon e vlerëson, sa më herët, nxënësit me probleme të sjelljes ose** me vështirësi në të nxënë, dhe harton e zbaton për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese.
- b) Ndihmon punonjësit arsimorë, prindërit dhe nxënësit në **parandalimin ose eliminimin e abuzimeve** të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve dhe abuzimeve të vetë nxënësve nga duhani, alkooli, droga etj.
- c) Informon, nëpërmjet bisedave e leksioneve, punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimet moshore tipike të nxënësve dhe problemet tipike që nxënësit hasin gjatë të mësuarit dhe të nxënës.
- ç) Ndihmon mësuesit kujdestarë dhe mësuesit lëndorë për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e institucioneve arsimore të zakonshme.
- d) Këshillon nxënësit për karrierën e tyre.
- dh) Administron dhe interpreton teste psikologjike (nga psikologu).
- e) Plotëson dosjet individuale për rastet e nxënësve që kanë përfutuar nga shërbimi psiko-social.
- ë) Raporton me shkrim tek drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social çdo fakt për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimor dhe prindër të nxënësit.
- f) Merr pjesë në kërkime të parashikuara në planin vjetor të njësisë.

Dispozitat normative parashikojnë edhe kontributin e supervisorit të shërbimit psikologjik dhe të punonjësve arsimorë në ndërgjegjësimin e nxënësve mbi rëndësinë e marrjes së shërbimit psikologjik. (Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, 2013; 44, 45).

Qëllimi kryesor i shërbimit psikologjik shkollor është promovimi i mirëqenies mendore dhe fizike të nxënësve si dhe lehtësimi i procesit të të nxënës. Shërbimet tashmë të njohura të psikologjisë shkollorë përfshijnë veprimtari bazë që në themel kanë standarde të këshillimit. Këto veprimtari (shërbime bazë) plotësojnë njëra-tjetrën dhe prandaj shihen si të integruara dhe të koordinuara mire, si pjesë e një të tërë, më shumë se sa si shërbime të ndara.

Inspektoriati Shtetëror i Arsimit Parauniversitar në vitin 2013 boton manualin “Inspektimi dhe vetëvlerësimi i shërbimit psikologjik në shkollë”. Ky udhëzues vjen si një material me tregues të matshëm dhe instrumente pune të cilët përcaktojnë elementet e domosdoshme të shërbimit psikologjik, duke u bazuar në filozofi dhe në metodologji bashkëkohore të inspektimit dhe vlerësimit të shërbimeve arsimore. Udhëzuesi detajohet në 5 fusha themelore të inspektimit dhe vetëvlerësimit, përkatësisht:

Fusha 1: Vlerësimi

Fusha 2: Planifikimi

Fusha 3: Konsultimi dhe bashkëpunimi

Fusha 4: Këshillimi

Fusha 5: Zhvillimi profesional i psikologut shkollor. (ISHA 2013; 20)

Janë këto fusha ato që detajojnë edhe dimensionet që një psikolog shkollor duhet të marrë në mjedisin arsimor të shkollës dhe detyrat dhe përgjegjësitë e këtij profesionistë të parashikuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe në dispozitat normative.

### **3-Perceptimet e Vetë Psikologëve Shkollorë mbi Shërbimin Psiko-social në Shkolla**

Nga një studim i kryer nga Qendra Alternativa një organizatë jo fitim prurëse me në fokus të punës së saj hartimin, analizën, zbatimin dhe monitorimin e politikave socio-ekonomike lidhur me zhvillimin kombëtar në fushat e shëndetit publik, mjedisit, arsimit dhe mbrojtjes sociale në Shqipëri në përputhje me standardet dhe politikat e BE dhe bazuar në parimet e te drejtave të njeriut të mbrojtura nga konventat ndërkombëtare, rezultoi se psikologët shkollorë dëshmojnë se e kanë filluar punën në shkolla kur vetë aktorët e lidhur me shkollën nuk kanë qenë të informuar në mënyrë të mjaftueshme për punën që këta të fundit do të bënin. Për këtë shumica e psikologëve shkollorë të pjesë e focus grupeve të organizuara nga kjo qendër, dëshmojnë së niveli i mbështetjes ndaj punës së tyre ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, por përsëri ka një lloj paqartësie për rolin e psikologut në shkollë. Janë jo të rralla rastet kur psikologu shkollor shihet si një mësues më shumë, apo si një kujdestar klase, apo episodet e perceptimeve të shprehura të nxënësve dhe mësuesve të cilët e shohin këtë profesionist si një mundësi për të trajtuar ata që “çmenden”. Niveli relativisht i ulët i kuptimit të rolit të PSHP në shkollë ndikon në marrëdhëniet që ata vendosin me këta të fundit. Kësisoj, nëse PSHP përmendin se punojnë me sa më shumë aktorë që mundin, ata ndjejnë se nuk kanë partnerë realë. Nga shumë persona shërbimi psikologjik shikohet si i ndarë nga programi shkollor, si diçka e jashtme që nuk është pjesë e shkollës.

Nga fokus grupet e zhvilluara nga kjo qendër rezultoi se drejtuesit dhe mësuesit kujdestarë janë partnerët më të ngushtë, e pastaj vijnë kolegët në shkollat e tjera. Kryesisht mësuesit e lëndëve shoqërore janë më bashkëpunues dhe kjo mundëson realizimin e aktiviteteve informuese gjatë orëve të mësimi. [...]. Qëndrimet mosbesuese e jombështetëse ushqehen herë pas here edhe nga përpjekjet e PSHP për të vëzhguar gjatë mësimi, ose për të anketuar nxënësit për qëllimet e punës së tyre. (Qendra Alternative <http://www.qendraalternative.al/>)

Një pjesë e psikologëve shkollorë shprehin gjithashtu se ka një lloj ndryshimi midis mbështetjes që ofrohet në shkollat e zonave urbane nga ajo në shkollat e zonave rurale. Në shkollat e zonave urbane ka një nivel pranimit, mbështetje dhe një njohje më të mirë të shërbimit psikologjik krahasuar kjo me shkollat e zonave rurale. “Kur mes palëve ka raporte bashkëpunimi, kërkimi i mendimit nga PSHP

bëhet sistematikisht, ndërsa ka mundësi që kur nuk ekziston një bashkëpunim i tillë, mësuesit dhe drejtorët ua shkarkojnë punën me sjelljet e nxënësve PSHP.” Një burim i rëndësishëm mbështetje janë edhe profesionistët e tjerë. Ata shërbejnë si burime bashkëpunimi dhe referimi. “Frekuenca e rasteve të bashkëpunimit varion nga asnjë, në të rralla me mjekë dhe psikiatër dhe të herëpashershme me psikologë dhe punonjës socialë në organizata jofitimprurëse. Kjo ka ndihmuar për një menaxhim dhe adresim më të mirë të nevojave nga ana e PSHP.” Bashkëpunimi me partnerë të tjerë rrit nivelin e vetëbesimit, siguron burimin profesional të nevojshëm si dhe mundëson konsultimin duke identifikuar alternativat më të përshtatshme.

#### **4-Shërbimi Psikologjik në Shkolla dhe Perceptimet e Nxënësve mbi këtë Shërbim**

Shërbimi psikologjik në shkolla dhe për më tepër dimensionin social i këtij shërbimi është një fenomen relativisht i vonë në institucionet e arsimit parauniversitar në Shqipëri. Edhe më i vonë është perceptimi i këtij shërbimi si një mjet edukues nga mjedisi i mësimdhënësve dhe perceptimi i tij si një instrument që ndihmon për edukimin e adoleshentit shqiptar. Implementimi i vonuar kohor i shërbimit psikologjik në shkollën shqiptare ka një numër arsyesh me sfond si politik dhe të traditës së popullatës shqiptare ndër të cilat mund të përmendim mentalitetin frenues të autoriteteve vendimarrëse, pamundësinë e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri për të përgatitur specialistë me profesionin e psikologut shkollor. Nga pilotimi i këtij shërbimit në vitet 2004 dhe 2005, në zbatimin e tij në shkollë të gjerë në arsimin parauniversitar në Shqipëri në vitet 2008, kaloi një kohë shumë e shkurtër dhe kjo periudhë ndikoi në nivelin e ulët të perceptimit që vetë nxënësit apo punonjësit e tjerë arsimorë në shkolla kishin ndaj shërbimit psiko-social në këto institucione.

Në fillimet e shërbimit psikologjik në vitin 2008 disa adoleshentë shpreheshin. Duke qenë një vend në tranzicion, nuk jemi mjedisuar ende me futjen e psikologut nëpër shkolla. Kjo ndodh ngaqë ne, nxënësit, kur nuk besojmë tek prindi apo shoku, si mund t'i besojmë një personi tjetër? Besimi është diçka fundamentale dhe nuk mund t'i dorëzohet çdo njeriu, prandaj shpeshherë preferojmë të mbyllemi në botën tonë adoleshente. Pyetja ime është: tek cili duhet të besojë një i ri, tek një i afërm, apo tek një i panjohur?. (Gazeta Shqip Qershor 2012).

Kjo është në formë të përmbledhur gjithçka që ndodh me një nxënës, kur gjendet përballë një studioje në shkollën e tij, ku lexohet “Kabineti i shërbimit psikologjik”. Edhe pse kanë kaluar kaq vjet, problemi i (mos)besueshmërisë së nxënësit mbetet sërish, ndonëse jo si në fillimet. Psikologu shkollor është një njeri që merret me nxënësit me probleme mendore, mendohej nga shumë prej tyre, duke e parë veten jashtë rrezes së tij. Natyrisht që psikologët shkollorë e kanë kapur këtë ngërç që iu lidhte duart dhe janë përpjekur të shtrijnë urat e besimit dhe komunikimit me gjithë nxënësit, duke argumentuar se ky shërbim nuk është vetëm për disa fëmijë në nevojë, por një mundësi për këshillim për çdo nxënës.

Paketat dhe rregullimet ligjore të ndërmarra kanë marrë përsipër të forcojnë dhe

promovojnë urat e komunikimit ndërmjet studentëve, psikologëve shkollorë dhe mësuesve, por nga ana tjetër ata pashmangshmërisht vazhdojnë të mbështeten në retorikën tradicionale të të konsideruarit të fokusit kryesor të shërbimit të këtyre profesionistëve studentët me probleme.

Në një studim të Dr. Elida Rapti ‘Perceptimi i adoleshentit në shkollën shqiptare’, autorja pohon që “shërbimi psikologjik në shkollë njihet ende pak nga grupi i adoleshentëve. Vetëm 4 adoleshent ndër 5 të pyetur, njohin faktin se në shkollën e tyre ka shërbim psikologjik. Rreth 20 % e adoleshentëve nuk kanë njohuri për funksionimin e shërbimit psikologjik në shkollën e tyre. .(Rapti E., Revista Pedagogjike, IZHA 2013;164)

I ndërmarrë në vitin 2011, ky studim nuk është në gjendje të masë impaktin që do të ketë në vijim Ligji I Arsimit Parauniversitar 69/2012 dhe kryesisht detyrat dhe përgjegjësitë që ky ligj do të vendosë përpara drejtuesve të shkollave përse I përket promovimit të shërbimit psikologjik nga ana e tyre për të konsoliduar më tej statusin e tij në shkollën shqiptare.

Nga ana tjetër tendenca e ulët që shfaqin adoleshentët mbi njohjen e funksioneve që ka shërbimi psikologjik në shkollën e tyre plotësohet më mirë kur ata pyeten për njohuritë që kanë mbi rolin që luan shërbimi psikologjik në shkollën e tyre.

Të dhënat tregojnë se 1 ndër 3 nga adoleshentët që kanë pohuar se njohin faktin që ka shërbim psikologjik në shkollën e tyre, shprehen se nuk dinë se çfarë detyrash ka ky shërbim në shkollën e tyre. Ky fakt përforcon idenë se adoleshentët, pavarësisht se dinë që ka shërbim psikologjik në shkollën e tyre, përsëri kanë një shkallë të ulët njohje për detyrat që ky shërbim ka për edukimin e sjelljeve të tyre (Rapti E., Revista Pedagogjike, IZHA 2013;164).

Mungesa e informacionit të adoleshentëve në lidhje me gamën e shërbimeve të ofruara nga psikologët shkollorë lidhet nga njëra anë me mentalitetin dominues dhe frenues të shoqërisë shqiptare dhe nga ana tjetër me mangësitë e politikave arsimore të cilat mbështesin një raport më të favorshëm shkollor /nxënës i cili do ta kthente këtë figurë në një imazh më familjar dhe më të ngrohtë për nxënësit dhe për mësuesit të cilët e vëzhgojnë atë ndërsa kryen funksionet e tij në më shumë se një shkollë në harkun kohor të një dite pune.

“Ftohtësia”, papërshtatshmëria apo mungesa e mjediseve ku zhvillohet shërbimi psikologjik në shkolla sërish kanë një ndik të drejtëpërdrejtë në perceptim e shtrembër të shërbimit psikologjik nga ana e adoleshentëve.

Efikasiteti i shërbimit psikologjik në shkollë lidhet ngushtë edhe me ambientin fizik ku realizohet ky shërbim në shkollën shqiptare. Numri i madh i adoleshentëve që pohojnë se nuk ka ambiente të përshtatshme për ushtrimin e shërbimit psikologjik në shkollë, tregon indirekt edhe besueshmërinë jo të lartë që kanë adoleshentët për statusin e shërbimit psikologjik në shkollë. .(Rapti E., Revista Pedagogjike, IZHA 2013;165).

Në një popullatë prej 1200 nxënësish, shkalla e njohjes nga studentët e arsimit të mesëm të pranisë së shërbimit psikologjik në shkollë është e lartë për 81% të të anketuarve, ndërkohë që 16% e tyre nuk kanë fare dijeni për ekzistencën e shërbimit psikologjik në shkollë. Të pyetur më pas në mënyre direkte në lidhje me besimin që ato kanë ngritur në lidhje me efektshmërinë e shërbimit psikologjik në shkolla vetëm 1 adoleshent ndër 2 të pyetur, e percepton takimin me psikologun e shkollës si një veprim të efektshëm dhe që ka ndikim për modifikimin e sjelljes së tij problematike apo si mjet që e ndihmon për të menaxhuar problemet e tij në ambientin shkollor apo familjar.” ( Rapti E., Revista Pedagogjike, IZHA 2013;166).

Kjo mungesë besimi mbi efikasitetin e shërbimit të psikologut shkollor shumë herë mund të shpjegohet me mungesën e kuaklifikimit përkatës nga ana e psikologëve shkollorë, me normën e lartë për nxënës dhe për ditë pune të caktuar për këta psikologë nga udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës si dhe mungesën e dëshirës karakterizuese për të gjithë adoleshentët për të ia adresuar problemet e tyre një personi të huaj.

Prirjet Europiane të perceptimit të rolit të psikologut shkollor nga ana e adolescentëve tregojnë për një përfaqim nga ana e këtij target grupi më shumë të rolit të psikologut shkollor si këshillues dhe si edukues sesa si ndërhyrës në problematikat shkollorë. Kjo është në njëfarë mase edhe fryma e dhënë këtij profesioni nga ana e Ligjit të Arsimit Parauniversitar 69/2012 u vë detyrë mësuesve dhe autoriteteve drejtuese të shkollës të rrisin ndërgjegjësimin në mjedisin shkollor për rolin e shërbimit psiko social, dhe nga ana tjetër të marrin kualifikime për të qenë të aftë të trajtojnë problemet e adolescentëve përpara se ato të kthehen në situata që kërkojnë ndërhyrje emergjente nga ana e psikologëve shkollorë.

## 5-Konkluzione

Në përfundim mund të themi që:

- Zanafilla e qasjes mosbesuese të mjedisit edukativ shqiptar ndaj shërbimit psiko-social duhet kërkuar në vetë retorikën e formulimit të dokumentëve politik rregullatorë të arsimit parauniversitar dhe në mjedisin shkollor të krijuar nga vetë punonjësit e arsimit parauniversitar. Një psikolog shkollor së pari ka për detyrë të parandalojë të edukojë dhe vetëm si masa fundore të trajtojë problemet e lindura dhe të pamundura të shmangen me anë të qasjeve të tjera konstruktive.
- Koha relativisht e re e implementimit të shërbimit psikologjik në shkollën shqiptare ende nuk lejon që të rinjtë të kenë një nivel të lartë të njohjes së detyrave që ka ky shërbim në shkollë.
- Paragjykimet dhe opinionet frenuese të familjes dhe komunitetit shqiptar ndaj punës së psikologut shkollor krijojnë barriera ndaj promovimit të bashkëpunimit të të rinjve me shërbimin psikologjik në shkollë.
- Standartet e ulta profesionale që përfaqëson shërbimi psikologjik në shkollë, mungesa e trajnimeve të vazhduara për këta profesionistë ndikojnë mbi nivelin e ulët të besueshmërisë që kanë të rinjtë ndaj këtij shërbimi.
- Strukturat politikbërëse në fushën e arsimit dhe në fushën e shërbimit social duhet të shmangin përdorimin e retorikës tradicionale e cila i konsideron

psikologët si profesionistë klinicienë të cilët ndërhyjnë sa herë që nxënësit apo studentët shfaqin problem në mjedisin shkollor.

- Angazhimi i psikologëve në më shumë se një shkollë do të vazhdojë të ndikojë negativisht mbi perceptimin që kanë të rinjtë mbi psikologun shkollor.
- Gjallërimi i dimensionit social të shërbimit psiko-social (pra angazhimi edhe i punonjësve social në shkolla) do të lehtësojë psikologun shkollor nga barra që i është dhënë dhe do të ndihmojë në përmirësimin e perceptimit të statusit të këtij të fundit në mjediset shkollore.

**Referenca:**

Bardon, J. I & Bennett, V. C. (1974). School Psychology, Englewood Cliffs, New York: PrenticeHall.

Fagan, T. & Wise, P. (2000). School Psychology: Past, Present and Future. Bethesda, MD: National Association of School Psychologist.

Ministria e Arsimit dhe e Shkences(2013).Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, nenet 45, 46, 47, 48,93, 94, 95, 96, 97, 98, 99,100,101.

Gray, S. W. (1963). The psychologist in the schools. New York: Holt, Rinehart & Winston.

Gutkin,T., B., & Curtis, (1998). School Based Consultation Theory and Practice (3rd.ed), John Wiley & sons,Inc.

Hartshorne, T.S., dhe Johnson, M.C. (1985). The Actual and Preferred Roles of the School Psychologist according to Secondary School Administration, Journal of School Psychology, vol. 23.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit(2013). Inspektimi dhe Vetëvlerësimi i Shërbimit Psikologjik në shkollë, Tiranë.

Lentz, F. E., dhe Shapiro, E. S. (1985). Behavioral School Psychology: A Conceptual Model for the Delivery of Psychological Services."In T. Kratochwill (Eds.), Advances In School Psychology (vol. 5, f. 191-221). Hillsdale, New York: Erlbaum

Ligj Nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

Ministria e Arsimit, (2004).Udhëzim Bazë i Minisrisë së Arsimit për Futjen e Shërbimit Psiko-pedagogjik në Shkollë", Tiranë, [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Qendra Alternative(2012)Shërbimi psikologjik ne shkolla. <http://www.qendraalternative.al>

Rapti, E. (2004). Psikologjia Shkollore, Tiranë.

Rapti, E., (2004). Roli i Shërbimit Psikosocial në Shkollë, Tiranë.

Rapti,Sinani. E (2013). Perceptimi i adoleshentit mbi shërbimin psikologjik në shkollën shqiptare., Revista Pedagogjike, IZHA.

Tamo, A., Kamani, P., Nano, V., Tahsini, I., & Agolli, I.,(2006) Raport i Vlerësimit të Shërbimit Psikologjik Shkollor, Tiranë.

Varoshi, Emanuela(2013)Implementimi i Shërbimit Psikologjik Shkollor, Risia që Kontribuon në Përqasjen e Sistemit Arsimor Shqiptar me atë Bashkëkohor. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Program i doktorates.

White, M. A., & Harris M. R. (1961). The School Psychologist. New York: Harper & Brothers.











[www.bjes.beder.edu.al](http://www.bjes.beder.edu.al)

**Address:**

"Jordan Misja" St. Tirana - Albania

**Contact: Tel: +355 4 24 19 200, + 355 4 24 19 222;**

**Fax: +355 4 24 19 333 web: [www.bjes.beder.edu.al](http://www.bjes.beder.edu.al), e-mail: [bjes@beder.edu.al](mailto:bjes@beder.edu.al)**